

Dr. Aida Zhupa



Libër mësuesi
për tekstin shkollor

Sociologjia 12

Shtëpia botuese ShBLSh e RE

Libër mësuesi
Sociologjia 12

Autore: Aida Zhupa
Redaktore letrare:

Arti grafik:
Kopertina:

© ShBLSh e Re, 2018
ISBN

Adresa

Tabela e përmbajtjes

Hyrja

1. Rëndësia e studimit të lëndës.

- 1.1 Pse duhet të studiojmë sociologji?
- 1.2 Rëndësia e sociologjisë në edukimin qytetar të nxënësve dhe vështirësitë gjatë procesit të nxënies në lëndët shoqërore.
- 1.3 Metoda mësimdhënie/nxënie në orët e sociologjisë
- 1.4 Kurrikula me bazë kompetencat dhe shkencat sociale
- 1.5 Qëllimet e programit të sociologjisë.
- 1.6 Ndërthurja e sociologjisë me lëndët e tjera.

2. Programi i sociologjisë, qëllimet dhe kompetencat kyçe.

- 2.1 Qëllimet e programit të Sociologjisë
- 2.2 Lidhja e kompetencave të lëndës me kompetencat e tjera kyçe.
- 2.3 Lidhja e lëndës së sociologjisë me temat ndërkurrikulare.
- 2.4 Lidhjet e lëndës së sociologjisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit.
- 2.5 Udhëzime metodologjike.
- 2.6 Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së sociologjisë? Mjedisi i të nxënit të sociologjisë.
- 2.7 Udhëzime për vlerësimin.
- 2.8 Materialet dhe burimet mësimore.

3. Llojet e planifikimeve.

- 3.1 Plani mësimor vjetor i lëndës (plani sintetik).
- 3.2 Shpërndarja e përmbajtjes lëndore sipas tremujorëve.
- 3.3 – 3.4 Planifikimi i orëve mësimore sipas tremujorëve (plani analitik) dhe rezultatet e të nxënit për secilin tremujor.

4. Modele të planeve – ditar të mësuesit/es.

- 4.1 Plan – ditarët e mësuesve për çdo temë mësimore.
- 4.2 Udhëzime metodologjike për organizimin e mësimin në orët 90 min.
- 4.3 Modele të plan – ditarëve të mësuesve për orët 90’.

5. Model projekti lëndor

6. Modele testesh për realizimin e kompetencave lëndore.

7. Model vetëvlerësimi për nxënësit/es dhe mësuesin/in.

8. Udhëzime për hartimin e një ankete.

HYRJE

Të dashur kolegë!

Teksti "Sociologjia 12" është bazuar në arritjet më të mira të mendimit sociologjik bashkëkohor dhe realizon të gjitha kërkesat e programit të hartuar dhe miratuar nga institucionet përkatëse. Ai është përshtatur me moshën dhe kërkesat e të rinjve të sotëm për një dije sa më funksionale dhe të vlefshme për realitetin ku ata jetojnë, në përputhje me ndryshimin e modeleve të sjelljes së njerëzve dhe zhvillimit të marrëdhënieve në shoqëri.

Libri i mësuesit "Sociologjia 12" është hartuar për t'iu ndihmuar në realizimin sa më cilësor të programit të kësaj lënde. Ai përmban:

- udhëzime për një metodologji moderne të mësimdhënies/nxënies në përputhje me grupmoshën dhe kërkesat e nxënësve, duke motivuar pjesëmarrjen e tyre në procesin e nxënies;
- planifikimin sa më eficient të orëve mësimore dhe shpërndarjen e tyre vjetore dhe trimestrale;
- modele ditësh bashkëkohore (45' dhe 90'), për çdo temë mësimore;
- modele testesh për secilin tremujor;
- udhëzime për organizimin e projekteve, veprimtarive praktike, si dhe modele konkrete të tyre etj.

Ky udhëzues bazohet në eksperiencën shumëvjeçare të autorëve të tekstit në fushën e kërkimit shkencor dhe në mësimdhënie, duke patur parasysh standartet e reja që kurrikula shkollore ka vendosur dhe me qëllim formimin e kompetencave kyç, si aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, në fusha të ndryshme të nxënies. Për këtë qëllim janë përcaktuar standartet për rezultatet e arritura nga nxënësit, si dhe praktika të reja mësimdhënieje për mësuesit.

Për lëndët shoqërore si sociologjia, vjen i përcaktuar qartë qëllimi i programit dhe tekstit mësimor, që ndikon në edukimin qytetar me vlera demokratike të nxënësve, për të drejta të barabarta njerëzore dhe për të luftuar çdo dallim gjinor, kulturor, gjuhësor, etnik, racor, fetar, etj. Konkretizimi i një teksti të tillë të parametrave bashkëkohorë, bën të domosdoshme që në përputhje me të, të jetë dhe niveli i mësuesve që do ta përcjellin këtë tekst tek nxënësit. Për këtë qëllim, në përputhje me programin lëndor dhe objektivat e reja, jemi përpjekur të orientojmë mësuesit drejt metodave të reja bashkëkohore, që nxisin përfshirjen aktive të nxënësve në orën e mësimi, duke krijuar një mjedis social dhe sa më miqësor në klasë. Bashkëpunimi mes nxënësve, krijon një klimë barazie dhe mirëkuptimi, që rrit motivimin dhe rezultatin e nxënies. Po kështu, kurrikula shkollore, lidhet me zhvillimin e një sërë veprimtarish dhe procesesh edukimi, që përfshijnë nxënësit, mësuesit, drejtorinë e shkollës dhe organizma të ndryshëm brenda saj. Synimi i këtyre veprimtarive dhe produkteve kurrikulare është formimi i personalitetit të nxënësve dhe krijimi tek ata i aftësive, qëndrimeve dhe vlerave, përmes të cilave ata do të jetojnë denjësisht në shoqëri. Disa prej metodave, të cilat mund të përdoren në orët e sociologjisë janë shpjeguar dhe trajtuar në këtë libër, megjithëse mësuesi është i lirë të zgjedhë dhe të përshtasë metoda të tjera, në përputhje me nivelin, moshën dhe karakteristikat e nxënësve të tij. E rëndësishme është që ai të përdorë metoda dhe teknika të larmishme dhe ndërvepruese në klasë, pa qëndruar indiferent ndaj fenomeneve sociale shqetësuese për kohën, por duke u përpjekur t'i drejtojë nxënësit në rrugën e një debati konstruktiv, ku gjithësecili të arrijë në përfundime të drejta për veten dhe për të tjerët.

Shumë e rëndësishme për një formim të gjithanshëm të nxënësve, është pjesëmarrja në veprimtari ndërkurrikulare, përmes lidhjes së temave mësimore të lëndëve të ndryshme. Në orientimet që jepen në strategjinë e kurrikulës së re, kjo ndërthurje shikohet me rëndësi për tema sociale, si: identiteti

kombëtar dhe njohja e kulturave; të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore; vendimmarrja morale, etj., të cilat lidhin, si shembull, sociologjinë me edukimin qytetar, me historinë, filozofinë etj.

Mjedisi i klasës, sikurse edhe ai shoqëror, është i përbërë nga individë që nuk ndajnë të njëjtat pikëpamje dhe qëndrime. Kjo gjë përbën një sfidë të vërtetë për shkollën në përgjithësi dhe për mësuesit në mënyrë të veçantë. Në kushtet e globalizimit dhe migrimit në shoqërinë e sotme, rritet diversiteti kulturor në komunitete dhe rrjedhimisht edhe në shkolla. Kjo vështirëson punën për të arritur një unitet vlerash sociale, krahas ruajtjes së diversitetit të tyre. Në këtë drejtim lënda e sociologjisë luan një rol shumë të rëndësishëm në njohjen dhe vlerësimin e pluralizmit kulturor, përmes ruajtjes së vlerave të kulturës tënde dhe respektimit të tjetrit ndryshe. Duke pranuar se diversiteti është gjithmonë e më shumë tipar i shoqërisë së sotme moderne, sociologjia si lëndë duhet të edukojë një qytetar kozmopolit, që njeh realitetin bashkëkohor dhe është i aftë të përshtatet në të gjitha nivelet, lokale apo globale. Edukimi i nxënësve me respektin për tjetrin, do të pakësonte rastet e dhunës dhe bullizmit në shkollat tona. Shkolla në tërësinë e saj dhe veçanërisht lëndët shoqërore, duhet të kompesojnë mungesën e një modeli të mirë të prindërve, apo të komunitetit ku jetojnë, për edukimin e fëmijëve. Por, shpesh mësuesit nuk janë në gjendje ta kryejnë këtë rol, duke mos qenë të sigurtë në trajtimin e rasteve të diskriminimit, jo vetëm për shkak të formimit, por edhe sepse u mungon një strategji efikase. Për arritjen e një modeli të ri evropian të stafit mësues, duhet të përcaktohen kritere të reja vlerësimi për punën dhe trajnimin e tyre.

Puna e mësuesit sot, sigurisht nuk është e thjeshtë, por mbetet për t'u parë si një sfidë e përditshme, e cila kërkon shumë punë, vullnet dhe përgatitje.

“Realiteti i ri shoqëror dhe njohuritë e reja bashkëkohore, kërkojnë ndryshimin e rolit të mësuesit, jo vetëm si një specialist dhe kompetent në fushën e dijes, por edhe si një partner i rëndësishëm në një marrëdhënie komplekse ndërpersonale komunikimi, si një edukator dhe madje si një këshilltar i nxënësve për jetën, për planifikimin e karrierës së tyre të ardhshme” (Negovan et al., 2010: 1730).

Me respekt autorja

1. Rëndësia e studimit të lëndës

1.1 Pse duhet të studiojmë sociologji?

Sociologjia studion mënyrën se si anëtarët e një shoqërie, bazuar në normat dhe vlerat kulturore, ndërtojnë marrëdhëniet mes tyre, gjë që shpesh sjell kufizimin e lirive individuale në të mirë të shoqërisë, pra, të ruajtjes së kohezionit brenda saj. Raporti mes interesave të veçanta dhe atyre sociale, është shpesh i vështirë të kuptohet dhe mund të krijojë konflikte. Është detyra e sociologjisë të edukojë sjellje sociale që ndihmojnë në harmonizimin e marrëdhënieve ndërshoqërore. Sociologjia ka në qendër të saj sjelljen e individit në shoqëri, pra, mënyrën sesi individ bashkëvepron me individët e tjerë dhe institucionet që shoqëria ka ngritur për të rregulluar jetën ekonomike, sociale dhe politike. Ajo analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm social, kulturor dhe institucional në këtë sjellje.

Për këtë qëllim, sociologjia jep *imagjinatën sociologjike*, përmes të cilës çdo individ:

- dallon drejt vendin e tij në jetën e shoqërisë;
- gjykon me objektivitet ngjarjet e përditshme, për të marrë vendime të drejta në momente të caktuara;
- aftësohet për të qenë largpamës në trajtimin e interesave, jo vetëm personale, por në interes të të gjithë shoqërisë;

- gjykon drejt çështje të tilla si barazia e të drejtave, pa dallim gjinie, race, kombësie, kulture, bindje politike, etj.
- kupton pse kategori të caktuara nuk i respektojnë rregullat e vendosura nga shumica e njerëzve, por janë burim i sjelljeve devijante, të cilat shpesh çojnë në çrregullimin e aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore;
- analizon faktorët që ndikojnë në shoqërizimin e individit gjatë jetës, si familja, grupi shoqëror i moshatarëve, shkolla, komuniteti, media, etj., si dhe rrugët që çojnë në brendësimin dhe përshtatjen me rregullat shoqërore dhe ligjore nga individë dhe grupe të caktuara;
- vlerëson drejt kulturën e shoqërive të ndryshme, të cilat janë shpesh unike dhe ndryshojnë nga njëra – tjetra në vlera dhe në kriteret e vlerësimit të sjelljes njerëzore.
- redukton sjellje të tilla si dhuna, bullizmi, diskriminimi, etj., si dhe ndihmon në zgjidhjen e konflikteve duke u bazuar në ndërveprimin dhe negocimin e problemeve.

Sociologjia ndihmon të kuptosh se këto norma nuk kuptohen nga të gjithë njëllot. Prandaj dija dhe reflektimi i bazuar mbi imagjinatën sociologjike shërben si një metodë për secilin individ, për t'u orientuar drejt në shoqërinë ku ai jeton.

Misioni i lëndës së sociologjisë në formimin e sjelljeve sociale, konsiston në:

-edukimin dhe respektimin e vlerave kulturore me qëllim ruajtjen e kohezionit shoqëror dhe shmangien e sjelljeve deviate;

-njohjen e vetes dhe "tjetrit", për një marrëdhënie tolerance, bashkëpunimi, respekti të ndërsjell, për të ndërtuar një komunikim të drejtë dhe të hapur me kulturat e tjera;

-ndërgjegjësimin e individëve për të qenë qytetarë aktiv dhe për të nxitur pjesëmarrjen qytetare në shoqërinë civile;

- aftësimin për të qenë mirëkuptues dhe tolerant ndaj përvojave të njerëzve të tjerë, duke vlerësuar në mënyrë kritike mendimet dhe opinionet që nuk janë të tyre;

-ndërgjegjësimin e individëve për një kuptim të gjerë për të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare, por dhe aftësinë e tyre për t'i demonstruar këto përgjegjësi në qëndrimet që mbajnë në raport me veten dhe të tjerët.

Vetë lënda e sociologjisë, përmes programit të saj, ofron mundësi për zhvillimin shpirtëror, moral, social dhe kulturor, duke i ndihmuar nxënësit të zhvillojnë një kuptim të drejtë të vlerave shoqërore, si barazia, drejtësia, ndershmëria, virtyti dhe duke promovuar respektin për diversitetin dhe ndryshimin.

Edukimi për qytetari demokratike, përmes sociologjisë synon:

- të përgatisë nxënësit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë nxënësit në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror dhe drejtësinë sociale, në të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile, përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i lëndës së sociologjisë duhet të synojë:

- t'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre;
- t'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit;
- t'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar, në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike, të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Me ndihmën e këtij programi nxënësit arrijnë të arsyetojnë mbi sjelljet e tyre dhe të evidentojnë vlerat njerëzore dhe qytetare si: drejtësia, ndershmëria, përgjegjshmëria personale, respekti, etj., mendjehapur në kushtet e një shoqërie globale. Është mjaft e rëndësishme që nxënësit të pranojnë diversitetin si tipar të këtij realiteti.

Trajtimi dhe vlerësimi objektiv dhe i barabartë nga ana e mësuesve, ndaj të gjithë nxënësve në klasë, pavarësisht origjinës, prejardhjes, gjinisë, kulturës, etj., do të krijonte një klimë të përshtatshme bashkëpunimi. Por, nga ana tjetër, mësuesit duhet të ruajnë edhe pavarësinë e arritjeve dhe aftësive akademike të gjithësecilit, për t'i dhënë motivimin e duhur dhe për të nxitur një konkurrencë të drejtë dhe pozitive.

Programi i sociologjisë ndihmon në zhvillimin e imagjinatës sociologjike për:

- zgjidhjen e problemeve qytetare përmes angazhimit dhe aktivizimit në jetën shoqërore;
- gjetjen e perspektivave të reja në jetë;
- zbulimin e rolit publik të sociologjisë për zgjidhjen e çështjeve në interes të shoqërisë;
- nxitjen e debatit publik, që përfshin publikun kritik dhe të përgjegjshëm në çështjet sociale;
- krijimin e një vetëdijeje shoqërore kritike të një individi, i cili njihet përgjegjësitë e tij.

1.2 Rëndësia e sociologjisë në edukimin qytetar të nxënësve dhe vështirësitë gjatë procesit të nxënies në lëndët shoqërore.

Cilësia e arsimit të djemve dhe vajzave përmes institucioneve arsimore, është tregues i zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe kulturor të një vendi, që i jep mundësinë çdo individi të përmirësojë mirëqenien dhe të rrisë statusin e tij social, duke e bërë më aktiv në jetën publike. Kjo ndodh sepse, përveç pajisjes së nxënësve me njohuri dhe dije shkencore, mbetet qëllim parësor dhe detyrim i arsimit, edukimi i tyre me vlera qytetare, demokratike dhe globale, larg çdo paragjykimi. Nga ana tjetër, qëllim po aq i rëndësishëm i arsimit është të krijojë njerëz, që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, krijues, shpikës dhe zbulues, të formojë mendje, që të mund të jenë kritike, që të verifikojnë dhe jo të pranojnë çdo gjë që u jepet. Zhvillimi i të menduarit kritik të nxënësve duhet të jetë një nga synimet e shkollës dhe të gjitha elementeve të saj, si planeve mësimore, programeve, teksteve shkollore dhe kurrikulave të arsimit në të gjitha nivelet. Studime të shumta të kryera në fushën e pedagogji-psikologjisë, kanë trajtuar probleme të ndryshme që hasen në mjediset mësimdhënëse. Duke u bazuar në teoritë dhe analizat sociologjike të këtyre fenomeneve, duhet të jemi në gjendje të hartojmë strategji efektive, të cilat t'u përgjigjen sfidave, për të shfrytëzuar më mirë potencialet e proceseve arsimore-edukative. Një nga teoritë sociologjike të mirënjohura në këtë fushë, është ajo e *Ndërveprimit Simbolik*. Sipas Blumer (1969), asgjë nuk është e paracaktuar dhe e pandryshuar në sjelljen tonë si mësues apo si nxënës, ne mund ta ndryshojmë kuptimin e mësimdhënies/nxënies përmes ndërveprimeve tona sociale brenda mjedisit të auditoreve, duke mësuar prej tyre. Ndodh shpesh, që brenda orëve të mësimi të ndryshojnë vlera, opinione dhe bindje, jo vetëm tek nxënësit, por edhe tek mësuesit. Ky proces i rëndësishëm socio-pedagogjik, i cili quhet *formimi i sjelljes së re*, bën të qëndrueshme jo vetëm dijen e marrë, por dhe modelin e sjelljes së brendësuar. Por, mësuesit duhet të marrin parasysh formimin e mëparshëm të identitetit të nxënësve, të cilët vijnë nga nivele të ndryshme formimi socio-kulturor. Për këtë qëllim, ai duhet të përdorë metoda të larmishme mësimdhëniejeje, për të nxitur bashkëpunimin dhe për të arritur gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënies. Një pjesë e mirë e nxënësve do të ndjeheshin të përjashtuar nga dija dhe praktikat mësimore, nga diskutimet dhe debatet në klasë, nëse mësuesi me teknikat e tij nuk arrin të përfshijë eksperiencat e tyre jetësore gjatë zhvillimit të mësimi.

Teoria e të Mësuarit Social- Kjo teori arsyeton se fëmijët, gradualisht, zhvillojnë kuptimin mbi botën, duke ndërvepruar në mënyrë të vazhdueshme me të tjerët. Ata mësojnë rregullat e para të sjelljes nga prindërit, prandaj një numër i madh çrregullimesh të karakterit dhe sjelljes, janë pasoja të gabimeve ose

mangësive në edukimin familjar. Por, në këtë proces të gjatë dhe të rëndësishëm të socializimit, luajnë rol edhe faktorë të tjerë, si institucionet parashkollore dhe shkollat në të gjitha nivelet, të cilat konsolidojnë modelet e sjelljes së fëmijëve në raportet me moshatarët dhe mësuesit dhe që në fakt, duhet të plotësojnë mangësitë e njëri-tjetrit në veprimtarinë edukuese të tyre. Sa më aktive të jenë këto procese dhe metodat që përdoren në procesin mësimor, sa më shumë të nxitet bashkëpunimi mes nxënësve, aq më sociale do të jetë sjellja e tyre dhe aq më të lirë dhe kritikë do të jenë në gjykimet për veten dhe të tjerët. Megjithatë, nuk mund të mohojmë se arritjet në shkollim, varen edhe nga tipare individuale të personalitetit, aftësisë për vetëkontroll, për të vendosur objektiva dhe për të gjetur rrugët dhe mundësitë e realizimit të tyre. (Fig.1).

Teoria e të mësuarit social dhe aplikimi i saj në klasë, lidhet me krijimin e sjelljes së re tek nxënësit. Për këtë qëllim, studiues, mësues, politikëbërës, duhet të përpiqen të japin udhëzime dhe rrugët e mundshme, për të organizuar dhe strukturuar të gjitha marrëdhëniet ndërvepruese në mjediset shkollore, në mënyrë që të gjithë nxënësit të arrijnë të realizojnë potencialin e tyre të plotë. Krijimi dhe zbatimi i modeleve të përshtatshme pedagogjike dhe metodave të reja të mësimdhënjes, kërkon që mësuesit:

- Të nxisin vetëbesimin dhe iniciativën e lirë njëlloj tek të gjithë nxënësit;
- Të përgëzojnë çdo përpjekje dhe arritje të nxënësve, brenda dhe jashtë procesit mësimor;
- Të nxisin mendimin kritik, krijues dhe gjykimin e pavarur të nxënësve;
- Të krijojnë një klimë bashkëpunimi dhe tolerance, duke shmangur çdo lloj paragjykimi dhe diskriminimi.




Figura nr.1: Modeli i të Mësuarit Social

Vështirësitë gjatë procesit të nxënies në lëndën e qytetarisë.

Vështirësitë e arsimit sot në të gjithë botën janë të njohura. Ky është një diskutim që e ndeshim shpesh në mjediset arsimore dhe që shqetësojnë jo vetëm mësuesit, por dhe specialistët e arsimit, studiuesit, prindërit, etj. Nxënësit nuk kanë dëshirë të mësojnë, nuk janë të vëmendshëm dhe kanë humbur interesin për shkollën dhe librin. Kjo lidhet me një sërë faktorësh, ku më i rëndësishmi është zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i gjerë i saj në të gjitha fushat dhe nga të gjitha moshat, por kryesisht nga brezi i ri. Sot, libri dhe mësuesi nuk janë më burimet e vetme të dijes, për shkak se nxënësit informohen në forma të ndryshme, përmes shoqërisë, medias dhe internetit, duke humbur interesin për mësimin. Mësuesit sot, duhet të luajnë rolin e një edukatori dhe udhërrëfyesi, që drejton dhe lehtëson procesin e të nxënies. Kjo nxjerr si detyrë mjaft të rëndësishme organizimin e mësimin në forma dhe rrugë

të reja tërheqëse, bashkëkohore dhe praktike, në mënyrë që nxënësi të përfshihet në procesin e nxënies dhe të ndihet i dobishëm gjatë orës së mësimi. Këtu vështirësia qëndron, së pari, në aftësitë ndërvepruese të nxënësve, për shkak të veçorive të zhvillimit të tyre psikologjik dhe social, të cilat ndikojnë shumë gjatë procesit të nxënies. Së dyti, tek formimi i mësuesve, këndvështrimi dhe besimet e tyre për çështjet që trajtohen. Mësuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rolin pozitiv që luajnë në formimin e nxënësve, duke mbajtur qëndrime të ekuilibruara gjatë diskutimeve, larg stereotipeve dhe paragjytimeve, ashtu si në të kundërt mund t'i nxisin ato qoftë në mënyrë të pandërgjegjshme. Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i nxënësve, ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shmangien e sjelljeve paragjyquese dhe diskriminuese. Roli i edukatorit është të krijojë një klimë besimi dhe respekti reciprok ku secili të shprehë mendimet dhe opinionet e veta, pa u paragjykuar nga të tjerët.



Faktorët që ndikojnë në edukimin qytetar të nxënësve

Ndodh shpesh që mësuesit të jenë bartës të paragjytimeve, për shkak të formimit social-kulturor, prejardhjes dhe modeleve të edukuara në familje, që paraqet rrezik në përcjelljen e tyre tek nxënësit. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm, jo vetëm për paragjykimet dhe qëndrimet e njëanshme, por dhe të gatshëm dhe të hapur për të ndryshuar besimet dhe sjelljet e tyre. Ata duhet të përdorin metoda të reja të mësimdhënies, të cilat synojnë zhvillimin e aftësive individuale dhe përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të mësuarit, që do të thotë mësimi me në qendër nxënësin. Të shohim konkretisht disa nga problematikat që hasen gjatë trajtimit të tematikave të caktuara. Edukimi me ligjin, është një pjesë e rëndësishme e formimit të nxënësve, që ka për qëllim kuptimin mbi ligjin si mbrojtje për të gjithë, si dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për rëndësinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme. Kjo ndihmon në formimin e një ndërgjegje qytetare dhe rrit pjesëmarrjen e tyre në jetën politike të vendit në të ardhmen. Të gjithë ne në jetën e përditshme, në aktivitetet tona më të zakonshme, ndeshim me ligjet dhe sistemin ligjor, i cili rregullon këto marrëdhënie. Prandaj, megjithëse mund të mos kemi patur probleme ligjore dhe shkelje të të drejtave tona, gjithësecili duhet të dijë më shumë rreth tyre dhe përgjegjësi që kemi në lidhje me të tjerët. Nxënësit duhet të arsyetojnë mbi sjelljet e tyre të përditshme, duke vlerësuar veprimet e gabuara dhe ato që mund të bëjnë më mirë, për të mos shkelur një ligj apo të drejtën e dikujt tjetër. Kështu p.sh., veprimet që ata kryejnë gjatë një dite të zakonshme, si përdorimi i transportit urban, ardhja në shkollë, ndërveprimet me shokët dhe shoqet, raportet me mësuesit, koha e lirë gjatë pushimeve në shkollë, një ndeshje konkurruese sportive mes klasave, etj., mund të jenë shembuj konkretë, që mësuesi i

përdor si metodë, ku nxënësit arsyetojnë mbi sjelljet e tyre. Përmes diskutimeve, nxënësit arrijnë të evidentojnë vlerat njerëzore dhe qytetare që qendrojnë në themel të këtyre veprimeve, si drejtësia, ndershmëria, përgjegjshmëria personale, respekti, etj. Morëm si shembull ligjet dhe sistemin ligjor, por shembuj praktikë mund të jepen nga mësuesit në tema të ndryshme të sociologjisë, duke e sjellë atë më afër jetës së nxënësit. Metodologjia që duhet të përdoret në këtë lëndë, si rrjedhojë, lidhet me disa hapa kryesorë: 1- dhënia e shembujve faktikë (shifra dhe fakte, histori, situata rasti hipotetike apo reale, unikale dhe përgjithësuese, etj.); 2- diskutime rreth situatës së dhënë dhe qëndrimet e secilit nxënës ndaj saj; 3- eksplorime të kontekstit ligjor, social, etik, moral, ekonomik, etj.; 4- reflektimi mbi pasojat e situatës, për grupe të ndryshme të interesit dhe mbrojtja e tyre ligjore dhe sociale; 6- veprimi që duhej të ndërmerrej, nëse do të ishte i nevojshëm. Disa nga metodat e mësimdhënies/nxënies, si diskutime dhe debate, punë në grupe, lojë në role, etj., janë të njohura për mundësinë që u japin të rinjve për t'u shprehur lirisht, në një klimë besimi dhe respekti reciprok. Për këtë qëllim, mësuesi duhet të bëjë kujdes për t'i dhënë mundësinë çdo nxënësi të flasë, duke respektuar opinionet dhe gjykimet e secilit. Kryesisht puna në grupe nxit socializimin e të rinjve dhe ndërveprimin mes tyre. Grupi duhet t'i stimulojë pjesëmarrësit të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të pranojnë bindje të ndryshme nga të tyret. Po kështu, metoda e lojës në role i ndihmon nxënësit të shohin pasojat e veprimeve të tyre ndaj të tjerëve, duke i bërë më të përgjegjshëm. Përfshirja e nxënësve në situata të ndryshme, duke nxitur diskutimet, mund të sjellë kënde të ndryshme shikimi dhe trajtimi të tyre, si dhe mund të nxjerrë në pah problemet dhe dilemat që ata kanë. Duke i dhënë mundësinë të rinjve të edukohen mendjehapur, ne i kthejmë ata në agjentë të ndryshimit drejt një bote pa paragjykime. Por, diskutimet në lëndët shoqërore, konkretisht në sociologji, ndryshojnë nga lëndët e tjera, si në natyrën e çështjeve që trajtohen, ashtu dhe në argumentet e dhëna. Ato lidhen me mënyrën sesi ne e perceptojmë shoqërinë në të cilën do të dëshironim të jetojmë dhe rrugët përmes të cilave arrihet ky qëllim. Çështjet e trajtuara nga kjo lëndë janë shpesh të kontestueshme dhe kanë të bëjnë me të drejtat dhe përgjegjësitë, ligjet dhe drejtësinë, apo situata të ndryshme sociale, në të cilat të drejtat janë në konflikt me njëra-tjetrën. Nga ana tjetër, siç e përmendëm më lart, këto çështje janë shumëdimensionale dhe përfshijnë më shumë disiplina sesa thjesht sociologjia, sepse lidhen me më shumë se një fushë të jetës shoqërore, siç janë politika, ligjet, morali, etika, etj. Prandaj, praktikat mësimore në këto lëndë duhet të synojnë ndërveprimin mes nxënësve, duke respektuar të drejtat dhe identitetin e secilit prej tyre dhe duke hedhur kështu bazat e edukimit qytetar. Një nga rrugët për të arritur një mësimdhënie të suksesshme është njohja e mirë nga mësuesi, jo vetëm e përmbajtjes dhe qëllimit të kurrikulës, apo programit të lëndës, por edhe të aspekteve të zhvillimit emocional, aftësive njohëse dhe të nxënies tek nxënësit. Mënyra sesi ata ngrenë shqetësimet dhe shprehin argumentet e tyre, varen shumë nga formimi i tyre i mëparshëm, prandaj mësuesit duhet t'i ndihmojnë të arsyetojnë mbi rrugët e zgjidhjes dhe të reflektojnë mbi efekshmërinë e tyre, duke studiuar dhe pasojat për secilën mundësi. Mësuesit duhet të përpiqet që nxënësit në këtë lëndë, jo vetëm të zgjidhin situata gjatë orëve të mësimi, por që njohuritë e marra të transferohen në situata të reja. Dy nga metodat më të rëndësishme që janë në qendër të mësimdhënies dhe të mësuarit të lëndës së sociologjisë, janë debati dhe dialogu, sepse përmes tyre stimulohen mendimet e nxënësve dhe aftësia e tyre për t'u angazhuar në debatin publik, si një tipar i rëndësishëm i qytetarit në demokraci. Nga ana tjetër, problematikat sociale, për nga vetë natyra e tyre, është më mirë të zgjidhen përmes dialogut. Kjo bën të domosdoshme një gjuhë të pasur në shprehje dhe terminologji, gjë që për brezin e sotëm është një problem më vete, në mënyrë që ata të argumentojnë dhe të mbrojnë sa më mirë qëndrimet e veta. Një problem tjetër, është se në lëndën e sociologjisë çështjet që diskutohen janë sociale, pra, në të mirë të të gjithë shoqërisë. Por, zgjidhjet që ofrohen janë shpesh në kundërshtim me interesat e individëve të veçantë. Diskutimet janë të mbartura me ngarkesa emocionale, gjë që i ndan nxënësit, por jo rrallë edhe mësuesit, në partizanë ose kundërshtarë të njërit apo tjetrit pozicion. Kështu, mund të përmendim problematikat që lidhen me paragjykimet dhe

diskriminimet me bazë raciale, kulturore, gjinore, fetare, etj. Në diskutimet e këtyre tematikave, mësuesit ankohen se nuk janë në gjendje të strukturojnë debatin mes nxënësve. Kjo ndodh sepse njerëzit kanë interesa dhe këndvështrime të ndryshme mbi jetën në shoqëri. Prandaj sociologjia si lëndë nuk do të thotë "vetëm të flasim", por përmes dialogut të gjeihen zgjidhjet më të pranueshme për shoqërinë. Në këto raste, kur tensioni është i lartë, mësuesi organizon një debat të strukturuar, ku gjithsecili respekton fjalën e tjetrit dhe më pas shtron pikëpamjet dhe argumentet e veta. Mësuesi i bën të qarta kushtet e debatit që në fillim dhe disa prej tyre mund të jenë:

- gatishmëria për të dëgjuar të tjerët;
- respekti për të vërtetën dhe provat;
- gatishmërinë për të rishikuar pozicionin e secilit, nën dritën e dëshmive dhe / ose argumenteve.

Angazhimi efektiv në debat, po ashtu, varet nga aftësia për të ndërtuar argumente që janë logjike, si dhe për të njohur gabimet e arsyetimit në argumentet e të tjerëve. Nxënësit duhet të mësohen:

- të përdorin imagjinatën e tyre për të marrë parasysh përvojat e njerëzve të tjerë;
- të jenë të aftë për të menduar, shprehur dhe shpjeguar pikëpamjet që nuk janë të tyre;
- të jetë të aftë për të negociuar dhe zgjidhur problemet;
- të jenë të aftë të angazhohen në diskutime dhe debate, përmes argumenteve të mirëarsyetuara;
- të jenë të aftë të mbrojnë me gojë dhe me shkrim qëndrimin e tyre rreth problemit të debatuar.

Pjesëmarrja aktive në orët e mësimit, debati dhe dialogu, diskutimet e vazhdueshme, qëndrojnë në zemër të lëndës së sociologjisë. Në këtë mënyrë, kjo lëndë i ndihmon nxënësit të bëhen qytetarë të informuar, të mençur, të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për detyrat dhe të drejtat e tyre. Kjo pjesëmarrje në diskutime rrit vetëbesimin dhe i inkurajon ata të jenë aktivë dhe të dobishëm në jetën sociale jashtë shkollës, në lagjet e tyre, në komunitet dhe më gjerë. Duke diskutuar p.sh., rreth ekonomisë së vendit dhe asaj globale, ata orientohen më mirë në tregun e punës, apo duke mësuar për institucionet e ndryshme dhe vlerat demokratike, respektojnë më shumë identitetet kombëtare, fetare, etnike, etj. Por, sikurse pjesëmarrja e njerëzve në shoqërinë reale është e vështirë dhe e mbarsur me tensione dhe konflikte, ashtu edhe pjesëmarrja e nxënësve në lëndën e sociologjisë përbën një sfidë në vetvete. Klasat janë një mikrokozmos i vogël, ku përfshihen të gjitha këto tensione dhe kontradiktat reale, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në pjesëmarrjen aktive të nxënësve në orën e mësimit dhe në veprimtaritë shkollore.

Duhet pranur se në botë ka konflikte në aspektin politik, fetar, ekonomik, etj., mes vlerave të grupimeve të ndryshme. Secili nxënës përfaqëson një kulturë dhe përvojë të caktuar, të cilën e mbart nga familja dhe komuniteti nga i cili vjen, për rrjedhojë ai do të ketë këndvështrimet e tij për botën, të ndryshëm nga nxënësit e tjerë. Kjo e vështirëson bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në procesin e të nxënësve, shpesh edhe nga frika e paragjykitimit nga të tjerët. Krijimi i një klime respekti dhe besimi reciprok, i ndihmon nxënësit të rrisin vetëbesimin, të shprehin lirisht mendimet e tyre dhe të mos ndjehen të paragjykuar. Këto probleme i kanë sidomos fëmijët, që u përkasin kulturave dhe tipareve biologjike të ndryshme nga shumica tjetër, që mund të jenë pakica etnike, kombëtare, fetare, etj.

Pyetja që lind është: A do të jetë kjo përfshirje e barabartë, sikurse mësojnë në lëndët shoqërore, edhe në jetën reale? Kështu p.sh., lidhur me të drejtat universale, të barabarta dhe të patjetërsueshme të individëve njerëzor, a iu mbrohen njëllë këto të drejta në realitet? A kanë të gjithë kushte të njëjta jetese dhe mundësi të barabarta për të ecur në jetë? Kjo bën shpesh që nga këta nxënës, të humbasin besimin tek demokracia pjesëmarrëse dhe tek mundësia e gjithëpërfshirjes së qytetarëve në jetën e një vendi. Mësuesi/ja duhet të ngulmojë në theksimin e rolit të rëndësishëm të arsimimit për gjithsecilin, në mënyrë që të zvogëlohet hendeku mes individëve të shtresave të ndryshme social-ekonomike. *Hapi i parë drejt kësaj mundësie, për një përfshirje të barabartë të tyre, është aktivizimi i njëjtë i nxënësve në orën e mësimit dhe sidomos në lëndën e sociologjisë.*

1.3 Metoda mësimdhënie/nxënie në orët e sociologjisë

Të përmbledhim disa nga format që mund të nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve në orët e sociologjisë:

- Stuhi mendimesh (brainstorming). Kjo teknikë, që përdoret shpesh nga mësuesit, siguron pothuajse gjithmonë interesin dhe vëmendjen e nxënësve. Mësuesi nuk bën asnjë lloj kritike apo vlerësimi për idetë e dhëna prej tyre. Këto ide nuk i takojnë nxënësve të veçantë, por të gjithë kontribuojnë njëloj në ndërtimin e përgjigjes. Në këtë rast, cilësia është më pak e rëndësishme sesa sasia, por kjo nxit mendimin krijues të nxënësve.
- Argumentet pro dhe kundër një problematike sociale, nxisin shprehjen e opinioneve të të gjitha llojeve. Në këtë mënyrë, mësuesi e ka më të lehtë të zbulojë skemën e të menduarit tek nxënësit e tij.
- Formulimi i hipotezave të reja, mbështetur më parë në mbledhjen e të dhënave dhe fakteve (përmes hulumtimit në tekste të tjera, apo në internet), për të kundërshtuar ose mbrojtur një gjykim të caktuar, sidomos për çështje të drejtash në konflikt. Kjo mënyrë mund të përcaktohet edhe si “Avokati i djallit” dhe stimulon fleksibilitetin e të menduarit dhe aftësinë për ta parë problemin nga shumë këndvështrime, ndryshe nga opinion i të tjerëve. Kështu p.sh., në rastet ku përgjigjet nuk janë të qarta, lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë morale, sociale, etike, etj., të individit.
- Puna në grupe të vogla (6-8 nxënës), është mjaft efikase, sepse nxënësit mësojnë më shumë duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin, përmes teknikave të ndryshme, sesa mësojnë në disa raste nga vetë mësuesit. Diskutimet në grup kanë disa avantazhe. Ato rrisin thellësinë e të kuptuarit të përmbajtjes, nxisin pjesëmarrjen dhe motivimin e nxënësve në procesin e nxënies, zhvillojnë aftësitë për të zgjidhur problemet, rrisin përgjegjësinë e çdo anëtar brenda grupit, komunikimin mes tyre, si dhe nxjerrin në pah aftësitë organizative dhe udhëheqëse (lideri) të nxënësve të veçantë.

Një tjetër metodë, e cila duket e përshtatshme dhe e realizueshme, kryesisht për tema në të cilat mësuesit nuk ndjehen ekspertë të fushës, është planifikimi i disa orëve gjatë vitit (2-3 orë), në të cilat ftohen për të marrë pjesë specialistë apo njerëz të kualifikuar të këtyre çështjeve. Mësuesit mund të ftojnë p.sh. juristë apo avokatë, të cilët mund të flasin për të drejtat e njeriut, barazinë, emigracionin, punësimin, biznesmenë të suksesshëm që frymëzojnë me shembullin e tyre, ose të vizitojnë me nxënësit një zyrë avokatie, biznesi, etj. Në këtë rast nxënësit eksplorojnë atë çka ndodh në të vërtetë në praktikë, si dhe njihen me rregullat dhe ligjet që rregullojnë këto marrëdhënie. Ata mund t’u drejtojnë pyetje ekspertëve, për çështje që i kanë të paqarta, të cilat i kanë mbledhur së bashku me mësuesin/en, për të marrë një informacion më profesional dhe duke i shfrytëzuar këto burime për një përgatitje më të mirë të nxënësve në këtë lëndë. E rëndësishme është që *mësuesit e sociologjisë të jenë të mirëinformuar për ngjarjet dhe çështje të aktualitetit, për të cilat duhet të mbajnë një qëndrim të argumentuar dhe jo të bazuar në opinione personale*. Ata duhet të rrisin njohuritë në fusha të ndryshme si sociale, ekonomike, politike, të teknologjisë së informacionit, etj. me qëllim përcjelljen e tyre tek nxënësit. Kjo mbetet një sfidë e përditshme, për të qenë në kontakt me të rejat që sjell zhvillimi brenda dhe jashtë vendit. Nga ana tjetër, mësimdhënia e integruar mes lëndëve të ndryshme, ndihmon në konteksizimin e temave të veçanta mësimore të sociologjisë. P.sh., lënda e sociologjisë, qytetarisë, filozofisë, historisë etj., mund të ndërthurren së bashku në projekte ndërlëndore, të cilat i përgatisin nxënësit të analizojnë problemet dhe të arsyetojnë rrugëzgjidhjet në një një rrafsh më të gjerë njohurish. Po ashtu, përdorimi i teknologjisë së informacionit në ditët e sotme, është një mundësi më tepër për nxënësit, për të eksploruar mbi tema të

caktuara, që orientohen nga mësuesi. Në formëm e një minikërkimi shkencor, ata mësojnë të hulumtojnë të dhëna, shifra dhe fakte, apo opinione të specialistëve të fushës. Burimet e informacionit janë të shumta dhe të hapura për t'u shfrytëzuar nga të gjithë. Puna kërkuese e pavarur duhet të inkurajuar vazhdimisht nga mësuesit, sepse zhvillon tek ata mendimin kritik dhe të pavarur. Mbledhja e informacionit mund të caktohet nga mësuesja si detyrë shtëpie, duke e kombinuar më pas në klasë me punë të pavarur, në grupe ose individuale, me qëllim përpunimin e të dhënave të mbledhura dhe krahasimin e tyre, duke mbërritur në konkluzione përmes diskutimeve dhe debateve.

Një nga teknikat më të vështira, që shpesh bëjnë diferencën e mësuesve në efikasitetin e punës së tyre, janë pyetjet dhe mënyra e ndërtimit të tyre. Studiues të ndryshëm kanë hulumtuar mbi këtë çështje dhe kanë argumentuar se ka dy lloje pyetjesh, ato me fund të mbyllur, që kanë një përgjigje të njohur dhe të saktë të një informacioni faktik dhe pyetje me fund të hapur, të cilat i japin mundësinë nxënësit të argumentojë, të ngrej hipoteza të reja dhe të vlerësojë, pra kërkojnë një nivel më të lartë të menduari. Është vërejtur nga studimet të shtrira në kohë, se nxënësit që mësohen me pyetje të hapura kanë rezultate më të larta në arritjet e tyre sesa në rastin e parë. Studimet tregojnë gjithashtu, sesa më shumë mësuesi/ja ndërhyjnë në përgjigjet e nxënësve, sa më shumë flet ai/ajo, aq më pak mundësi kanë ata të përqëndrohen dhe të japin opinionet e tyre rreth pyetjes së bërë. Në rastet kur mësuesit u drejtojnë pyetje nxënësve, përgjithësisht u japin pak kohë për t'u menduar (rreth 2 sekonda), më pas flasin përsëri dhe ndërhyjnë me një pyetje tjetër. *Hulumtimet tregojnë se nëse mësuesit presin të paktën 3 sekonda, kanë mundësi të marrin më shumë përgjigje dhe të një niveli më të lartë të të menduarit.* Po ashtu nëse mësuesit kanë tendencën për të vënë në dyshim atë çka thotë nxënësi, me qëllim stimulimin e të menduarit, më shpesh shkaktojnë të kundërtën, në krahasim me mësuesit të cilët presin *me durim* që përgjigja e nxënësit të jetë më e qartë, pa bërë pyetje të vazhdueshme dhe të njëpasnjëshme. Përgjithësisht, pyetjet drejtohen nga mësuesit, duke dominuar kështu rrjetin e diskutimeve dhe duke mos i dhënë mundësinë nxënësve të *gjenerojnë vetë pyetje*, të paktën atëherë kur kjo është e mundur. Disa nga pyetjet që provokojnë të menduarin kritik qytetar janë: *A mendoni se është e drejtë? Duhet të ketë një ligj në lidhje me të? Çfarë argumenti do të përdornit, për të bindur dikë? Çfarë do të ishte më e mirë për shoqërinë? Çfarë do ta bëjë situatën më të barabartë? Kush e mban përgjegjësinë për këtë veprim? Kush i paguan pasojat në shoqëri? Çfarë ju bën të ndiheni më keq në këtë situatë? A kanë të drejtë personat në fjalë ta kryejnë këtë veprim? Nga i buron kjo e drejtë? Si mund të ndërtohej një kompromis i mirë?* etj.

Nga studimet rezulton se mësuesi përveç rolit të udhëheqësit dhe menaxhuesit të diskutimeve dhe debateve në klasë, shërben si *një model sjelljeje* për nxënësit e tij. Mënyra sesi mësuesi/ja logjikon apo përdor arsyetimin reflektues, në shumicën e rasteve ndikon që nxënësit të përdorin të njëjtën rrugë të menduari. Mënyra se si mësuesi/ja vepron kur nxënësit përgjigjen dhe debatojnë me njëri-tjetrin, edukon të njëjtën mënyrë sjelljeje tek auditori ku zhvillon mësimin. Mësuesi/ja duhet të përpiket sa herë të jetë e mundur, të edukojë sjellje dhe aftësi qytetare të pjesëmarrjes në debate publike. Ai/ajo përpiket të vlerësojë të gjitha format alternative të mendimit, duke u përpjekur për ta parë një situatë nga të gjitha këndvështrimet e sjella nga nxënësit në klasë, duke u bazuar përherë në prova, fakte dhe argumente. Po aq e rëndësishme për lëndën e sociologjisë, është jo vetëm marrja e njohurive mbi kulturën, problemet sociale dhe praktikën e demokracisë në vend dhe më gjerë, por dhe *zhvillimin e aktiviteteve* jashtë saj, me qëllim edukimin dhe përgatitjen e nxënësit për të qenë i aftë të zgjidhë problemet jashtë shkollës. Ata duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të zotërojnë vetëdijen kritike, për t'u bërë të dobishëm në jetën e komunitetit ku jetojnë. Përmes lëndës së sociologjisë, nxënësit edukohen të jenë të përgjegjshëm në sjelljet e tyre brenda dhe jashtë mjedisit të shkollës. Ata zhvillojnë aftësitë për hetim dhe komunikim, mësojnë të jenë aktiv dhe pjesëmarrës në aktivitete dhe në shërbimet në komunitet, përgatiten për të qenë qytetarë të informuar dhe të interesuar për problemet që shqetësojnë, jo vetëm pjesën ku jetojnë, por edhe më gjerë.

Sipas studiuesve, në lëndën e sociologjisë, vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të bëhet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

1-Shkalla e përvetësimit të njohurive dhe koncepteve teorike të lëndës.

2- Aftësitë e hetimit dhe komunikimit: Nxënësit duhet të mësohen të hulumtojnë çështjet aktuale politike, shpirtërore, morale, sociale apo kulturore të kohës, duke analizuar probleme apo ngjarje nga burime të ndryshme informacioni, përfshirë dhe internetin.

2- Aftësia shprehëse për të mbrojtur mendimin e tij personal, me gojë ose në punët me shkrim, lidhur me situata, ngjarje, probleme të caktuara shoqërore.

3- Aftësia për të marrë pjesë në debate në klasë dhe bashkëpunime në grup, duke kontribuar në diskutimet eksploruese për zbulimin e rrjetit shkak-pasojë të fenomenit.

4- Aftësia për të qenë mirëkuptues dhe tolerant ndaj përvojave të njerëzve të tjerë, duke vlerësuar në mënyrë kritike mendimet dhe opinionet që nuk janë të tyre.

5- Përgjegjshmëria në pjesëmarrjen në punët e pavarura (projektet, detyra shtëpie), aktivitete ose veprimtaritë praktike, të cilat organizohen nga mësuesi në varësi të programit të lëndës dhe metodologjisë së përdorur.

Bazuar në këto kriterë, për mësuesin do të ishte e lehtë ndoshta të vlerësonte pikën e parë, por të tjerat do të ishin më të vështira për t'u matur. Për këtë arsye, për mësuesit do të nevojitej, përveç zotërimit të mirë të lëndës nga ana teorike dhe profesionale, intuitë pedagogjike, përvojë dhe trajnime të vazhdueshme.

1.4. Kurrikula me bazë kompetencat dhe shkencat sociale

Kurrikula zyrtare jep mesazhet qendrore të arsimit, ajo mund të rrisë, apo të ulë motivimin e nxënësve për angazhim, përpjekje dhe zhvillim, përmes imazheve që u jep për veten e tyre dhe botën ku jetojnë. Nëse kurrikula nuk pasqyron diversitetin e jetës dhe interesat e nxënësve, mesazhi i saj nuk është i plotë. Qasja e re kurrikulare në arsimin shqiptar, që përqendrohet në zhvillimin e kompetencave tek nxënësit, kërkon ndryshime edhe në metodat dhe format e punës. Kjo nënkupton që:

- Metodën e mësimdhënies duhen përshtatur me nevojat individuale, interesat dhe veçoritë e nxënësve, me qëllim që të sigurohet suksesi i secilit prej tyre;
- Duhet pranuar nga mësuesit, që stilet e të nxënësit ndryshojnë nga një nxënës tek tjetri;
- Duhet përzgjedhur metoda, teknika dhe strategji të mësimdhënies, që nxitin përfshirjen aktive të nxënësve në orën e mësimi;
- Duhet përdorur burime të ndryshme të të nxënësit, që nxitin pjesëmarrjen, vëzhgimin, pavarësinë, kërkimin dhe kureshtjen e nxënësve;
- Duhet krijuar një mjedis i këndshëm e miqësor në klasë, me qëllim që të nxitet interesi dhe motivimi i nxënësve për të nxënë.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme të punës, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve, në mënyrë që të integrojnë njohuritë përkatëse me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet. Kurrikula zyrtare orienton disa nga metodat, teknikat dhe strategjitë që mund të përdoren në lëndët shoqërore, si p.sh., diskutimi, debatet, vërtetimet, intervistat, projektet kurrikulare dhe ndërkurrikulare, etj. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar mënyrat e ndryshme të të nxënësit të tyre.

Zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike, ofrojnë sfida të vazhdueshme për brezin e ri, i cili ka nevojë të pajiset me kompetenca të reja, që e ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme. Kjo lidhet, jo vetëm me fitimin e njohurive dhe aftësive teknike, por edhe me të kuptuarit e mundësive, sfidave, çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore, që lindin ose shoqërojnë këto ndryshime. Kompetencat-kyç lidhen me zhvillimin e aftësive të nxënësve për të nxënë, për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, për

komunikim, vetëbesimin dhe besim tek të tjerët, për pjesëmarrje aktive në shoqëri, si individë të përgjegjshëm të një shoqërie globale dhe diverse. Ndërkohë që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut. Nxënësi vlerëson diversitetin, respekton të tjerët, përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise. Programi i lëndës sociologji për klasën XII-të është hartuar në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat, një përmbledhje e të cilave, rezulton si më poshtë:

Kompetenca qytetare

Programi i sociologjisë, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së sociologjisë nxisin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i *sociologjisë* krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj. në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet.

Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i *sociologjisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur formimin sociologjik, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të

njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i sociologjisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.




Fig.2: Kompetencat kyçe sipas kurrikulës së re 2016

1.5 Qëllimet e programit të sociologjisë

Sipas Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institutit të Zhvillimit të Arsimit, lënda “Sociologjia 12” synon:

1. t’u ofrojë nxënësve njohuritë e nevojshme dhe t’u kultivojë aftësitë intelektuale për të analizuar dukuritë, proceset e zhvillimet më të rëndësishme të shoqërisë;
2. të kultivojë aftësitë për t’u angazhuar në zgjidhjen praktike të problemeve të ndryshme shoqërore që kanë të bëjnë me individin, me grupime shoqërore të caktuara ose me gjithë shoqërinë;
3. të kultivojë vetëdijen dhe përkushtimin për respektimin e vlerave, normave kulturore e ligjore si kusht i domosdoshëm për bashkëjetesën në shoqërinë bashkëkohore.

Misioni i lëndës sociologjia është zhvillimi i aftësive të tilla si:

- aftësia për të menduar në mënyrë kritike;
- aftësia për të menduar në mënyrë krijuese;
- aftësia për të zbatuar njohuritë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në jetën e përditshme;
- aftësia për të parashikuar ecurinë e proceseve të caktuara shoqërore në të ardhmen, së paku të afërt;
- aftësia për reflektime dhe arsyetime me vlerë morale e shoqërore.

Në misionin e kësaj lënde bëjnë pjesë edhe aftësitë për të kultivuar modele të sjelljeve shoqërore, si: aftësia për të përshtatur modele sjelljesh me të pëlqyeshme për shoqërinë ose të paktën për klasa ose shtresa të caktuara të saj;

- aftësia për t'u orientuar në procesin kompleks të komunikimit me anëtarë të subkulturave të ndryshme.
- aftësia për qenë sa më i efektshëm në angazhimet si veprimtar për zgjidhjen e problemeve shoqërore;
- aftësia për të parashtruar një problem shoqëror dhe për të argumentuar rrugëzgjidhjen e tij;
- aftësia për të parandaluar edhe tejkaluar konfliktet në bashkëveprimet e shumëllojshme me individë ose grupe shoqërore të caktuara;
- aftësia për t'u orientuar në shoqëritë dhe sistemet e tjera kulturore, kur mund të punojë e jetojë si student, si emigrant etj.;
- aftësia për të çmuar me frymë relativiteti vlerat, normat dhe elementet e tjera të sistemeve kulturore të vendeve të tjera;
- aftësia për t'u orientuar drejt lëvizjeve shoqërore përparimtare.

Përveç përvetësimit të koncepteve dhe të vlerave kryesore, aftësimi për t'u orientuar dhe për t'u angazhuar në veprimtari të ndryshme shoqërore, politike e kulturore, "Sociologjia" synon të kultivojë edhe qëndrime të caktuara, ndjenjën e përkushtimit për t'u angazhuar gjithnjë në anën më të përparuar të çdo fushe të jetës e të veprimtarisë, ndjenjën e përkushtimit ndaj vlerave me rëndësi jetike për ekzistencën dhe funksionimin e shoqërisë si:

- bindja për zbatimin me korrektësi të kërkesave të vlerave dhe të normave kulturore dhe ligjore sunduese në shoqëri;
- bindja se funksionimi normal i shoqërisë bazohet kryesisht në veprimtarinë paqësore të individëve dhe të grupeve shoqërore;
- bindja se është detyrë e çdo anëtar të shoqërisë të ndihmojë në formë të ndryshme për kapërcimin e dukurive e të problemeve që shqetësojnë shoqërinë, grupe të caktuara e deri individuale të veçantë;
- kultivimi i shpirtit kritik dhe kundërshtues ndaj të gjithë formave të paragjykimëve dhe diskriminimeve që kanë të bëjnë me përkatësinë gjinore, racore, etnike, kulturore, subkulturore etj.
- vlerësimi i elementeve përparimtare të çdo kulture dhe çdo shoqërie si pasuri e gjithë njerëzimit etj.

1.6 Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Kompetenca qytetare

Programi i sociologjisë, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së sociologjisë nxisin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i *sociologjisë* krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj. në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet.

Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i *sociologjisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur formimin sociologjik, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i *sociologjisë* nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

1.7 Lidhja e lëndës së sociologjisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së sociologjisë fokusohet në zhvillimin e temave të

mëdha ndërkurrikulare si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedis.
- Ndërvlerësim.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e sociologjisë, nxënësi ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvlerësimin e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvlerësimin e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë, ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale.

Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvlerësimin dhe bashkëjetesën paqësore.

1.8 Lidhjet e lëndës së sociologjisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxëniet

Sociologjia - Matematika

Nxënësi/ja:

- llogarit koeficientë të ndryshëm si koeficienti i vrasjeve ose i vetëvrasjeve, llogarit peshën specifike (përqindjen) për çështje demografike, për dukuri të tjera sociale etj.;
- paraqet në mënyrë grafike ecurinë e dukurive të ndryshme shoqërore etj.

Sociologjia - Biologjia

Nxënësi/ja:

- shpjegon marrëdhënie specifike ndërmjet përbërjes biologjike dhe prirjeve për reagime të caktuara të njerëzve në situata shoqërore të veçanta;

Sociologjia - Psikologjia

Nxënësi/ja:

- përshkruan "mekanizmat" psikologjike të ndikimit të nofkave përçuese në vetëperceptimin e njerëzve;
- përshkruan ndikimet psikologjike të divorcit në jetën e ish-bashkëshortëve dhe sidomos të fëmijëve të tyre.

Sociologjia - Historia

Nxënësi/ja:

- parashtron ecurinë e zhvillimit të dukurive shoqërore më të rëndësishme, së paku gjatë periudhës moderne;
- dallon dhe përzgjedh ato fakte historike që ilustrojnë më mirë idetë sociologjike.

Sociologjia - Letërsia

Nxënësi/ja:

- përmend vepra letrare, të cilat me nivel të lartë artistik pasqyrojnë ngjarje shoqërore të rëndësishme;
- përmend vepra letrare, që me nivel të lartë artistik pasqyrojnë lëvizje shoqërore, të cilat kanë shënuar kthesa në historinë e shoqërisë.

1.9 Udhëzime metodologjike

Përmbajtja e lëndës së sociologjisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimdhënies dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimi nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar e sociologjik që motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dala nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

1.10 Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së sociologjisë?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

Dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënësve; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;

- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimi dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.*

Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- ✓ aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia

për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tijat;

- ✓ aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- ✓ respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- ✓ aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- ✓ aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;

- ✓ bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- ✓ aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- ✓ gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- ✓ aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.

Mjedisi i të nxënit të sociologjisë

Të mësuarit e sociologjisë nxit një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Të mësuarit e sociologjisë zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Të mësuarit e sociologjisë duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve socialë, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e studimeve sociologjike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës për të shfrytëzuar TIK-un në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjesisë shoqërore;

1.11 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi i nxënësit shtrihet gjatë gjithë procesit mësimor dhe nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës. Vlerësimi është një proces kompleks që duhet të përmirësohet në mënyrë të pandërprerë në të gjithë treguesit e vet. Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit të lëndës sociologjia dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon mënyra vlerësimi të shumëllojshme dhe angazhon edhe nxënësit në këtë proces kompleks. Vlerësimi bëhet për arritje individuale ose/dhe në grup, në klasë ose/dhe jashtë saj. Nëse nxënësit punojnë në grupe të vogla për objektiva të caktuara, mësuesi sqaron rëndësinë e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të çdo nxënësi në veçanti.

Nxënësi vlerësohet me notë ndërkohë që paraqet arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish e punimesh të caktuara.

Në orët e lëndës sociologjia nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë për përvetësimin e njohurive dhe për realizimin e detyrave të ndryshme të lëndës jashtë klase. Mësuesi duhet të vlerësojë, duke u sqaruar nxënësve pikësynimet dhe kriteret e vlerësimit.

Vlerësimi me shkrim synon të nxisë aftësimin e nxënësve për të komunikuar me shkrim sa më saktë njohuritë sociologjike. Vlerësimi me shkrim mund të realizohet në mënyrë tradicionale, me laps dhe letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi planifikon provime me shkrim për njohuritë e disa mësimave ose kapitujve, të cilat i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Përdoren lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet për objektiva të veçuar të të nxënit deri tek ata komplekse që zgjasin një që përmbajnë pyetje që testojnë saktësinë e përvetësimit të koncepteve sociologjike, pyetje që kultivojnë të menduarit kritik, krijues, eseistik etj.

Gjithashtu mësuesi vlerëson edhe paraqitjen me shkrim nga nxënësit të detyrave tematike, të projekteve kurrikulare etj. Një formë e paraqitjes me shkrim nga nxënësi është edhe provimi përfundimtar.

Një formë vlerësimi dhe vetëvlerësimi është edhe portofoli i nxënësit, çka është një përmbledhje e tij në lëndën e sociologjisë përgjatë disa muajve ose gjithë vitit shkollor.

Portofoli mund të përmbajë provime me shkrim, detyra për çështje të caktuara shoqërore, projekte kurrikulare, kaseta me intervista të incizuara, fotografi, filmime ngjarjesh të caktuara që ilustrjnë ide sociologjike të rëndësishme etj.

Përzgjedhjet për portofolin bëhet nga nxënësi, ndërkohë që mësuesi është në rolin e këshilluesit.

Nxënësit që kanë jetuar për disa vite në sisteme të tjera kulturore si bij ose bija të familjeve të emigrantëve në forma të ndryshme mund të ofrojnë edhe për nxënësit e tjerë të klasës përvojën e tyre të komunikimit ndërkulturor. Përvoja të tilla të gjalla janë shembuj që përvetësohen në mënyrë të natyrshme nga nxënësit adoleshentë.

Në vlerësimin e nxënësve në lëndën sociologjia është mirë të mbahen parasysh edhe refleksionet e tyre për veprimtari të ndryshme shoqërore jashtë mjediseve të shkollës, sidomos në ato me profil altruizmi më të spikatur si veprimtaria vullnetare, ku nxënësit janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë. Theksojmë se nuk do të vlerësohet pjesëmarrje e nxënësit, por aftësitë e tij vetjake intelektuale për të reflektuar rreth veprimtarive të tilla.

Përreth formimit teorik-intelektual lënda “Sociologjia” do të ndikojë edhe shoqërizimin e nxënësve adoleshentë me cilësitë më të mira të veprimtarit shoqëror me personalitet të afirmuar, si: dinjiteti vetjak, aftësia për të gjykuar në mënyrë të pavarur rreth problemeve të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, aftësitë për t’u pozicionuar në anën e grupimeve shoqërore që ofrojnë zgjidhje më përparimtare, aftësia për t’u informuar në mënyrë dinamike për zhvillimet shoqërore në vendin tonë dhe në vendet më me ndikim në shkallë botërore, aftësia për të nxjerrë përfundime teorike e praktike nga lëvizje të ndryshme shoqërore, vetëdija për të zbatuar me korrektësi normat kulturore e ligjore sunduese të shoqërisë etj.

Natyrisht, nxënësi nuk do të vlerësohet për modelet e sjelljeve të tij vetjake, por për argumentimin e domosdoshmërisë së modeleve të sjelljeve të caktuara në mjedise përkatëse etj.

Përvetësimi i njohurive sociologjike, kultivimi i aftësive intelektuale dhe motivimi për t’u përfshirë në veprimtari shoqërore të shumëllojshme realizohen në mjedise të ndryshme si shkolla, familja, bashkësia e banorëve të lagjes etj. Këto përbëjnë fushat kryesore në të cilat fitohen njohuritë e aftësitë dhe njëherazi zbatohen në praktikë. Në rrethana të tilla një mundësi e mirë për të vlerësuar aftësitë intelektuale në procesin e zbatimit të njohurive dhe të pjesëmarrjes në veprimtari shoqërore janë projektet që përfundojnë në një produkt të caktuar si një portofol individual, grupi ose klase, realizimi i një konkurimi në nivel klase, shkolle ose edhe më gjerë ku nxënësit të paraqesin ese analitike për probleme të caktuara të zhvillimit të shoqërisë shqiptare etj.

1.12 Materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në fushën shoqërore dhe mjedisi ndihmon në konkretizimin e ideve dhe edukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Sugjerime për përdorimin e TIK

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet eeb për njohuri për shoqërinë.
- Përdorimi i CD-ROM-it për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/a jo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm softëare-sh.

- Përdorimi i simulimeve softëare.
- Përdorimi i grafikëve softëare.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

2. Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën e filozofisë përfshin:

- 1) Planifikimin vjetor
- 2) Planifikimin për secilën periudhë (Shtator-Dhjetor; Janar-Mars; Prill-Qershor)
- 3) Planifikimin analitik të orëve mësimore
- 4) Planifikimin ditor

Plani vjetor është një plan sintetik.

Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha.

Periudhat janë:

- periudha e parë: Shtator- Dhjetor,
- periudha e dytë: Janar – Mars,
- periudha e tretë: Prill- Qershor.

2.1 Plani mësimor vjetor i lëndës

34 javë x 2 orë = 68 orë

1.	Njohuri të reja	Teori	50 orë	72%
2.	Përpunim njohurish	Përsëritje	4 orë	28%
3.		Veprimtari praktike	8 orë	
4.		Testime	3 orë	
5.		Projekt	3 orë	
6.	Gjithsej		68 orë	100%

2.2 Shpërndarja e përmbajtjes lëndore sipas tremujorëve - Sociologji 12

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës sipas tremujorëve		
	Shtator–Dhjetor 25 orë	Janar–Mars 21 orë	Prill–Qershor 22 orë
TEMATIKA 1 Kultura, individi, shoqëria (10 orë)	1.1 Përcaktimi i kulturës. 1.2 Simbolet kulturore. 1.3 Gjuha. 1.4 Vlerat kulturore. 1.5 Normat kulturore. 1.6 Larmia kulturore. 1.7 Vlerësime të kulturave: Etnocentrizmi. 1.8 Vlerësime të kulturave: Ksenocentrizmi dhe relativizmi kulturor. 1.9 Përsëritje 1.10 Veprimtari: “Trashëgimia kulturore dhe sfidat e globalizimi”.		
TEMATIKA 2 Shoqërizimi (5 orë)	2.1 Përvoja shoqërore dhe shoqërizimi. 2.2 Mjedise dhe faktorë të shoqërizimit (I). 2.3 Mjedise dhe faktorë të shoqërizimit (II). 2.4 Shoqërizimi dhe ciklet e jetës. 2.5 Veprimtari: “Media dhe shoqërizimi i të rinjve”.		
TEMATIKA 3 Devianca (10 orë)	3.1 Kuptimi sociologjik i deviancës. 3.2 Tipet kryesorë të krimit (I). 3.3 Tipet kryesorë të krimit(II). 3.4 Shpjegime të deviancës: Pikëpamjet biologjike. 3.5 Shpjegime sociologjike të deviancës. 3.6 Funksionet shoqërore të deviancës. 3.7 Veprimtari: “Sjelljet		

TEMATIKA 4 Shtresimi gjinor dhe familja (6 orë) TEMATIKA 5 Racat dhe etniciteti (5 orë) TEMATIKA 6 Analiza sociologjike e besimeve fetare (10 orë)	devijante dhe shoqëria". 3.8 Përsëritje. 3.9 Testi i tremujorit të dytë. 3.10 Projekt lëndor. Faza I. Tema: "Hartimi dhe realizimi i një ankete".	4.1 Shtresimi gjinor dhe lëvizjet feministe. 4.2 Martesa. 4.3 Familja. 4.4 Funksionet kryesore të familjes. 4.5 Divorci dhe e ardhmja e familjes. 4.6 Veprimtari: "Familja, martesa dhe sfidat e shoqërisë së sotme". 5.1 Racat dhe etnitë. 5.2 Marrëdhëniet ndërmjet grupeve racore dhe etnike. 5.3 Marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne. 5.4 Pakicat kombëtare dhe grupet etnike në Republikën e Shqipërisë. 5.5 Veprimtari: "Mirëkuptim dhe respekt mes shqiptarëve dhe pakicave". 6.1 Feja dhe funksionet shoqërore të saj. 6.2 Tipat e organizatave fetare zyrtare: Eklesia, dinominejshën dhe laicizmi. 6.3 Tipat e organizatave fetare jozyrtare: Sekti dhe kulti. 6.4 Fetë botërore: Krishtërimi, islamizmi, judaizmi. 6.5 Fetë botërore: Hinduizmi, budizmi dhe	
---	--	--	--

TEMATIKA 7 Urbanizimi dhe karakteristika të punës në shoqëritë më të urbanizuara (7 orë) TEMATIKA 8 Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore (5 orë) TEMATIKA 9 Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne (3 orë)		konfucianizmi. 6.6 Ndryshimet fetare në shoqërinë moderne. 6.7 Veprimtari: "Harmonia fetare në Shqipëri, vlerë historike dhe pasuri kombëtare". 6.8 Përsëritje. 6.9 Test: Tremujori II 6.10. Projekt lëndor. Faza II. Tema: "Hartimi dhe realizimi i një ankete".	7.1 Zhvillimi i qyteteve paraindustriale. 7.2 Industrializimi dhe zhvillimi urban. 7.3 Dukuri dhe prirje bashkëkohore të urbanizimit. 7.4 Interpretime sociologjike të jetës shoqërore në qytete. 7.5 Veçori kryesore të punës në shoqëritë moderne (ora I). 7.6 Veçori kryesore të punës në shoqëritë moderne (ora II). 7.7 Veprimtari: "Telepuna dhe rristurimi i marrëdhënieve shoqërore". 8.1 Shtresimi i shoqërisë (Sistemi i kastave). 8.2 Shtresimi i shoqërisë (Sistemi i klasave) 8.3 Ndryshimet shoqërore. 8.4 Lëvizjet shoqërore. 8.5 Veprimtari: "Lëvizja studentore e dhjetorit 1990, lëvizje historike drejt demokracisë" 9.1 Shoqëria tradicionale dhe moderne (ora I). 9.2 Shoqëria tradicionale dhe moderne (ora II). 9.3 Shoqëria pasmoderne.
---	--	--	--

TEMATIKA 10 Metodat e kërkimit sociologjik (7 orë)			10.1 Tipare të metodave të kërkimit sociologjik. Eksperimenti. 10.2 Vëzhgimi sociologjik. 10.3 Intervista sociologjike dhe studimi i dokumenteve. 10.4 Anketa sociologjike dhe kampionimi. 10.5 Përsëritje. 10.6 Test i tremujorit të tretë. 10.7 Projekt lëndor.Faza III. Prezantimi i projektit.
---	--	--	---

2.3 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe sipas tremujorëve

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE – TREMUJORI I – 25 orë
Nxënësi/ja në fund të tremujorit I: • njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj., me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. • kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë. • komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve. • vetëdijësohet për rëndësinë e ndjenjës së integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. • pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor; • vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise; • zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë; • veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, udhëzues, fjalorë, enciklopedi, radio, TV, internet, etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim; • parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media; • përdor krahasimin dhe kundërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive shoqërore; • shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të përpunuar një temë, veprimtari, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake;
- menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren);
- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
- merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë;
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

2.4 Planifikimi i orëve mësimore sipas tremujorëve (plani analitik)

N r.	Tematika	Tema mësimore	Situatë e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e	Vlerësimi	Burimet
1	TEMATIKA 1 Kultura, individi, shoqëria (10 orë)	1.1 Përcaktimi i kulturës	Në rrjedhën e historisë, shoqëritë zhvilluan veçori kulturore të ndryshme, që i dallojnë nga njër-tjetra.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, harta e konceptit, reflektim.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë, sociologjia digjitale, historia, interneti etj.
2		1.2 Simbolet kulturore	Dallimet kulturore të shoqërive shprehen në simbolet e ndryshme, që shprehin kuptime të njësuar për ta.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, organizuesi grafik.	Vlerësim i vazhdueshëm	Tekstet e lëndëve shoqërore: histori, letërsi, gjuhë, interneti etj.
3		1.3 Gjuha	Gjuha si mjet komunikimi është përdorur që në kohët e hershme dhe është zhvilluar bashkë me shoqërinë njerëzore.	Brainstorming, klaster, mbajtja e strukturuar e shënimeve, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë, sociologjia digjitale internet etj.
4		1.4 Vlerat kulturore	Historia e çdo populli nuk mund të kuptohet	Brainstorming, punë në grupe,	Vlerësim i vazhdueshëm,	Teksti i sociologjisë,

			pa vlerat e krijuara gjatë jetesës në shoqëri, që përbëjnë traditën e tij kulturore.	mbajtja e strukturuar e shënimeve, organizuesi grafik, diskutim.	vetëvlerësim, vlerësim portofoli.	burime të tjera informacioni: enciklopedi, botime, internet etj.
5		1.5 Normat kulturore	Shoqëria funksionon në bazë të rregullave morale të përcaktuara nga vetë njerëzit, që kanë rëndësi të ndryshme për ta.	Brainstorming, punë në grupe, diagrama e Venit, diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm, vlerësim portofoli.	Teksti, sociologjia digjitale interneti.
6		1.6 Larmia kulturore	Diskutime mbi larminë e traditave kulturore në Shqipëri, sipas krahinave të ndryshme.	Diskutime, punë në grupe, harta e konceptit.	Vlerësim i vazhdueshëm, në grup dhe individual	Teksti, sociologjia digjitale, enciklopedi, botime, interneti.
7		1.7 Vlerësime të kulturave: Etnocentrizmi.	Shoqëritë krijojnë paragjykitime për kulturat e tjera, duke mbivlerësuar vlerat dhe zakonet e tyre.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, shënime të strukturuar, organizuesi grafik	Vlerësimi i vazhdueshëm, vetëvlerësim.	Teksti, sociologjia digjitale, interneti.
8		1.8 Vlerësime të kulturave: Ksenocentrizmi dhe relativizmi kulturor.	Mbivlerësimi i kulturës së tjetrit është një tjetër problem i disa shoqërive, që çojnë në vlerësime të gabuara të kulturës tënde.	Brainstorming, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit.	Vlerësimi vazhdueshëm, vlerësim për tjetrin.	Teksti, sociologjia digjitale, historia, interneti etj.
9		1.9Përsëritje.	Linja I: Kultura.	Diskutime, punë grup, reflektive.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti i digjitalizuar.
10		1.10 Veprimtari: “Trashëgimia kulturore dhe globalizimi”.	Diskutime mbi rëndësinë e ruajtjes së traditës përballë një bote të globalizuar.	Harta e mendimit, punë në grupe, rrjeti i diskutimeve.	Vlerësim portofoli në grup dhe individual	Teksti i sociologjisë, filozofisë, historisë.
11	TEMATIKA 2 Shoqërizimi (5 orë)	2.1 Përvoja shoqërore dhe shoqërizimi.	Shoqërizimi si proces bazohet në përvojën e brezave lidhur me elementët e ndryshëm të kulturës.	Stuhia mendimi, organizues grafik, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti digjital, Internet etj.

12		2.2 Mjedise dhe faktorë të shoqërizimit (I).	Shoqërizimi përcaktohet nga shumë faktorë individual dhe social.	Brainstorming, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm, vlerësim portofoli.	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
13		2.3 Mjedise dhe faktorë të shoqërizimit (II).	Diskutime mbi rolin e faktorëve të jashtëm socialë në shoqërizimin e individëve.	Harta e mendimit, punë në grupe, rrjeti i diskutimeve, debat dhe dialog.	Vlerësim i vazhdueshëm, vlerësim portofoli.	Teksti digjital, foto, video, interneti.
14		2.4 Shoqërizimi dhe ciklet e jetës.	Shoqërizimi kalon në disa faza sipas grupmoshave të ndryshme.	Harta e mendimit, punë në grupe, rrjeti i diskutimeve, debat dhe dialog.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti digjital, foto, video, internet.
15		2.5 Veprimtari: “Media dhe shoqërizimi i të rinjve”.	Media është një nga faktorët e shoqërizimit, që ndikojnë tek të rinjtë në forma të ndryshme.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, prezantime, diskutime.	Vlerësim portofoli	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
16	TEMATIKA 3 Devianca (10 orë)	3.1 Kuptimi sociologjik i deviancës.	Devianca shpjegohet si një dukuri sociale që ka karakterizuar të gjitha shoqëritë, në të gjitha kohërat.	Brainstorming, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
17		3.2 Tipet kryesorë të krimit (I).	Krimet klasifikohen sipas objektit ndaj të cilit drejtohen.	Harta e mendimit (cluster), punë në grupe, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
18		3.3 Tipet kryesorë të krimit (II).	Krimet dallojnë nga rëndësia e normës që shkelin. Shembuj.	Brainstorming përjashtues, shënime në dyshe, diagrama piramidale, diskutime.	Vlerësimi përmbledhës	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
19		3.4 Shpjegime të deviancës: Pikëpamjet biologjike.	Diskutim: Devianca në disa raste që shpjegohet me shkaqe biologjike.	Brainstorming përjashtues, shënime në dyshe, diagrama	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.

				piramidale, diskutime.		
20		3.5 Shpjegime sociologjike të deviancës.	Sociologët arsyetojnë se shkaqet e deviancë janë të lidhura me faktorë socialë.	Harta e mendimit (cluster), punë në grupe, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
21		3.6 Funksionet shoqërore të deviancës.	Devianca luan disa funksione në shoqëri, me efekte të ndryshme në shoqëri.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, punë në grupe, ese argumentuese.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
22		3.7 Veprimtari: "Krimet e urrejtjes dhe pasojat shoqërore".	Krimet e urrejtjes konsiderohen si sulme ndaj individëve të bazuara në paragjykimet racore, fetare, etnike, karakteristikat personale si orientimi seksual etj.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, prezantime, diskutime, debat dhe dialog.	Vlerësim portofoli	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
23		3.8 Përsëritje e tematikës 3.	Devianca dhe shpjegimi i faktorëve që ndikojnë janë objekt i studimeve të shumta.	Brainstorming, punë në grupe, diskutime, ese argumentuese.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti digjital, foto, video, interneti etj.
24		3.9 Testi i tremujorit të parë.	Vlerësim i arritjeve së kompetencave të tremenstrit I.	Punë me shkrim	Vlerësimi individual	Teksti i sociologjisë, sociologjia digjitale.
25		3.10 Projekt lëndor. Faza I. Tema: "Hartimi dhe realizimi i një ankete".	Studimi i një ankete dhe mënyrës së ndërtimit të saj.	Punë në grupe ose individuale	Vlerësim portofoli.	Teksti i sociologjisë, modele pyetësorësh nga burime të tjera, internet.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE – TREMUJORI II - 21 orë

Nxënësi/ja:

- njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj., me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën.
- kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- vetëdijësohet për rëndësinë e ndjenjës së integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin.
- pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor;
- vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise;
- zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, udhëzues, fjalorë, enciklopedi, radio, TV, internet, etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim;
- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- përdor krahasimin dhe kundërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive shoqërore;
- shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të përpunuar një temë, veprimtari, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake;
- menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyrë/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).
- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
- merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

N r	Tematika	Tema mësimore	Situatë e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	TEMATIKA 4 Shtresimi gjinor dhe familja (6 orë)	4.1 Shtresimi gjinor dhe lëvizjet feministe.	Lufta e grave për të fituar të drejta të barabarta me burrat është e hershme.	Brainstorming, rrjeti i diskutimeve, përmbledhja pohim/mbështetje.	Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual.	Teksti mësimor, teksti digjital, interneti etj.
2		4.2 Martesa.	Institucioni i martesës luan një rol të rëndësishëm në strukturimin e marrëdhënieve shoqërore.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	Vlerësimi i vazhdueshëm në grup dhe individual.	Teksti mësimor, digjital, interneti etj.
3		4.3 Familja.	Familja mbetet elementi bazë që ndërton shoqërinë dhe siguron kohezionin social.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, harta e konceptit, reflektim.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti mësimor, digjital, internet.
4		4.4 Funksionet kryesore të familjes.	Familja është vendi ku gjithsecili edukohet, gjen dashuri dhe mbështetje.	Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, organizuesi grafik.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti mësimor, digjital, internet.
5		4.5 Divorci dhe e ardhmja e familjes.	Divorci është një problem social që prek të gjithë pjestarët e familjes, kryesisht fëmijët dhe adoleshentët.	Brainstorming, klaster, mbajtja e strukturuar e shënimeve, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë, teksti digjital, botime psikologji, internet.
6		4.6 Veprimtari: “Familja, martesa dhe sfidat e shoqërisë së sotme”.	Diskutime mbi ndryshimet që kanë ndodhur në konceptimin e familjes dhe martesës, sot.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, prezantime, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm, vlerësim portofoli.	Teksti i sociologjisë, digjitale, enciklopedi, botime, internet etj.
7	TEMATIKA 5 Racat dhe etniciteti (5 orë)	5.1 Racat dhe etnitë.	Përcaktimi i koncepteve racë dhe etni, si dhe dallimet mes tyre.	Brainstorming, punë në grupe, diskutim i strukturuar pro/kundër.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, interneti.

8		5.2 Marrëdhëniet ndërmjet grupeve racore dhe etnike.	Diskutime mbi qëndrimet paragjyqese racore dhe etnike.	Diskutime, grupet e ekspertëve, organizues grafik, përmbledhja pohim/mbështetje	Vlerësim i vazhdueshëm, në grup dhe individual	Teksti, enciklopedi, botime, interneti.
9		5.3 Marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne.	Shoqëritë moderne krijojnë marrëdhënie të ndryshme me pakicat, sipas kushteve dhe politikave të ndryshme.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, shënime të strukturuar, organizuesi grafik.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë, digjitale, enciklopedi, botime, internet etj.
10		5.4 Pakicat kombëtare dhe grupet etnike në Republikën e Shqipërisë.	Diskutim mbi qëndrimet tolerante dhe harmonike të shqiptarëve ndaj pakicave në periudha të ndryshme të historisë.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit, shënime të strukturuar, organizuesi grafik.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë, digjitale, enciklopedi, botime, internet etj.
11		5.5 Veprimtari: “Mirëkuptim dhe respekt mes shqiptarëve dhe pakicave”	Faktorët që kanë ndikuar në qëndrimet tolerante të shqiptarëve ndaj pakicave.	Grupet e ekspertëve, rrjeti i diskutimeve, debat dhe dialog, pohim/mbështetje.	Vlerësim portofoli në grup dhe individual	Teksti i sociologjisë, digjitale, filozofia, historia etj.
12	TEMATIKA 6 Analiza sociologjike e besimeve fetare (10 orë)	6.1 Feja dhe funksionet shoqërore të saj.	Lindja e fesë si nevojë e njerëzve për të shpjeguar botën.	Stuhia e mendimeve, organizues grafik, diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, filozofia etj.
13		6.2 Tipat e organizatave fetare zyrtare	Diskutime mbi tipet e organizatave fetare që nxënësit njohin.	Brainstorming, punë në grupe, përmbledhje pohim/mbështetje.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, filozofia etj.
14		6.3 Tipat e organizatave fetare jozyrtare	Organizatave fetare jozyrtare kanë si qëllim tërheqjen e sa më shumë anëtarëve të rinj.	Brainstorming, shënime të strukturuar, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, interneti etj.

15	6.4 Fetë botërore (1)	Fetë janë të shumëllojshme në përputhje me tiparet e kulturave ku janë krijuar.	Brainstorming, shënime dyshe të strukturuar, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, interneti etj.
16	6.5 Fetë botërore (2)	Disa nga fetë janë më të përhapura në shkallë botërore.	Harta e mendimit, grupi i ekspertëve, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm, në grup ose individual.	Teksti, sociologjia digjitale, interneti etj.
17	6.6 Ndryshimet fetare në shoqërinë moderne.	Gjatë zhvillimit të shoqërisë kanë ndryshuar dhe besimet fetare.	Harta e mendimit, grupi i ekspertëve, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, interneti etj.
18	6.7 Veprimtari: “Harmonia fetare në Shqipëri, vlerë historike dhe pasuri kombëtare”	Harmoni ndërjetare e shqiptarëve nënkupton respektin e ndërsjellë për fetë e ndryshme të njëritjetrit.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, prezantime, diskutime.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti, sociologjia digjitale, historia, filozofia, interneti etj.
19	6.8 Përsëritje: Linja 6.	Përfundim idesh, reflektime dhe diskutime.	Punë në grupe, diskutime, ese argumentuese.	Vlerësimi përmblendhës në grup dhe individual	Teksti, sociologjia digjitale, historia, filozofia etj.
20	6.9 Test: Tremujori II	Rishikim i njohurive të marra gjatë tremestrit II.	Punë individuale me shkrim	Vlerësim përmblendhës	Teksti i sociologjisë, digjitale.
21	6.10 Projekt lëndor. Faza II Tema: “Hartim i dhe realizimi i një ankete”.	Objekti i kësaj ankete lidhet me përzgjedhjen e studimeve universitare.	Punë në grupe (ekspertët) ose individuale, rrjeti i diskutimeve: pro/kundër.	Vlerësim portofoli në grup dhe individual.	Teksti mësimor, burime të tjera nga botime, internet etj.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE – TREMUJORI III – 22 orë

Nxënësi/ja:

- njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj., me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën.
- kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- vetëdijësohet për rëndësinë e ndjenjës së integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin.
- pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor;
- vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise;
- zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, udhëzues, fjalorë, enciklopedi, radio, TV, internet, etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim;
- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- përdor krahasimin dhe kundërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive shoqërore;
- shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të përpunuar një temë, veprimtari, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake;
- menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).
- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
- merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

1	TEMATIKA 7 Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara (7 orë)	7.1 Zhvillimi i qyteteve paraindustriale.	Industrializimi dhe zhvillimi i tregtisë ndihmojnë në zhvillimin e qendrave urbane.	Shënime të strukturuar në dyshe, marrëdhëniet pyetje – përgjigje, reflektim.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, filozofia, interneti etj.
2		7.2 Industrializimi dhe zhvillimi urban.	Urbanizimi i mënyrës së jetesës filloi të rritej nën ndikimin e zhvillimit të industrisë.	Brainstorming, lexim i orientuar, shënime të strukturuar, rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, filozofia, interneti etj.
3		7.3 Dukuri dhe prirje bashkëkohore të urbanizimit.	Rritja e qyteteve të mëdha ka sjellë përveç zhvillimit edhe pasoja negative.	Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, reflekto dhe përgjigju.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti, sociologjia digjitale, filozofia, interneti etj.
4		7.4 Interpretime sociologjike të jetës shoqërore në qytete.	Mënyra e jetesës në qytete ka veçoritë e saj në ndryshim nga jeta në fshat.	Brainstorming, shënime të strukturuar, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, filozofia, interneti etj.
5		7.5 Veçori kryesore të punës në shoqëritë moderne (ora I).	Në ekonomitë industriale të zhvilluara puna ka karakteristika të veçanta.	Brainstorming, punë në grupe, shënime të strukturuar, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, sociologjia digjitale, historia, interneti etj.
6		7.6 Veçori kryesore të punës në shoqëritë moderne (ora II).	Zhvillimi i shoqërive moderne sjell pasoja negative për punësimin e njerëzve.	Brainstorming, punë në grupe, shënime të strukturuar, diskutime.	Vlerësim vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti i sociologjisë, teksti digjital, foto, video, internet.
7		7.7 Veprimtari: “Telepuna dhe ristrukturimi i marrëdhënieve shoqërore”.	Proceset e punësimit kanë ndryshuar sepse përdoren programet kompjuterike.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, prezantime, diskutime.	Vlerësim portofoli	Teksti i sociologjisë, teksti digjital, foto, video, interneti etj.

8	TEMATIKA 8 Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore (5 orë)	8.1 Shtresimi i shoqërisë (Sistemi i kastave).	Shtresimi shoqëror është i përgjithshëm, por me tipare të veçanta në çdo shoqëri.	Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, reflektë dhe përgjigju.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë teksti digjital, internet.
9		8.2 Shtresimi i shoqërisë (Sistemi i klasave)	Në shoqëritë moderne të industrializuara bëhet mbizotërues sistemi i klasave.	Brainstorming, punë në grupe, organizuesi grafik, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë teksti digjital, internet.
10		8.3 Ndryshimet shoqërore.	Ndryshimi shoqëror është procesi i shndërrimeve në organizimin e shoqërisë.	Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, reflektë dhe përgjigju.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë teksti digjital, internet.
11		8.4 Lëvizjet shoqërore.	Lëvizje shoqërore të shumëllojshme: për të drejtat e grave, të fëmijëve, të njerëzve me ngjyrë etj.	Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, reflektë dhe përgjigju.	Vlerësimi përmbledhës	Teksti i sociologjisë teksti digjital, foto video, internet.
12		8.5 Veprimtari: "Lëvizja e Studentëve të dhjetorit 1990, demokratizimi i shoqërisë shqiptare".	Sfidat kryesore të shoqërisë shqiptare në procesin e demokratizimit.	Brainstorming, grupi i ekspertëve, prezantime, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm dhe portofoli	Teksti i sociologjisë teksti digjital, foto, video internet.
13	TEMATIKA 9 Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne (3 orë)	9.1 Shoqëria tradicionale dhe moderne (ora I).	Shoqëria moderne është përfutur nga zhvillimi i vrullshëm i industrisë.	Brainstorming, shënime të strukturuara, punë në grup, harta e konceptit, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti i sociologjisë teksti digjital, foto, video internet.
14		9.2 Shoqëria tradicionale dhe moderne (ora II).	Shoqëria moderne ka disa veçori në krahasim me atë tradicionale.	Brainstorming, punë në grupe, organizuesi grafik, diskutim.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë teksti digjital.
15		9.3 Shoqëria pasmoderne.	Shoqëria pasmoderne është produkt i zhvillimit	Pyetje-përgjigje, rrjeti i diskutimit,	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti mësimor, sociologjia

			të teknologjisë.	reflektive.		digjitale.
16	TEMATIKA 10 Metodat e kërkimit sociologjik (8 orë)	10.1 Tipare të metodave të kërkimit sociologjik. Eksperimenti.	Metodat e kërkimit sociologjik ndryshojnë nga ato të shkencave ekzakto.	Brainstorming, punë në grupe, organizuesi grafik, diskutime.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë teksti digjital, interneti etj
17		10.2 Vëzhgimi sociologjik.	Vëzhgimi në sociologji nënkupton vëzhgimin e proceseve shoqërore.	Brainstorming, rrjeti i diskutimit: pro/kundër, reflektive.	Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual	Teksti mësimor, digjital, internet.
18		10.3 Intervista sociologjike dhe studimi i dokumenteve.	Intervista është një nga metodat që të ofron përfundime cilësore në studimet sociologjike.	Harta e mendimit, punë në grupe, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti mësimor, digjital, internet.
19		10.4 Anketa sociologjike dhe kampionimi.	Roli i veçantë i anketës sociologjike në studimin e dukurive shoqërore.	Harta e mendimit, punë në grupe, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	Vlerësimi i vazhdueshëm	Teksti i sociologjisë, teksti digjital, interneti etj.
20		10.5 Përsëritje.	Përfundim i njohurive të tremujorit të tretë.	Brainstorming, punë në grupe, diskutime.	Vlerësim përmbljedhës	Teksti i sociologjisë, digjital.
21		10.6 Test i tremujorit të tretë.	Vlerësim i njohurive të tremujorit të tretë.	Punë me shkrim, individuale.	Vlerësim përmbljedhës.	Teksti mësimor, sociologjia digjitale.
22		10.7 Projekt lëndor. Faza III. Prezantim (ora II).	Paraqitja dhe prezantimi i anketave të hartuara nga nxënësit.	Brainstorming, grupet e ekspertëve, diskutime, reflektive.	Vlerësimi përmbljedhës portofoli	Teksti i sociologjisë, digjital, video – audio, internet.

4. Modele të plan – ditarëve të mësuesve

4.1 Modele të plan – ditarëve të mësuesve për orët 45’

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.1 Tema mësimore: Përcaktimi i kulturës		Situata e të nxënit: Në rrjedhën e historisë, shoqëritë zhvilluan veçori kulturore të ndryshme, që i dallojnë nga njëra-tjetra. Ato përfshijnë anë të të jetesës së përditshme, si mënyra e të ushqyerit, veshjes, sjelljes, besimet fetare, festat dhe ceremonitë etj.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit: - shpjegon një nga përcaktimet kryesore sociologjike të kulturës; - përshkruan rolin e kulturës në përpjekjet e njerëzve për ndryshimin e natyrës; - vetëdijësohet për funksionet kryesore humanizuese të kulturës;		Konceptet kyçe: - Kulturë; - Funksion humanizues i kulturës; - Funksion transformues i kulturës.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, qytetaria etj mbi konceptin kulturë dhe raportin e saj me shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, rrjeti i diskutimit, punë në grupe, praktikë e pavarur, diskutime.			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I: Brainstorming, rrjeti i diskutimit. Mësuesja/i organizon lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Ata i japin përgjigje pyetjeve duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për kulturën, elementët e saj dhe duke listuar tiparet dalluese kryesore të kulturës në vende të ndryshme.			
mënyra e të ushqyerit, gjuha ceremonitë simbolet  besimet fetare festimet veshjet, etj..			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grup. Praktikë e pavarur. Mësuesi/ja përmbledh idet e nxënësve duke dhënë një nga përkufizimet e kulturës. Ai/ajo thekson raportin e ndërsjellë mes kulturës dhe zhvillimit të shoqërisë. Sot në botë ka një numër të madh sistemesh kulturore, që dallohen shumë nga njëri-tjetrin. Por, pavarësisht nga dallimet, çdo sistem kulturor ka pesë përbërës kryesorë: simbolet, gjuhën, vlerat, normat dhe kulturën materiale. Klasa ndahet në grupe. Temat e sugjeruara janë:			

Grupi I: Kultura si ndërmjetëse në marrëdhëniet e njerëzve me natyrën. Grupi II: Kultura si faktor humanizimi. Grupi III: Ndikimi i ndërsjellë ndërmjet zhvillimit të kulturës dhe zhvillimit të shoqërisë. Grupi IV: Kultura përbën kornizën brenda së cilës formohet personaliteti i çdo anëtarë të kulturës. Nxënësit prezantojnë rezultatet e punës së tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e kulturës në veprimtarinë jetësore të njeriut, në të gjitha raportet: me natyrën, mes individëve dhe në përmirësimin e mënyrës së jetesës. Hapi III: Përforcimi i të nxënit. Diskutime. Reflektimi për njohuritë e marra, organizohet në fund të orës së mësimi. Nxënësit përforcojnë idetë kryesore të lëndës së re, lidhur me kulturën dhe rëndësinë e zhvillimit të saj në jetën e shoqërisë. Ata dallojnë kuptimin sociologjik dhe atë të përditshëm të fjalës "kulturë".
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues, i vazhdueshëm.
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë shtëpie: I. Ese shpjeguese me temë: "Kultura është një ndërtim po aq individual dhe psikologjik, sa edhe një konstruksion shoqëror". II. Ese përshkuese me temë: "Sa kanë ndikuar kultura shqiptare dhe kulturat e tjera në formimin e personalitetit tim".

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.2 – 1.3 Tema mësimore: Simbolet kulturore dhe gjuha.	Situata e të nxënit: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë shkrimin në hyrje të mësimi mbi rolin e gjuhës shqipe në marrëdhënie me kultura të tjera europiane, si dhe ndryshimet mes simboleve të kulturave të ndryshme.		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësja/i: -shpjegon kuptimin sociologjik të simbolit kulturor dhe të vetëdijësohet për funksionet shoqërore të tij; -aftësohet për t'u orientuar në botën e simboleve të kulturës shqiptare dhe të kulturave të tjera; -përshkruan përcaktimin sociologjik të gjuhës dhe ndikimet e saj në zhvillimin e kulturës; -analizon dhe të vetëdijësohet për rolin e veçantë të gjuhës shqipe mes kulturës së vendeve të tjera të Europës.	Koncepte kyçe: - simbol kulturor; - funksion i simbolit kryesor; - simbol me përdorim nënkulturor; - simbol me përdorim ndërkulturor; - gjuhë si sistem simbolesh.		
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, gjuha dhe letërsia, filozofia etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, gjuha shqipe etj mbi konceptin		

simbol kulturor dhe gjuhë.

Metodat e përdorura: Brainstorming, harta e mendimit (cluster), mbajtja e strukturuar e shënimeve, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit.

Organizimi i orës së mësimit


Hapi I: Brainstorming, harta e mendimit (cluster)

Mund të organizohet bazuar në lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe diskutimit të situatës së dhënë në libër. Mësuesja/i fton nxënësit të japin idetë e tyre lidhur me llojin e simboleve dhe rëndësinë e tyre në jetën e përditshme, duke i grupuar në tabelë në formën e një harte (cluster). Nxënësit sjellin shembuj konkretë nga keqkuptimet e ndodhura në jetën e përditshme, për shkak të mosnjohjes së simboleve kulturore (ose gjuhës).

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Mbjatja e strukturuar e shënimeve (krahaso – dallo), harta e konceptit.

Mësuesja/i drejton nxënësit të analizojnë pjesë të caktuara të tekstit, me qëllim dallimin e simboleve të ndryshme kulturore dhe ndryshimit të tyre në kohë.

Më pas, së bashku ndërtojnë në tabelë hartën e konceptit, me funksionet që ato luajnë në jetën e përditshme (e njëjta gjë mund të bëhet për gjuhën).



Hapi III: Përforcimi i të nxënit. Rrjeti i diskutimit.

Së bashku, konkludojnë rolin e rëndësishëm të simboleve kulturore (ose të gjuhës si sistem simbolesh), duke identifikuar faktorët që ndikojnë në ndryshimin e tyre, si dhe prirjet e këtij zhvillimi.

Vlerësimi: **Vlerësimi:** *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.*

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues, i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie:

I. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në ditët e sotme ka sjellë përshtatjen e njerëzve me fjalë të reja, që më parë do të dukeshin pa kuptim, si për shembull internet, e-mail, downloading, connect, etj. Shpjegoni me shkrim disa nga tiparet e këtij ndryshimi. Mbani qëndrimin tuaj lidhur me përparësitë apo problemet që sjell ai në jetën e përditshme.

II. Një pjesë e emigrantëve braktisin gjuhën amtare për t’u përshtatur më mirë me jetën brenda kulturës së re. Studimet tregojnë se ruajtja e gjuhës së origjinës dhe mësimi i një gjuhe të re do t’i ndihmonte më shumë këtë tranzicion. Përshkruani me shkrim disa nga të mirat që sjell arsimimi në dy gjuhë (bilingual) i fëmijëve, familjet e të cilëve emigrojnë.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.4 Tema mësimore: Vlerat kulturore		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatat e dhëna në tekst, lidhur me kuptimin që i japim vlerave kulturore në jetën e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> <i>-shpjegon konceptin sociologjik të vlerës kulturore.</i> <i>-përshkruan vlerat kryesore të kulturave perëndimore.</i> <i>-analizon rolin e veçantë të vlerave kulturore në funksionimin e shoqërisë tradicionale shqiptare.</i> <i>-vetëdijësohet për vlerat kulturore që e udhëheqin në jetë.</i>		Koncepte kyçe: - vlerë kulturore; - vlerë kulturore e shoqërive moderne perëndimore; - vlerë kulturore e shoqërisë tradicionale shqiptare; - besë; - mikpritje; - harmoni ndërfaqetare.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet organizimi i lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve dhe disiplinat e tjera, si historia, filozofia, letërsia etj., për ndërtimin e njohurive të reja dhe argumentimin e ideve dhe njohurive të përfthuara.	
Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, organizuesi grafik, diskutim.			
Organizimi i orës së mësimi Hapi I: Brainstorming, diskutime. Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimin e situatave të dhëna në libër dhe identifikimin e problemit. Përvoja historike tregon se vlerat kulturore kanë luajtur rol të rëndësishëm në funksionimin e shoqërive tradicionale, ku pothuajse nuk vepronin fare organet shtetërore, sikurse në Shqipëri, deri në shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, ajo pjesë e shoqërisë shqiptare e zonave malore që nuk iu nënshtrua regjimit të pushtimit osman. Vlerat më të spikatura të popullit tonë gjatë kësaj periudhe janë: besa mikpritja harmonia fetare Vlerat kulturore			
Hapi II: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, diskutime. Nxënësit ndahen në grupe. Ata përgatiten për temat e mëposhtme:			


Grupi I: Besa ka qenë një formë "kontrate shoqërore" e pashkruar, që nuk mund të shkelej për asnjë lloj arsye" Grupi II: Mikpritja, e kuptuar si respekt dhe nderim i veçantë për mikun, ndihmoi në kapërcimin e konflikteve. Grupi III: Harmonia fetare ndihmoi në ruajtjen e bashkëjetesës paqësore mes shqiptarëve. Hapi III: Përforcimi i të nxënës: Nxënësit prezantojnë dhe demostrojnë rezultatet e punës në grupe. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e zbatimit të këtyre vlerave kulturore për kohën kur funksionuan, në mungesë të ligjeve dhe organeve shtetërore për zbatimin e tyre. Së bashku me mësuesen/in nxënësit bëjnë dallimin mes vlerave tradicionale dhe atyre bashkëkohore shqiptare.
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi c- vlerësim me anë të portofolit
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë me shkrim: Trajtoni në formën e një eseje vlerat kulturore që ju do të zgjidhnit si më të përshtatshme për ditët e sotme: shpirtin konkurrues dhe iniciativën e lirë apo frymën e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke?

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.5 Tema mësimore: Normat kulturore		Situata e të nxënës: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë situatën e dhënë në tekst, lidhur me rregullat që njerëzit i zbatojnë në mënyrë të vetvetishme në shoqëri. Pse ndodh kështu?	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja: - shpjegon kuptimin sociologjik të normave kulturore; - përshkruan shumëllojshmërinë e normave kulturore dhe rolin e veçantë të tyre në shoqëri; - analizon veçoritë e normave të kulturës shqiptare; - vetëdijësohet për rolin e tyre në zgjidhjen e pothuajse të gjithë problemeve dhe mirëfunksionimin e shoqërisë shqiptare.		Konceptet kyç: - normë kulturore; - more; - folkuej; - normë kulturore udhëzuese; -normë kulturore urdhëruese; - normë kulturore ndaluese; - tabu.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, qytetaria etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, letërsia etj., për të kuptuar drejt rëndësinë e veprimit të normave në mirëfunksionimin e shoqërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, diagrama e Venit, rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I:** Brainstorming, ha.

Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe diskutimin e situatës së dhënë në libër. Ai/ajo rendit në tabelë, në formën e një harte, disa nga normat që individët duhet të zbatojnë në shoqëri për të ruajtur marrëdhënie respekti dhe ndërveprimi reciprok.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup, praktikë e pavarur, diagrama e Venit.**Hapi III:** Përforcimi i të nxënës: reflektime dhe diskutime.

Nxënësit prezantojnë dhe demonstrojnë rezultatet e arritura nga puna në grupe. Ata diskutojnë së bashku temën e mëposhtme:

Normat kulturore na mësojnë si të sillemi me njëri-tjetrin dhe të ndihemi komod në komunitetin tonë. Rregullat për të komunikuar me të panjohur në publik janë të shumta. Për shembull: është normale të presësh rradhën në një qendër tregëtare, por nuk do të ishte etike të mos e respektoje atë; do të ishte sjellje e rregullt të kërkoje leje për t'u ulur në tryezë me të panjohur për të konsumuar ushqim të shpejtë, por kjo nuk do të ishte normale në një restorant për të darkuar; do të ishte normale të uleshe pranë një të panjohuri në autobus të mbushur me njerëz, por jo kur ai është pothuajse bosh, e kështu me rradhë.

Diskutoni mes jush situata kur jeni ndodhur ngushtë nga sjellja e parregullt e një të panjohuri. Tregoni si dhe pse keni reaguar në atë mënyrë? Si do të kishit vepruar po të kishit reflektuar më gjatë?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ata vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime e debate. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani disa nga ndryshimet e normave kulturore që vini re në kulturën e sotme shqiptare. A mendoni ju se këto ndryshime sjellin zhvillim apo humbje të vlerave njerëzore? Sillni argumente sa më të qarta dhe bindëse, pro dhe kundër qëndrimit tuaj.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.6 Tema mësimore: Larmia kulturore.		Situata e të nxënës: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë për larminë e kulturës shqiptare sipas krahinave dhe në kohë të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegon konceptin sociologjik të nënkulturës;		Konceptet kyçe: - larmitet kulturor - nënkulturë;	

-analizon faktorët kryesorë që përcaktojnë kulturën shqiptare si mozaik i pasur nënkulturash; - shpjegon konceptin sociologjik të kundërkulturës; -përshkruan veçoritë kryesore të disa kundërkulturave në Shqipëri ose në vende të tjera;	- kundërkulturë; - kundërkulturë rinore.
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, qytetaria etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, letërsia etj.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodat e përdorura: Rrjeti i diskutimit, punë në grupe, marrëdhënia pyetje-përgjigje, harta e konceptit.

Organizimi i orës së mësimi: Rrjeti i diskutimit, harta e konceptit.

Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, si dhe diskutimin e situatës së dhënë në libër. Nxënësit japin shembuj të ndryshëm nënkulturash nga qyteti i lindjes apo krahina e origjinës. Së bashku nxjerrin në pah larmitetin e kulturës shqiptare në mënyrën e jetesës, si banesat, ushqimi tradicional, veshjet popullore, arti, traditat etj.

Nënkultura	Kundërkultura
•Pozicioni gjeografik •copëzimi feudal •besime fetare të ndryshme •zona të pushtuara dhe të lira •dialektet gjuhësore •emigrimi i shqiptarëve etj.	•Të rinjtë: shije dhe prirje ndryshe nga tradita: •muzika •veshjet •pasionet dhe dëshirat •Krijimtaria në kushtet e pushtimit, diktaturave etj.

Hapi II: Ndërtimin e njohurive të reja. Punë në grup. Praktikë e pavarur.

Mësuesja/i përcakton konceptet nënkulturë dhe kundërkulturë, duke bërë dallimin mes tyre. Klasa ndahet në grupe.

Grupi I: Përshkruan modele të veçantë sjelljeje, komunikimi ose veshjeje të ndonjë grupi nënkulturor që banon në qytetin ose krahinën tuaj.

Grupi II: Përshkruan ndonjë model sjelljeje kundërkulturore të të rinjve shqiptarë. Analizon kundërvënien e sjelljeve të tilla ndaj vlerave dhe normave kulturore sunduese të shoqërisë.

Grupi III: Krahason modelet e sjelljes së të rinjve shqiptarë gjatë sistemit të diktaturës dhe sot. Përshkruan ndryshimet mes tyre.

Grupi IV: Analizoni ndryshimet e kulturës shqiptare në kushtet e sotme të globalizmit.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Marrëdhëniet pyetje – përgjigje

Nxënësit prezantojnë dhe demostrojnë rezultatet e punës në grupe. Mësuesja/i drejton pyetjet për reflektim:

1. Ç'është nënkultura?
2. Cilët faktorë kryesorë përcaktojnë mozaikun e nënkulturave në kulturën shqiptare?
3. Ç'është kundërkultura?

4. Pse të rinjtë në shoqëritë moderne janë më të prirur drejt kundërkulturave?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime e debate.
a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie:

I Përshkruani modele të veçantë sjelljeje, komunikimi ose veshjeje të ndonjë grupi nënkulturor që banon në qytetin ose krahinën tuaj.

II. Përshkruani ndonjë model sjelljeje kundërkulturore të të rinjve shqiptarë. Analizoni kundërvënien e sjelljeve të tilla ndaj vlerave dhe normave kulturore sunduese të shoqërisë.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.7 Tema mësimore: Vlerësime të kulturave: Etnocentrizmi.		Situata e të nxënës: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë situatat e tekstit. Mbi vlerësimi i kulturës së tjetrit është një tjetër problem i disa shoqërive, që çojnë në vlerësime të gabuara.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: - shpjegon konceptin sociologjik të etnocentrizmit; - përshkruan rrjedhojat kryesore të psikozave dhe të praktikave me natyrë etnocentrike; - aftësohet për t’u orientuar në mjediset e kulturave të tjera, duke shmangur qëndrimet etnocentrike.		Fjalët kyçe: - vlerësim i kulturave; - etnocentrizëm; - funksione të praktikave etnocentrike; - etnocentrizëm i qëllimshëm.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, foto, historia, filozofia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, letërsia etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, shënime të strukturuar, rrjeti i diskutimit, reflekto dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimi			
Hapi I: diskutim i situatave në libër dhe identifikimi i problemit. Pse njerëzit kanë probleme në gjykimin e vlerave kur kalojnë kufijtë e kulturës së tyre?			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Shënime të strukturuar. Praktikë e pavarur.			
Mësuesja/i shpjegon kuptimin e etnocentrizmit si vlerësimi dhe gjykimi i një kulture nga kriteret e një kulture tjetër. Ai është një reagim njerëzor i përgjithshëm, i pranishëm në të gjitha shoqëritë dhe grupet shoqërore, madje në të gjithë individët. Më i pranishëm është tek njerëzit më pak të arsimuar, më fanatikë nga pikëpamja fetare ose që kanë punuar e jetuar brenda një sistemi kulturor, por edhe tek vendet e mëdha kundër kulturave të popujve të vegjël ose më pak të zhvilluar.			

Nxënësit punojnë dy çështjet për diskutim në libër:

1. Analizoni dy shembuj keqkuptimi ose konflikti si pasojë e psikozave me natyrë etnocentrike, të vëzhguara në jetën e përditshme, të pasqyruara në filma, në programe televizive e të internetit ose për të cilët keni lexuar e dëgjuar.
2. Analizoni disa pikëpamje me natyrë etnocentrike të emigrantëve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në vende të tjerë të Europës dhe më gjerë.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Reflekto dhe përgjigju

1. Ç'është etnocentrizmi?
2. Cilët individë ose grupe shoqërore janë më të prekshëm nga shfaqjet e etnocentrizmit?
3. Ç'pasoja kryesore të dukshme sjellin mendësitë dhe praktikat me natyrë etnocentrike?
4. Pse organet drejtuese të partisë – shtet gjatë periudhës së rendit socialist kultivonin prirjet etnocentrike në kulturën shqiptare?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ata vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime e debate. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm b- vlerësim portofoli (puna e pavarur).

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie me shkrim:

- I. Përshkruani emocionet që keni përjetuar kur keni parë për herë të parë modele krejt të veçanta sjelljeje të anëtarëve të kulturave të tjera.
- II. Përshkruani në formën e një eseje ndonjë situatë keqkuptimi në të cilën jeni ndodhur ju ose të njohurit tuaj si rrjedhojë e psikozave me natyrë etnocentrike.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
1.8 Tema mësimore: Vlerësime të kulturave: Ksenocentrizmi dhe relativizmi kulturor.		Situata e të nxënit: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë situatat e tekstit. Mbivlerësimi i kulturës së tjetrit është një tjetër problem i disa shoqërive, që çojnë në vlerësime të gabuara.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> - shpjegon konceptin sociologjik të ksenocentrizmit dhe atë të relativizmit kulturor; - aftësohen për t’u orientuar në sistemet e tjera kulturore, duke shmangur shokun kulturor; - aftësohen për të vlerësuar me frymë relativizmi çdo element të çdo sistemi kulturor.		Koncepte kyç: - ksenocentrizëm; - relativizëm kulturor; - shok kulturor.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, foto, historia, filozofia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, letërsia etj.,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: diskutim i situatës në libër dhe identifikimi i problemit. Cilët janë faktorët që ndikojnë në mbivlerësimin e kulturave të huaja përballë asaj kombëtare?

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Shënime të strukturuar. Praktikë e pavarur.

Mësuesja/i shpjegon kuptimin e ksenocentrizmit: si mbivlerësimi i kulturave të popujve të tjerë dhe nënvlerësimi i kulturës vetjake dhe relativizmin kulturor si gjykimi i një kulture mbi bazën e kritereve të veta dhe jo të ndonjë kulture tjetër quhet relativizëm kulturor.

Më pas, diskutohen probleme lidhur me të ashtuquajturin “shok kulturor”, që është i natyrshme kur kalojmë në sisteme kulturore të ndryshme nga tonat. Ai shkaktohet nga zakone dhe tradita të ndryshme të një kulture tjetër, si: në mënyrën e jetesës, veshjes, ushqimit, rregullave etike të sjelljes, ritualeve të besimeve fetare, etj. Njerëzit pas zhgënjimit që pësojnë, fillimisht priren të refuzojnë kulturën tjetër dhe duke lavdëruar të vetën. Kjo është një prirje e natyrshme për gjithsecilin, po të kujtojmë faktin se kultura mësohet dhe edukohet brez pas brezi. Kërkon ditë, muaj për të marrë veten nga shoku kulturor dhe shpesh vite për t’u përshtatur dhe për të jetuar në një kulturë të re.

Nxënësit punojnë dy çështjet për diskutim në libër:

1. Analizoni dy shembuj keqkuptimi ose konflikti si pasojë e psikozave me natyrë etnocentrike, të vëzhguara në jetën e përditshme, të pasqyruara në filma, në programe televizive e të internetit ose për të cilët keni lexuar e dëgjuar.

2. Analizoni disa pikëpamje me natyrë etnocentrike të emigrantëve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në vende të tjerë të Europës dhe më gjerë.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Ese analitike, sipas grupeve, me temë:

I. “Ekperienca me kultura të reja ofrojnë mundësi për të praktikuar relativizmin kulturor”. Mbani qëndrimin tuaj rreth pohimit dhe përpikuni të jeni sa më bindës në shpjegimin tuaj, përmes fakteve apo shembujve konkretë.

II. Përshkruani me shkrim emocionet që përjetoni, kur përballeni me elemente të veçanta të kulturave të tjera që ndryshojnë shumë nga elementet përkatëse të kulturës shqiptare.

III. Përshkruani një situatë shoku kulturor, në të cilën jeni ndodhur ju, ndonjë shoqe, shok ose i afërmi juaj.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ata vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime e debate. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm b-vlerësim portofoli (puna e pavarur në klasë ose në shtëpi).

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie me shkrim:

1. Analizoni mendësi ksenocentrike të përhapura ndër shqiptarët, veçanërisht ndër emigrantët (mendësi të tilla mund t’i gjeni përmes bisedave me emigrantë që janë kthyer përkohësisht ose përgjithmonë në Shqipëri ose përmes shkrimeve të tyre në internet).

2. Analizoni ndonjë element të veçantë të kulturës shqiptare, i cili mund t’iu duket i çuditshëm anëtarëve të kulturave të tjera, por që ka pasur rëndësi të madhe për funksionimin e shoqërisë shqiptare tradicionale.

1.10 Veprimtari 1

Kultura shqiptare, vlerat tradicionale dhe sfidat e globalizmit

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Nxënësit në fund të orës së veprimtarisë:

- Zhvillojnë aftësinë ndërpersonale duke bashkëpunuar në grup për realizimin e objektivave të përbashkëta të veprimtarisë.

- Mbajnë qëndrim kritik ndaj qëndrimeve paragjyquese me natyrë etnocentrike, ndaj kulturave të tjera.
- Aftësohen në qëndrime pranuese dhe respektuese ndaj larmisë kulturore, për një bashkëjetesë dhe harmoni shoqërore.
- Shfrytëzojnë burimet të ndryshme, gjykon vlefshmërinë duke përdorur teknologjinë e informacionit për përgatitjen e prezantimeve.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Rrjeti i diskutimit; punë në grupe; debat dhe dialog; organizues grafik; rishikim në grup; harta e konceptit; konkluzione dhe reflektime.

Për të zhvilluar këtë veprimtari duhet të keni përvetësuar njohuritë e Tematikës I dhe të keni hulumtuar në burime të tjera për më shumë informacion nga sjelljet dhe kultura e grupeve të ndryshme shoqërore. *Mësuesja ka ndarë orën paraardhëse, sipas grupeve, detyrat për zhvillimin e orës.*



paragjyquese dhe diskriminuuese? Si mund t'i luftojmë ato?

Faza e dytë: Punë në grupe.

Grupi I: Sillni shembuj simbolesh, vlerash, normash, etj., nga kultura e Shqipërisë së Veriut, gjatë periudhës së funksionimit të kanuneve. Arsyetoni mbi kuptimin dhe vlerën që ato patën për kohën.

Grupi II: Sillni shembuj simbolesh, vlerash, normash, etj., nga kultura e Shqipërisë e Mesme para vendosjes së rregjimit komunist, duke shpjeguar vecoritë dhe vlerën e tyre kulturore.

Grupi III: Sillni shembuj simbolesh, vlerash, normash, etj., nga kultura e Shqipërisë së Jugut, para vendosjes së rregjimit komunist, duke vlerësuar rolin e tyre për kohën kur funksionuan.

Grupi IV: Sillni shembuj simbolesh, vlerash, normash, etj., në ditët e sotme në vendin tonë. Analizoni ndryshimet dhe transformimet që kanë pësuar ato në krahasim me të kaluarën.

Faza e tretë: Prezantimi i punës së grupeve. Rishikim në grup.

Secili grup prezanton punën e tij në poëer point, album, poster, etj.

Faza e parë: Rjeti i diskutimit

Mund të bazoheni në pyetjet e mëposhtëme:

-C'kuptojmë me kulturë?

-Cilët janë elementët e saj përbërës?

-Cfarë rëndësie ka zbatimi i vlerave dhe normave kulturore për ruajtjen e harmonisë dhe bashkëjetesës shoqërore?

-Pse individë ose grupe të ndryshme shoqërore dalin në kundërshtim me vlerat dhe normat e mirëpranuara nga shoqëria?

-Cfarë kuptojmë me diversitet kulturor? Difuzion kulturor? Globalizim të kulturës?

-Cilat janë këndvështrimet etnocentriste, ksenocentriste dhe relativiste kulturore?

-Ku qëndron rrezikshmëria e qëndrimeve



Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit, duke plotësuar apo përforcuar idetë e paraqitura.

Faza e katërt: Konkluzione dhe reflektime – Rrejtë i diskutimit; Debat dhe dialog; Harta e konceptit.

Shumë e rëndësishme është faza e IV e veprimtarisë, ku secili grup duhet të mbajë qëndrimin e tij kritik ndaj një dukurie të caktuar të lidhur me konceptin kulturë, disa prej të cilave i kemi renditur më poshtë. Mësuesja orienton diskutimin në formën e një debati konstruktiv, ku respektohet liria e fjalës dhe e mendimit të gjithësecilit.

Secili grup ndërton hartën e tij të konceptit për çështjet e mëposhtme. Konkretisht:

-Grupi I: Jep shembuj qëndrimesh etnocentriste ndaj zakoneve të traditës shqiptare dhe më pas mban qëndrim kritik ndaj vlerës që këto kultura patën në kohën që funksionuan.

-Grupi II: Jep shembuj qëndrimesh ksenocentriste ndaj kulturave të tjera gjatë periudhës mbas viteve 1990 në Shqipëri dhe dëmet që solli për origjinalitetin e kulturës tonë.

-Grupi III: Vlerëson ndryshimet e mëdha që ka sjellë përparimi i kulturës në Shqipëri deri në ditët e sotme, duke evidentuar edhe pasojat negative të këtij zhvillimi.

-Grupi IV: Pozicionohet sipas këndvështrimit të relativizmit kulturor ndaj kulturës shqiptare dhe raportit të saj me kulturat e tjera në kushtet e globalizmit.

Rendisni në tabelë disa nga përparësitë dhe efektet negative të procesit të globalizmit për Shqipërinë.

Faza e pestë: Mësuesja vlerëson punën e bërë gjatë organizimit dhe realizimit të veprimtarisë, që mund të jetë pjesë e punës së portofolit të tremujorit të parë. Ky vlerësim mund të jetë në këto forma:

-vlerësim në grup;


-vlerësim individual;

-vetëvlerësim;

-vlerësim për shoqen/shokun.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
2.1 Tema mësimore: Përvoja shoqërore dhe shoqërizimi.		Situata e të nxënësve: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst. Shoqërizimi si proces bazohet në përvojën e brezave lidhur me elementët e ndryshëm të kulturës.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: - shpjegon kuptimin sociologjik të shoqërizimit; - përshkruan ndikimet kryesore të shoqërizimit në formimin e personalitetit të njeriut; - analizon shpjegimet kryesore sociologjike të procesit kompleks të shoqërizimit; - reflekton dhe të vetëdijësohet për veçoritë e shoqërizimit vetjak.		Konceptet kyçe: - shoqërizim; - personalitet; - vetja shoqërore; - përvoja shoqërore	
Burimet: : Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, foto, historia,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me disiplina të	

filozofia, psikologjia etj.	tjera, si historia, filozofia, letërsia etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodat e përdorura: Stuhia mendimi, organizues grafik, rrjeti i diskutimit, reflektio dhe përgjigju.	
Organizimi i orës së mësimit	
Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimin e situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit. Nxënësit shprehin opinionet e tyre lidhur me procesin e shoqërizimit dhe rolin e përvojës shoqërore në formimin e personalitetit të njeriut.	
 <pre> graph TD P((Personaliteti)) --- M((mendimet)) P --- O((opinionet)) P --- S((sjelljet personale)) P --- N((ndjenjat)) P --- V((përfytyrimi për veten)) P --- R((reagimi ndaj të tjerëve)) </pre>	
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grup, praktikë e pavarur, harta e konceptit. Mësuesi/ja përcakton shoqërizimin si <i>një proces i vazhdueshëm i bazuar në ndërveprimin shoqëror, nëpërmjet të cilit individët zhvillojnë mundësitë e tyre njerëzore dhe mësojnë modelet e kulturës së vet.</i> Ai/ajo jep disa shpjegime të shoqërizimit: ▪ Zhan Piazhe - me fazat e zhvillimit të aftësive njohëse të individëve; ▪ Zigmund Frojd - me marrëdhëniet ndërmjet instinkteve dhe vetëdijes së njerëzve. ▪ Mid - me fazat e zhvillimit të kuptimit për veten.	
Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: Reflektio dhe përgjigju. 1. Ç'është shoqërizimi? 2. Cili është përcaktimi sociologjik i personalitetit? 3. Si ndikon shoqërizimi në formimin e personalitetit të njeriut dhe në transmetimin e kulturës nga njëri brez në tjetrin? 4. Cilat janë drejtimet kryesore të marrëdhënieve ndërmjet vetes së individit dhe shoqërisë?	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja/i: a- vlerësim formues b- vlerësim me anë të portofolit	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë me shkrim: Përshkruani sa dhe si e përfytyroni rolin e një personi tjetër, me të cilin parashikoni të bëni një bisedë për një problem të rëndësishëm.	

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
2.2 – 2.3 Tema mësimore: Mjedise dhe faktorë të shoqërizimit.		Situata e të nxënës: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë situatat në tekst mbi fa	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon veçoritë e ndikimit të familjes në procesin e shoqërizimit të fëmijëve; -argumenton funksionet shoqërizuese të shkollës; -përshkruan ndikimet shoqërizuese të grupeve të vogla të shoqeve dhe shokëve të ngushtë; -përshkruan veçoritë e ndikimit të medias dhe opinionit publik në shoqërizim;		Konceptet kyçe: -agjenci shoqërizimi; -shoqërizim gjinor; -program mësimor i hapur; -program mësimor i fshehtë; -grupi shoqëror i ngushtë; -shoqërizim i parashikuar; - opinion publik.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, psikologjia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**Metodat e përdorura:** Brainstorming, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit.**Organizimi i orës së mësimi****Hapi I:** bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimin e situatave të dhëna në libër dhe identifikimin e problemeve.**Hapi II:** Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit, debat dhe dialog.

Klasa ndahet në grupe dhe orientohet drejt shënimeve të strukturuar mbi tekstin.

Çdo grup analizon njërën nga faktorët e shoqërizimit, të vendosura së bashku me nxënësit në hartën e mendimit. Më pas, organizohet rrjeti i diskutimit mbi rolin që luajnë këta faktorë në jetën e individit.

Secili grup prezanton punën duke sjell argumentet e tij. P.sh.: Roli i familjes: -formimi i personalitetit dhe vlerave shoqërore; -shoqërizimi gjinor; - zhvillimi i prirjeve dhe talenteve; - përcaktimi i statusit etj. Shkolla: -

ndërveprimi me të tjerët; - aftësimi teorik dhe profesional përmes programit të hapur dhe të fshehtë; - vetëdijësimi për prirjet dhe talentet etj.

Kështu me rradhë për të gjithë faktorët e shoqërizimit (ora zhvillohet 90').

Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: Rjeti i diskutimit, debat dhe dialog.

Nxënësve përforcojnë idetë e tyre, duke reflektuar edhe për problemet që lindin gjatë procesit kompleks të shoqërizimit, si në familje, shkollë, me moshatarët e tyre, përmes mediave sociale, opinionit etj. Ata diskutojnë së bashku me mësuesin/en mbi rrugët e menaxhimit sa më të mirë të këtyre anëve.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vlerësim me anë të portofolit


Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësve do të punojnë ushtrimet në libër dhe zhvillojnë me shkrim temën: Përshkruani ndonjë mosmarrëveshje që keni pasur me prindërit lidhur me mendimet, mënyrën e veshjes ose modelet e sjelljes tuaj.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
2.4 Tema mësimore: Shoqërizimi dhe ciklet e jetës.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë për situatën hyrëse të temës në tekst. Shoqërizimi kalon në disa faza sipas grupmoshave të ndryshme, të cilat paraqesin veçoritë dhe vështirësitë e tyre në procesin e shoqërizimit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> <i>-përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërizimit në çdo cikël të jetës;</i> <i>- analizon mendësitë kryesore të shoqërisë shqiptare për çdo cikël të shoqërizimit;</i> <i>- përgatitet shpirtërisht për të përballuar vështirësitë dhe sfidat e çdo cikli të shoqërizimit;</i> <i>- vetëdijësohet për të toleruar gabimet e të tjerëve karakteristike për çdo cikël shoqërizimi.</i>		Konceptet kyçe: <i>- cikël i shoqërizimit;</i> <i>- fëmijëri;</i> <i>- adoleshencë;</i> <i>- moshë e ritur e hershme;</i> <i>- moshë e pjekurisë;</i> <i>- pleqëri.</i>	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, psikologjia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, harta e mendimit, punë në grupe, lexim i orientuar , rrjeti i diskutimeve, debat dhe dialog.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësueja/i bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimin e situatës së dhënë në libër dhe identifikimin e problemit. Së bashku me nxënësit klasifikohen në tabelë fazat e ndryshme të shoqërizimit gjatë jetesës së individëve në shoqëri.



Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grup, lexim i orientuar, praktikë e pavarur, rrjeti i diskutimit. Klasa ndahet në grupe. Mësuesi/ja orienton analizimin sipas grupeve të secilës fazë të shoqërizimit. Nxënësit dallojnë veçoritë e çdo grup moshe duke evidentuar përparësitë dhe problemet përkatëse në procesin kompleks të shoqërizimit.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Prezantime, diskutime, debat dhe dialog.

Grupet paraqesin argumentet e tyre, duke bërë krahasimin e fazave të ndryshme të shoqërizimit. Ata konkretizojnë me shembuj konkretë nga jeta e tyre, shokëve dhe shoqeve, të afërmëve etj.

Së bashku me mësuesen/in, nxënësit analizojnë çështjet mëposhtme:

1. Shkaktet e fëmijërisë së pashpjeguar dhe pasojat për shoqërinë;
2. Mendësitë dhe shqetësimet e adoleshentëve për perspektivën profesionale dhe shoqërore.
3. Mendësitë dhe paragjykimet që pengojnë gratë shqiptare të moshës 41- 60 vjeç për të përparuar në karrierën profesionale dhe politike.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja/i:

- a- vlerësim formues
- b- vetëvlerësim
- c- vlerësim me anë të portofolit

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Përshkruani mendimet e shoqeve, të shokëve të afërt dhe të prindërve për të ardhmen tuaj profesionale.

2.5 Veprimtari praktike

Tema: “Media dhe shoqërizimi i të rinjve”

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës. Nxënësjat/i në fund të orës së veprimtarisë:

- Zhvillon aftësinë e bashkëpunimit në grup për realizimin e objektivave të veprimtarisë;
- shpjegon ndikimin e mjediseve dhe faktorëve të ndryshëm në shoqërizimin e individit;

- përshkruan ndikimin e mediave si televizioni dhe interneti në procesin e shoqërizimit gjinor të adoleshentëve;
- shfrytëzon burime të ndryshme dhe përdor teknologjinë e informacionit për përgatitjen e paraqitjeve grafike.

Lexim orientues

Shoqërizimi është procesi përmes të cilit brezi i ri përshtatet me një mënyrë jetese të caktuar, duke përfshirë të gjithë elementët e kulturës si vlerat, simbolet dhe gjuhën, normat etj. Në këtë mënyrë ruhet trashëgimia kulturore brez pas brezi. Por, në procesin kompleks të shoqërizimit, jo rrallë riprodhohen paragjykime dhe pabarazi ndryshme. Kështu, dallimet dhe paragjykimet gjinore janë ruajtur përgjatë historisë në shumicën e kulturave.

Çështje për diskutim:

- Analizoni forma të ndryshme paragjykimesh që janë transmetuar nga brezi në brez. Si mund të përmirësohen sjellje të tilla?
- Analizoni veçoritë e ndikimit të programeve të ndryshme televizive dhe të internetit në shoqërizimin e të rinjve dhe të rejave.
- Përshkruani disa nga ndikimet pozitive dhe negative të rrjeteve sociale në shoqërizimin e brezit të ri, sot.

Çështje që mund të trajtohen në grupe:

Grupi I: Vajzat dhe filmat

Aktualisht, shumë prindër janë të shqetësuar për mesazhet që përcjellin filmat. Edhe filmat vizatimorë që shohin vajzat në moshë të vogël i shoqërizojnë ato me të ashtuquajturin "rol princeshe", që presin të shpëtohen nga "princi i kaltër". Në këtë mënyrë vajzave iu kultivohet vetëvlerësim i pamjaftueshëm për veten.

-Diskutoni rreth personazheve të fimave tuaj të preferuar, duke i parë përmes "lenteve gjinore".



Grupi II: Reklammat dhe mesazhet gjinore

Programet promovuese në media përcjellin në shumicën e rasteve mesazhe diskriminuese gjinore. Gratë paraqiten më shpesh brenda në shtëpi si amvisa apo nëna të devotshme, ndërsa burrat jashtë familjes, në karrierë. Vajzat përdoren si imazhe të bukurisë fizike dhe më rrallë në poste drejtuese, biznes, etj., sikurse djemtë.

-Diskutoni rreth mesazheve gjinore që përcjellin reklama të ndryshme që shfaqen në televizion, internet.

Grupi III: Rrjetet sociale dhe dallimet gjinore

Rrjetet sociale si Facebook, Instagram, WhatsApp etj., i ndihmojnë njerëzit të shkëmbejnë mesazhe me një rreth të gjerë shoqëror. Por, shpesh, ato përhapin modele të papërshtatshme për të rinjtë, ndër të cilat edhe paragjykimet gjinore. Për shembull, vajzat janë të prirura të shfaqin imazhe të bukurisë fizike, veshje të shtrenjta të modës, etj, ndërsa djemtë paraqiten me forma muskuloze të trupit, modele të reja autoveturash etj. Reklamime të tilla përforcojnë paragjykimet ndërgjinore.

-Diskutoni nga këndvështrimi gjinor shfaqje të tilla në rrethin tuaj shoqëror.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
3.1 Tema mësimore: Kuptimi sociologjik i deviancës.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst. Devianca shpjegohet si një dukuri sociale që ka karakterizuar të gjitha shoqëritë, në të gjitha kohërat. Pse ndodh kështu dhe si shpjegohet devianca në sociologji?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> -shpjegon kuptimin sociologjik të konceptit deviancë; - argumenton karakterin relativ të deviancës; - shpjegon me frymë relativizmi modele të ndryshme të sjelljeve deviante; - vetëdijësohet se mund të përballet me sjellje deviante të të tjerëve në jetën e përditshme;		Konceptet kyçe: - sjellje deviante; - krim; - karakter relativ i deviancës.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, psikologjia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grup, lexim i orientuar, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimeve.			
Organizimi i orës së mësimin Hapi I: Mësuesi/ja realizon lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, si dhe diskutimin e situatës së dhënë në libër, duke identifikuar problemin e deviancës. Ajo drejton pyetje rreth karakterit relative të deviancës në kohë dhe në hapsirë, duke theksuar karakterin universal të kësaj dukurie. Nxënësit sjellin shembuj konkretë dhe përpiqen t’i klasifikojnë si sjellje deviante ose jo. Mësuesja/i shpjegon kuptimin sociologjik të deviancës si shkelje të normave kulturore të një grupi shoqëror ose të gjithë shoqërisë. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup, praktikë e pavarur, lexim i orientuar, shënime të strukturuar. Klasa ndahet në grupe, ku secili prej tyre orientohet të analizojë një paragraph të tekstit, duke nxjerrë çështjet kryesore lidhur me faktorët që përcaktojnë karakterin relativ të deviancës në marrëdhënie me: 1- norma kulturore të caktuara; 2- rrethanat shoqërore; 3- pozitës shoqërore; 4- ndryshimeve në rrjedhën e kohës. Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë punën e tyre. Mësuesja diskuton rreth pyetjeve të mëposhtme: 1. Ç’është devianca? 2. Cili është përcaktimi sociologjik për krimin? 3. A mund të ketë modele sjelljesh, që të quhen deviantë në çdo shoqëri dhe në çdo kohë? 4. Nga cilët faktorë kryesorë përcaktohet nëse një sjellje është deviante ose jodeviante?			
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:			

- a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Dettyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Dettyrë me shkrim: Përshkruani ndonjë model sjellje deviante më të përhapur tek shoqëria e juaj në shkollë ose në komunitetin ku banoni.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
3.2 – 3.3 Tema mësimore: Tipet kryesorë të krimit.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë rreth sjelljeve të rënda devijante ose krimeve në shoqëri dhe dëmeve që ato shkaktojnë në marrëdhëniet ndërs shoqërore.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> <i>-përshkruan tipat kryesorë të krimit dhe rrezikshmërinë e tyre;</i> <i>-dallon grupet shoqërore më të prirur të kriminalizohen;</i> <i>-analizon veçanti kryesore të krimeve në shoqërinë shqiptare;</i> <i>-vetëdijësohet për t’u përfshirë në veprimtari të ndryshme që synojnë kufizimin e krimeve në shoqërinë shqiptare, veçanërisht ndër të rinjtë.</i>		Koncepte kyç: - <i>krim kundër personit;</i> - <i>krim kundër pasurisë;</i> - <i>krim i mërisë;</i> - <i>krim “pa viktimë”;</i> - <i>krim “i jakave të bardha”.</i>	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, psikologjia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, shënime në dyshe, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimeve.			
Organizimi i orës së mësimin Hapi I: Brainstorming, shënime në dyshe. Mësuesja/i bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Ata diskutojnë llojet e ndryshme të krimeve në shoqëri dhe dënimet që merren nga ligji dhe opinionin, sipas rëndësisë së veprës penale. Të ndarë sipas bangave në dyshe, nxënësit nxjerrin shënime nga teksti sipas çështjes së caktuar nga mësuesja/i, lidhur me tipet e krimeve, faktorët që i nxisin dhe shkallën e rrezikshmërisë së tyre shoqërore. Hapi II: Ndërtimin e njohurive të reja. Punë në grup, praktikë e pavarur, harta e konceptit. Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre dhe së bashku me mësuesin/en ndërtojnë hartën e konceptit me tipet më të përhapur të krimeve në shoqëri.			



Hapi III: Përforcimi i të nxënit: rrjeti i diskutimeve, reflektive.

Nxënësit diskutojnë rreth faktorëve që nxitin krimin në rradhët e të rinjve dhe cilat kategori të tyre janë të rrezikuara më shumë të përfshihen. Ata ndërtojnë një organizues grafik, ku rendisin sipas rradhës llojin më të përhapur të krimit tek të rinjtë dhe përbri tij shkakët që e nxitin atë.

Lloji i krimit	Shkaqet
Krimet kundër pasurisë	Gjendja e ulët ekonomike, papunësia, dëshira për të plotësuar dëshirat në kohë dhe rrugë të shkurtër, ndikimi i modeleve të shoqërisë, mungesa e edukimit të mjaftueshëm, arsimit i ulët, mungesa e zbatimit të ligjit dhe dënimeve etj....
Krimet "pa viktima"	Kurioziteti i moshës, ndikimi i shoqërisë, mungesa e informacionit, niveli i ulët arsimor, edukimi i pamjaftueshëm, neglizhimi, mungesa e perspektivës, dhuna, papunësia etj.....
Krimet kundër personit	Përfshirja në veprimtari kriminale (trafikim drogë, prostitucion armë etj), gjakmarrje ose hakmarrje, niveli i ulët ekonomik-social etj...
Krimet të mërisë ose të urrejtjes	Përfshirja për shkak të moshës së re, mungesa e informacionit dhe edukimit, niveli arsimor i ulët, ndikimi i medias etj.....
Krimet e "jakave të bardha"	Etja për të bërë para në rrugë të shpejtë, edukimi i pamjaftueshëm, modelet sociale, moszbatimi i ligjeve etj....

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësimi

c- vlerësim me anë të portofolit


Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë ne shkrim: Përshkruani sa dhe si ndikoheni ju nga filmat me dhunë që transmetohen nga televizionet ose programet e internetit.

Nxënësit sjellin materiale mësimore, për të zhvilluar orën e dytë të mësimit, duke përdorur burime të ndryshme, statistika, shifra, shkrime dhe studime të bëra si në Shqipëri dhe jashtë saj. Detyrat ndahen në grupe, në çift ose individuale, sipas dëshirës së nxënësve, në përputhje me të cilën di të bëhet dhe vlerësimi i punës së tyre (mund të përdoret për vlerësimin e portofolit lëndor).

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
3.4 Tema mësimore: Shpjegime të deviancës: Pikëpamjet biologjike.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i diskuton me nxënësit për shkaqet që shpjegojnë sjelljet deviante dhe nëse lidhen ato me anën biologjike të njeriut.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon shpjegimet biologjike kryesore të deviancës; -analizon interpretimin gjenetik të deviancës; -përshkruan kufizimet kryesore të teorive biologjike dhe gjenetike;		Koncepte kyç: - shpjegim biologjik i deviancës; - shpjegim gjenetik i deviancës; - kufizime të shpjegimeve biologjike të deviancës.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, psikologjia.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, shënime në dyshe, organizues grafik, diskutime, pyetje dhe reflektime.			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I: Mësuesja/i duke bërë lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, klasifikon në tabelë idetë e tyre mbi faktorët social, ekonomik, kulturor, ligjor dhe individual që ndikojnë në përfshirjen e individëve në sjelljet kriminale. Ai/ajo ndalon më shumë në anën personale që lidhet me biologjinë e personit.			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në çifte, praktikë e pavarur, organizuesi grafik. Mësuesja/i orienton shënimet e strukturuar në dyshe bazuar në çështjet që trajtohen në tekst dhe më pas klasifikohen në tabelë idetë e secilit çift, duke i rishikuar me kujdes në fund. Sipas teorisë biologjike kriminelë dallohet nga tiparet e jashtme fizike, struktura muskuloze e trupit ose çrregullime gjenetike.			
Hapi III: Përforcimi i të nxënit: diskutime, pyetje dhe reflektime. Mësuesja/i nxit reflektimin e nxënësve përmes pyetjeve rreth teorisë biologjike të shpjegimit të krimeve në shoqëri. A shpjegon kjo teori të gjitha krimet që kryhen në jetën e përditshme? A janë të dallueshëm kriminelët nga ana e jashtme fizike? Si do ta vlerësonit ju këtë teori? A mund të gjeni shembuj që mbështesin opinionin tuaj?			
Diskutoni shembuj dhe fakte nga jeta e përditshme që provojnë se edhe njerëz me tipare biologjike të përshkruara nga këta shkencëtarë zbatojnë me korrektësi kërkesat e normave kulturore dhe ligjore.			



Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipastemës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësimi formues i vazhdueshëm

b- vetëvlerësimi

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani si do të reagonit nëse do të zbulonit krejt rastësisht se shoqja ose shoku juaj më i afërt, ka vuajtur për disa muaj dënim me heqje lirie për shkelje të lehta ose jo të ligjit.

Dt. ___/___/___

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
3.5 Tema mësimore: Shpjegime sociologjike të deviancës.		Situata e të nxënësit: Sociologët përgjithësisht arsyetojnë se shkaqet e deviancës janë të lidhura me faktorët socialë. Mësuesi/ja fton nxënësit të japin mendimet e tyre lidhur me këtë çështje dhe situatën në tekst.	
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon përfundimet kryesore të teorisë së kontrollit për shpjegimin e deviancës; -analizon përfundimet kryesore të teorisë së etiketimit për shpjegimin e deviancës; -përshkruan si përthihen shpjegimet sociologjike të deviancës në shoqërinë shqiptare; -vetëdijësohet dhe të angazhohet për të shmangur etiketimet që provokojnë sjellje deviante.		Konceptet kyçe: - shpjegim sociologjik i deviancës; - teoria e kontrollit; - teoria e etiketimit; - nofke përçmuese	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, psikologjia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e	

	nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, psikologjia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Harta e mendimit (cluster), punë në grupe, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	
Organizimi i orës së mësimi Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe nxit diskutimin mbi rolin e mjediseve shoqërore në nxitjen e njerëzve drejt sjelljeve deviante e kriminale. Si i shpjegon sociologjia ndikime të tilla shoqërore? Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup, praktikë e pavarur. Klasa ndahet në grupe, për të analizuar nga teksti teoritë e sociologëve të ndryshëm mbi shpjegimin e sjelljeve deviante. Hapi III: Përforsimi i të nxënit: rrjeti i diskutimit: pro/kundër. Nxënësit prezantojnë konkluzionet e punës në grup. Ata rendisin në tabelë përfundimet sipas teorive.	
Trevis Hirsh: Teoria e kontrollit.	Sjelljet deviante varet nga: lidhjet shoqërore; mundësitë; angazhimi dhe besimi.
Hauërd S. Beker: Teoria e etiketimit:	E njëjta sjellje mund të etiketohet në mënyra të ndryshme, duke u nisur nga këndvështrime të ndryshme...
Edvin Lemert: Devianca parësore dhe dytësore.	Devianca e parë pasohet nga sjellje të tjera deviante (dytësore)...
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipastemës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vlerësim për të tjerët c- vlerësim me anë të portofolit	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë shtëpie: Analizoni raste të njerëzve që kryejnë sjellje deviante, të cilët provojnë përfundime të teorisë së T. Hirshit.	

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
3.6 Tema mësimore: Funkcionet shoqërore të deviancës.		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja fton nxënësit të japin mendimet e tyre lidhur me situatën në tekst dhe drejton diskutimin drejt shkaqeve që nxisin sjelljet deviante në shoqëri.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon funksionet negative të sjelljeve deviante; -përshkruajë funksionet pozitive të sjelljeve deviante; -vetëdijësohet për të vënë në dukje funksionet		Koncepte kyçe: - funksion shoqëror negativ i deviancës; - funksion shoqëror pozitiv i deviancës; - ndëshkim; - riedukim.	

pozitive dhe negative të sjelljeve deviante në jetën e përditshme.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, psikologjia etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, psikologjia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, rrjeti i diskutimit, harta e konceptit, punë e pavarur individuale, ese përshkruese.	
Organizimi i orës së mësimi Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimin e situatës së dhënë në libër dhe identifikimin e problemit. Ajo/ai drejtojnë pyetjet: Devianca luan edhe rol pozitiv? Në cilat raste është e mundur kjo? Cilat janë funksionet shoqërore të deviancës? Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimit, harta e konceptit. Sociologët bashkëkohorë kanë argumentuar se sjelljet deviante kanë katër funksione kryesore, që tërthorazi ndihmojnë në procesin e shoqërizimit. 1. Devianca dhe pohimi i vlerave kulturore: shumica e anëtarëve të shoqërisë kuptojnë më mirë rëndësinë e vlerave kulturore dhe domosdoshmërinë e zbatimit me korrektësi të normave kulturore për mirë funksionimin e shoqërisë. 2. Sjelljet deviante dhe përcaktimi i kufijve moralë: Sjelljet devijante shpesh u mësojnë anëtarëve të një shoqërie kufijtë mes sjelljeve të pranueshme ose të kundërshtuara nga shumica. 3. Devianca dhe forcimi i unitetit shoqëror: Shumica e njerëzve të vetëdijshëm të shoqërisë përjetojnë ndjenjën e zemëratës morale kundër sjelljeve deviante, veçanërisht ndaj atyre serioze, krimeve. 4. Disa sjellje deviante – burim ndryshimesh shoqërore: Në rrjedhën e kohës disa sjellje deviante masivizohen dhe shkaktojnë ndryshime shoqërore të rëndësishme. Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: reflekto dhe përgjigju, ese përshkruese. Reflekto dhe përgjigju: 1. Si ndikojnë sjelljet deviante në pohimin e vlerave dhe të normave kulturore? 2. Ç’ndikim kanë sjelljet deviante në përcaktimin e kufijve moralë? 3. Pse dhe si sjelljet deviante nxitin forcimin e unitetit të grupeve shoqërore? 4. Cilat sjellje deviante ndikojnë në ndryshimet e mëdha shoqërore? 5. Cilat janë idetë kryesore për rolin edukues dhe joedukues të burgjeve për kriminelët? Cilat janë masat që duhet të marrë shoqëria dhe shteti për ndëshkimin e krimeve dhe riedukimin e kriminelëve? Përshkruani në formën e esës temën: “Një model sjellje deviante që shqetëson më shumë të rinjtë adoleshentë në vendin tonë”.	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipastemës mësimore. a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi c- vlerësim me anë të portofolit	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.	

3.7 Veprimtari

Tema: Krimet e urrejtjes dhe pasojat shoqërore

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës. *Nxënësi/ja në fund të orës së veprimtarisë:*

- Përshkruan krimin e urrejtjes ose të mërisë dhe faktorët që nxisin këtë lloj krimi;
- dallon format specifike të shfaqjes së krimeve të tilla historikisht dhe në shoqërinë e sotme;
- analizon pasojat e krimit të urrejtjes ndaj grupeve të veçanta të popullsisë dhe shoqërisë në tërësi;
- mban qëndrim ndaj sjelljeve paragjyquese në shoqëri, tek të afërmit, etj.

Lexim orientues

Krimet e urrejtjes konsiderohen si sulme ndaj individëve të bazuara në paragjykimet racore, fetare, etnike ose karakteristikat personale si orientimi seksual etj.

Paragjykimet të tilla tek njerëzit, shfrytëzohen nga qarqe të ndryshme politike, fanatikë fetar, mafia etj., duke çuar shpesh në katastrofa humane. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës këto lloje krimesh u bënë të njohura me krijimin e organizatës së Ku Klux Klanit (mars 1865), që bazohej në urrejtjen ndaj grupeve të tjera për motive racore (kryesisht ndaj afro-amerikanëve), por edhe fetare (anti-semite), orientimit seksual etj. Shumë njerëz sot i konsiderojnë si akte terrorizmi, për shkak të kontrollit të viktimitave përmes frikës.

Teoria e racave e nazistëve është një shembull tragjik në historinë e njerëzimit, që çoi në zhdukjen e të paktën 6 milion izraelitëve, bazuar në një urrejtje absurde të Hitlerit ndaj tyre. Po kështu, spastrimet etnike në Kosovë dhe Bosnje përdorën dallimet etnike mes popujve etj. Në ditët e sotme janë të njohura aktet terroriste nga Al Qaeda, ISIS, të cilët shfrytëzojnë devotshmërinë e njerëzve ndaj fesë për qëllimet e tyre antihumane.

Forma aktuale të krimit të urrejtjes janë ato ndaj komuniteteve gej, të cilët jo rrallë janë viktima të dhunës fizike dhe presionit psikologjik. Kjo çon në përjetime negative emocionale dhe probleme me shëndetin mendor si frikë, ankth, depresion etj.

Çështje që mund të trajtohen në grupe:

Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë rreth formave të ndryshme që marrin krimet e mërisë ose urrejtjes, si



psh me natyrë racore, fetare, etnike dhe seksuale. Sillni shembuj nga aktualiteti në vendin tonë dhe nga historia e kulturave të tjera.

Çështje për diskutim:

- Diskutoni rreth mendësive në shoqërinë shqiptare për krimet e urrejtjes. Sillni shembuj nga opinionet e të njohurve tuaj, miqve, familjarëve etj.
- Krahasoni shoqërinë shqiptare me kulturat e vendeve të tjera në trajtimin e dallimeve racore, fetare etj. mes individëve. Cili është konkluzioni juaj?
- Analizoni sjellje me natyrë homofobike në rrethin tuaj shoqëror dhe pasojat e tyre. Cili është

qëndrimi juaj ndaj këtyre sjelljeve?

- Shpjegoni rolin negativ që luajnë paragjykimet e ndryshme në cënimin e harmonisë dhe respektit reciprok.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
4.1 Tema mësimore: Shtresimi gjinor dhe lëvizjet feministe.		Situata e të nxënët: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën e dhënë në tekst. Lufta e grave për të fituar të drejta të barabarta me burrat është e hershme dhe vazhdon sot e kësaj dite.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> -analizon format kryesore të pabarazisë gjinore; -vetëdijësohet për rolin e gruas në shoqërinë shqiptare, si faktor ekuilibrimi në komunikim dhe në jetën politike; -rendit pikësynimet kryesore të lëvizjes feministe; - vetëdijësohet për rëndëisnë e kësaj lëvizje në mbrojtje të të drejtave të gruas.		Koncepte kyçe: - pabarazi gjinore; - diskriminim gjinor; - shtresim gjinor; - lëvizje feministe.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, harta e mendimit (cluster), rrjeti i diskutimeve, debat dhe dialog, përmbledhja pohim/mbështetje.			
Organizimi i orës së mësimin Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimin e situatës së dhënë në libër dhe identifikimin e problemit: pabarazitë ndërgjinore në përpjesëtime të caktuara janë të pranishme në të gjithë veprimtaritë e shoqërisë. Nxënësit japin idetë e tyre mbi kuptimin e pabarazisë dhe diskriminimit gjinor, si shfaqet ai në fusha të ndryshme, veçanërisht në vendin tonë. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimeve, debat dhe dialog. Mësuesja/i drejton diskutimin mbi rolin e gruas në veprimtarinë jetësore të shoqërisë, në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë. Së bashku me nxënësit klasifikon në tabelë 4 drejtimet kryesore:			
punësim dhe të ardhura jetën politike Pabarazia ndërgjinore, shprehet në: punët e shtëpisë shpërpjesëtimet mes arsimimit dhe punësimit			

Hapi III: Përforsimi i të nxënës:

përmbledhja pohim/mbështetje.

Nxënësit diskutojnë bashkë me mësuesin/en objektiva kryesore të lëvizjes feministe, duke i renditur në tabelë dhe duke dhënë argumente mbështetëse:



Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Analizoni mendësitë dhe praktikën e ndarjes së punëve të shtëpisë ndërmjet bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre, vajza dhe djem në familjet shqiptare.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
4.2 Tema mësimore: Martesa		Situata e të nxënës: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë mbi situatën në tekst. Institucioni i martesës vazhdon të luaj luan një rol të rëndësishëm në strukturimin e marrëdhënieve shoqërore.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -shpjegon konceptin sociologjik të martesës; -përshkruan format kryesore të martesës; -analizon funksionet e veçanta të ekzogamisë dhe të poliginisë në shoqërinë tradicionale shqiptare; -përfshihet në veprimtari që promovojnë vlerat e veçanta të martesës në shoqërinë shqiptare.		Fjalë kyçe: - martesë; - endogami; - ekzogami; - monogami; - poliandri; - poligini - bashkëjetesë.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia,	

	interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodat e përdorura: Brainstorming, grupi i ekspertëve, debat dhe dialog, rrjeti i diskutimit: pro/kundër.	
Organizimi i orës së mësimi	
Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe diskutimin e situatës së dhënë në libër. Së bashku diskutojnë për rëndësinë e madhe shoqërore të martesës dhe traditave shqiptare në këtë drejtim. Martesa krijon marrëdhënie afrimiteti e bashkëpunimi jo vetëm ndër personat që martohen, por edhe ndërmjet anëtarëve të fiseve e të miqve të tyre.	
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe ekspertësh, praktikë e pavarur.	
Mësuesja/i shpjegon konceptet e reja të temës që lidhen me përcaktimin sociologjik të martesës dhe format që ajo ka marrë gjatë historisë në kultura të ndryshme, si poliandria, poliginia, monogamia etj.	
Nxënësve iu është dhënë si detyrë paraprake të hulumtojnë materiale që lidhen me temën e punës në grupe.	
Konkretisht:	
Grupi I: modele martesash që kanë ekzistuar në Shqipëri para vendosjes së sistemit komunist.	
Grupi II: forma të martesave gjatë sistemit komunist.	
Grupi III: martesat pas vitit 1990.	
Secili grup prezanton punën e tij, duke diskutuar edhe me nxënësit e tjerë pikat më interesante. Mësuesja/i drejton me kujdes debatin, që mund të krijohet kur diskutohen të tilla problematika.	
Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: rrjeti i diskutimit të strukturuar: pro/kundër.	
Shoqëria e sotme moderne po krijon sfida të reja për martesat tradicionale, si bashkëjetesa, martesat brenda të njëjtës gjini etj. Nxënësit japin argumentet e tyre përmes një diskutimi të strukturuar, ku gjithsecili respekton fjalën dhe opinionin e të tjerëve, pa paragjykuar.	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.	
a- vlerësim formues	
b- vlerësimi për tjetrin	
c- vlerësim me anë të portofolit	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.	

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
4.3 Tema mësimore: Familja.		Situata e të nxënësve: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst, mbi rëndësinë e familjes dhe evoluimin e saj gjatë historisë së njerëzimit. Familja mbetet elementi bazë që ndërton shoqërinë dhe siguron kohezionin social.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësja/i: -shpjegon kuptimin sociologjik të familjes; -përshkruan evolucionin e formave kryesore të familjes në shoqërinë moderne; -analizon bashkëjetesën, si formë të jetës familjare të ditëve tona.		Koncepte kyç: - familje; - familje e hapur; - familje patriarkale; - familje bërthamë e mbyllur; - familje me një prind..	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	

interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, psikologjia.	Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodat e përdorura: Brainstorming, rrjeti i diskutimit, harta e konceptit, reflekto dhe përgjigju.	
Organizimi i orës së mësimit	
Hapi I: Mësuesja/i bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimine situatës së dhënë në libër dhe identifikimin e problemit: Cili është roli i familjes sot? Cilat anë kanë ndryshuar? Si e vlerësoni ju rolin e saj?	
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimit, harta e konceptit. Mësuesi/ja jep përcaktimin e familjes nga ana sociologjike. Ai/ajo përshkruan fazat e evolucionit të saj gjatë historisë: familja e hapur, familja patriarkale, familja bërthamë e mbyllur dhe format bashkëkohore të familjes si ato me një prind, me prindër të të njëjtës gjini, në bashkëjetesë etj.	
Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: reflekto dhe përgjigju Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve reflektuese të mëposhtme:	
• Ç’është familja? • Cilat janë karakteristikat kryesore të familjes së hapur? • Cilat janë karakteristikat kryesore të familjes patriarkale? • Cilat janë veçoritë kryesore të familjes bërthamë të mbyllur? • Si e vlerësoni ju të ardhmen e familjes?	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.	
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.	
Detyrë me shkrim: Përshkruani mendimet tuaja për bashkëjetesën.	

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
4.4 Tema mësimore:		Situata e të nxënësve: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst. Përgjithësisht, familja është vendi ku individi edukohet, gjen dashuri, ngrohtësi dhe mbështetje.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësja/i: -analizon funksionet kryesore të familjes në shoqërinë moderne; -përshkruan veçoritë e funksioneve të familjes në shoqërinë shqiptare të ditëve tona; -analizon përkushtimin e veçantë të familjes shqiptare për mirërritjen dhe mirarsimimin e fëmijëve.		Konceptet kyçe: - funksion i familjes; - shoqërizim i fëmijëve; - shoqërizim i të rriturve; - tabu e incestit; - riprodhim; - nxitje emocionale; - përkrahje ekonomike.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, foto, video, historia, filozofia, psikologjia.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, organizuesi grafik, reflektio dhe përgjigju.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: Cilat janë funksionet e familjes sot, në kushtet e zhvillimit të vrullshëm të shoqërisë? Nxënësit shprehin idetë e tyre, duke respektuar opinionet e njëri-tjetrit.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup, praktikë e pavarur, rrjeti i diskutimit, organizuesi grafik. Klasa ndahet në grupe, ku secili grup përgatitet për njërin nga funksionet e familjes. Mund të përdorin tekstin, por edhe burime të tjera informacioni, internetin: foto, video, etj.

Së bashku me mësuesen/in ndërtojnë hartën e konceptit, duke diskutuar për rëndësinë e secilit funksion dhe ndryshimin e tij në kohë.



Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Reflektio dhe përgjigju.

- Cilat janë dy drejtimet kryesore të procesit të shoqërizimit që kryen familja?
- Çfarë vlere ka për fëmijët statusi i trashëguar nga familja?
- Pse familja luan rol të veçantë në nxitjen emocionale të anëtarëve të saj, sidomos të fëmijëve dhe të rinjve?
- Ç'rol të veçantë luan familja shqiptare për arsimimin e fëmijëve?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Analizoni me shkrim dëshirat dhe sakrificat e prindërve shqiptar për mirarsimimin e fëmijëve të tyre në Shqipëri ose në vende të tjera.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
4.5 Tema mësimore: Divorci dhe e ardhmja e familjes.		Situata e të nxënët: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë së bashku situatën e dhënë në tekst. Nxënësit shprehin mendimet e tyre në lidhje me dukurinë e divorcit dhe efektet e tij në shoqëri.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> -analizon dukurinë komplekse të divorcit -përshkruan faktorët kryesorë që përcaktojnë ecurinë e divorceve në shoqëritë perëndimore; -analizon veçoritë e divorceve dhe të rrjedhøjave kryesore të tyre në shoqërinë shqiptare; -përshkruajë vizionet kryesore të sociologëve për të ardhmen e familjes.		Koncepte kyç: - divorc; - faktorë përcaktues të divorcit; - përjetime të divorcit nga fëmijët; - e ardhmja e familjes.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, foto, video, historia, filozofia, psikologjia.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, klaster, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, rrjeti i diskutimit.			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: divorci një shqetësim në rritje për shoqërinë. Në shumë vende të botës, kryesisht të zhvilluara, por edhe ato në zhvillim, vihet re një ngritje e tendencës për divorc. Cilat janë faktorët që nxitin divorcin? Si ka ndryshuar mentaliteti edhe në Shqipëri për çiftet që divorcohen? Si e vlerësoni ju këtë dukuri?			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, lexim i orientuar i tekstit.			
Faktorët që nxisin divorcin:			
Pavarësia ekonomike e grave; Rritja e nivelit të arsimit dhe e personalitetit të grave Ndryshimet në statuset e bashkëshortëve Jetesa më e individualizuar Demokratizimi i legjislacionit			
Hapi III: Përforsimi i të nxënët: Nxënësit prezantojnë punën e tyre, duke analizuar faktorin përkatës dhe duke bashkërenduar argumentet e tyre me grupet e tjera.			
Më pas, mësuesja/i drejton diskutimin në një nga pasojat më të rëndësishme të divorcit si: shqetësim dhe ankth për fëmijët.			
Nxënësit mbajnë qëndrimin e tyre ndaj këtij problem, duke dhënë vizionet që ata kanë për të ardhmen e familjes, si dhe format e reja të saj në kohët e sotme.			
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënët mbështet në rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>			
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:			
a- vlerësim formues			

b- vetëvlerësimi dhe vlerësim për tjetrin

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani mendësitë e të afërmeve ose shoqeve dhe shokëve tuaj për divorcin dhe njerëzit e divorcuar.

4.6 Veprimtari

Tema: Familja, martesë dhe sfidat e shoqërisë së sotme

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës. Nxënësja/i në fund të orës së veprimtarisë:

- Shpjegon funksionet kryesore të martesës dhe familjes.
- rendit pikëpamjet kryesore për dilemën bashkëkohore: martesë apo bashkëjetesë.
- përshkruan mendësitë kryesore të shoqërisë shqiptare për këtë dilemë.
- mirëkupton dhe respekton të gjithë anëtarët e shoqërisë, pa dallim përkatësie gjinore, racor, kulturor, orientimi seksual, etj.
- shfrytëzojnë burimet të ndryshme, duke gjykuar vlefshmërinë e tyre.

Lexim orientues

Sociologët i shohin martesën dhe familjen si institucione shoqërore që ndihmojnë në krijimin e strukturës bazë të shoqërisë. Ato praktikohen në forma të ndryshme në varësi të kulturave dhe ndryshimeve në kohë.

Historikisht martesë ka shërbyer për të krijuar familjen, por ky koncept po ndryshon vazhdimisht. Rritja e numrit të çifteve që bashkëjetojnë, partnerët e të njëjtit seks dhe njerëzit që vendosin të jetojnë vetëm, po ndryshojnë idenë mbi martesën. Po kështu, prindërit e vetëm, ata të të njëjtit seks, çiftet bashkëjetuese apo të pamartuarit, po ndryshojnë kuptimin që ne kemi për familjen.

Megjithatë, për shumicën e njerëzve në botë, familja dhe martesë, që i parapaprin asaj, mbeten mjaft të rëndësishme.



Familja është qeliza bazë e shoqërisë, ku shumica e njerëzve gjejnë mirëqenie, dashuri dhe mbështetje. Prindërit kujdesen dhe shoqërizojnë fëmijët deri sa ata bëhen të pavarur dhe më pas, gjatë jetës, fëmijët kujdesen për prindërit e moshuar.

Bashkëjetesë apo martesë?

Bashkëjetesa, ku çifti ndan vendbanimin, marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe seksuale pa qenë të martuar, është bërë një formë më e pranueshme vitet e fundit. Kjo ka krijuar tek të rinjtë idenë se martesë po bëhet një formë e vjetëruar.

Çështje për diskutim:

Bashkëjetesa ndikon në:

a) Shtyrjen e moshës së martesës, sepse të rinjtë:

- preferojnë të ndajnë më shumë kohë së bashku, për të njohur më mirë njëri-tjetrin;
- kërkojnë të përfundojnë arsimimin dhe të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale;
- dëshirojnë të krijojnë kushte sa më komode jetese për vete dhe fëmijët;
- kërkojnë të shijojnë jetën, pa marrë përsipër shumë përgjegjësi.

b) Martesën e pjesës më të madhe të çifteve bashkëjetuese.

c) Jetëgjatësinë e martesës dhe pakësimin e numrit të divorceve.

- d) Rënien e numrit të lindjeve.
 e) Mungesën e përgjegjësisë ligjore dhe morale të prindërve ndaj fëmijëve.
 f) Problemet me ndarjen e pasurisë dhe kontributit të përbashkët të çiftit, që duan t’i japin fund bashkëjetesës.

Çështje që mund të trajtohen në grupe:

Grupet diskutojnë duke dhënë argumente bindëse të bazuara në studime dhe statistika, të kryera në Shqipëri dhe jashtë saj.

Grupi I: Martesa, roli dhe funksionet e saj gjatë historisë.

Grupi II: Sfidat e shoqërisë moderne ndaj formave klasike të martesës.

Grupi III: Familja roli dhe funksionet e saj.

Grupi IV: Forma të reja të familjes në shoqërinë bashkëkohore.



Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
5.1 Tema mësimore: Racat dhe etnitë.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst, lidhur me përcaktimin e koncepteve racë dhe etni, si dhe dallimet mes tyre.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -shpjegon konceptin racë dhe karakteristikat kryesore të racave; -shpjegon konceptin etni dhe dallimet kryesore ndërmjet etnisë dhe racës; -shpjegon konceptet pakicë kombëtare dhe pakicë etnike; -vetëdijësohet për rëndësinë e marrëdhënieve harmonike ndërmjet grupeve racore dhe etnike; -përfshihet në veprimtari kundër paragjykimeve racore dhe etnike.		Fjalët kyçe: - racë; - racë kaukaziane; - racë mongoloide; - racë negroide; - pakicë kombëtare; - pakicë etnike.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, diskutim i strukturuar pro/kundër.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe diskutimin e situatës së dhënë në libër, duke identifikuar problemin që, shpesh, këto koncepte përdoren në kuptimin e gabuar të tyre.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe (sipas rreshtave), praktikë e pavarur, diskutim i strukturuar.

Grupi I: Racat dhe klasifikimi i tyre sipas veçorive biologjike.

Grupi II: Etnitë, përcaktimi sociologjik dhe tiparet e tyre.

Grupi III: Pakicat ose minoritetet, karakteristikat dhe format e tyre.

Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: diskutim i strukturuar pro/kundër

Nxënësit prezantojnë argumentet e tyre sipas temës përkatëse të secilit grup. Diskutimi mund të bëhet rreth çështjeve si:

- Paragjykime të ndryshme të shoqërisë tuaj për aftësitë e njerëzve të racave të ndryshme.

- Mendësi që qarkullojnë në mjediset ku ju jetoni për njerëzit me përkatësi etnike joshqiptare.

Mësuesi/ja ruan balancën e diskutimit dhe debatit që mund të krijojnë tema të tilla me ndjeshmëri shoqërore.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:


a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Arsyetoni pse parapëlqeni ose jo, që bashkëshorti/ bashkëshortja juaj e ardhshme të jetë me përkatësi racore ose etnike të ndryshme nga ajo e juaja.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
5.2 Tema mësimore: Marrëdhëniet ndërmjet grupeve racore dhe etnike.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst, që lidhen me qëndrimet paragjyquese racore dhe etnike. Pse ndodh kështu? Si i shpjegon sociologjia dukuri e marrëdhënie të tilla?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> <i>-shpjegon natyrën e paragjykimeve racore dhe etnike;</i> <i>-analizon stereotipat dhe racizmin si forma kryesore të paragjykimeve etnike e racore;</i> <i>-shpjegon diskriminimin dhe format e tij;</i> <i>-vetëdijësohet për rrjedhojat e shumëfishta shoqërore të paragjykimeve dhe të diskriminimit.</i>		Koncepte kyç: - <i>paragjykim;</i> - <i>stereotip;</i> - <i>racizëm;</i> - <i>diskriminim pozitiv;</i> - <i>diskriminim negativ.</i>	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Diskutime, grupet e ekspertëve, organizues grafik, përmbledhja pohim/mbështetje.			

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I:**

Mësuesi/ja bën lidhjen e temës me njohuritë nga temat e mëparshme. Identifikohet problemi: paragjykimet me natyrë raciale dhe etnike kanë karakterizuar të gjithë historinë e njerëzimit. Pse ndodh kështu? Si i shpjegon sociologjia dukuri dhe marrëdhënie të tilla? Nxënësit shprehin opinionet e tyre lidhur me këto çështje.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: grupet e ekspertëve, organizues grafik.

Mësuesi/ja shpjegon konceptet e reja, duke dhënë përcaktimet e tyre, si p.sh.: ç'janë paragjykimet, format e shprehjes së tij si: stereotipat, racizmi dhe diskriminimi: pozitiv, negativ dhe institucional. Ajo/ai i vendos këto njohuri në formën e një harte koncepti.

Nxënësit kanë mbledhur paraprakisht informacione për çështjet që do të diskutohen në grupe.

Grupi I: Paragjykimet racore dhe etnike, pasojat e tyre për marrëdhënie harmonike në shoqëri.

Grupi II: Diskriminimi racor ose etnik, rrezikshmëria e tij në raport me grupime të caktuara të popullsisë.

Grupi III: Diskriminimi institucional ndaj pakicave dhe pasojat e tij.

Grupi IV: Paragjykimet me natyrë racore ose etnike që qarkullojnë në bisedat me shoqet dhe shokët, me miqtë dhe të afërmit tuaj. Shembuj ilustrues.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: përmbledhja pohim/mbështetje.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë punën e tyre në grupe ekspertësh, pasi kanë hulumtuar informacione të sakta bashkëkohore, shifra, fakte dhe shembuj realë për konkretizim. Ata japin argumente bindëse për të mbështetur qëndrimet e tyre.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësimi

c- vlerësim me anë të portofolit

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
--------------------------------------	--------------------------	--------------------	-------------------

5.3 Tema mësimore: Marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne.	Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst. Shoqëritë moderne krijojnë marrëdhënie të ndryshme me pakicat, sipas kushteve dhe politikave të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon rëndësinë shoqërore të marrëdhënieve ndërmjet popullsisë në shumicë dhe pakicave etnike; -dallon katër modelet kryesore të marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike; -përshkruan përparësitë dhe rrjedhojat negative të katër modeleve të marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike;	Koncepte kyç: - marrëdhëniet mes shumicës dhe pakicave etnike; - pluralizëm; - asimilim; - veçim; - shfarosje.
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, letërsia, sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodat e përdorura: Brainstorming, rrjeti i diskutimit, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, reflekto dhe përgjigju.	
Organizimi i orës së mësimin Hapi I: lidhja e mëparshme, dhënë në libër dhe dilema e ruajtjes së kulturës së origjinës sunduese për të bërë ndryshme? Ky mprehtë tek të rinjtë, modelet e grupeve etnike. Cilat shpjegohen nga Hapi II: ndërtimi i diskutimit, shënime të strukturuar, organizuesi grafik. Mësuesi/ja orienton klasën tek shënime të strukturuar në tekst. Nxënësit nxjerrin pikat kryesore, si dhe pyetjet për paqartësitë që mund të kenë. Së bashku ndërtojnë hartën e konceptit mbi format e marrëdhënieve mes shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne. <pre> graph TD A[Pluralizmi - grupet racore ose etnike kanë mundësi të barabarta në shoqëri.] --> B[Asimilimi - anëtarët e pakicave ndryshojnë mënyrën e jetesës për t'iu përshtatur modeleve të kulturës sunduese.] B --> C[Veçimi fizik dhe shoqëror i grupimeve të ndryshme nga shumica e popullsisë.] C --> D[Shfarosja ose zhdukja e një grupimi njerëzish nga një tjetër nëpërmjet përdorimit të dhunës.] </pre> temës me temat e diskutim i situatës së identifikimi i problemit: vlerave tradicionale të apo përshtatja me kulturën karrierë në fusha të problem është më i dhe përcaktohet nga marrëdhënieve ndërmjet janë këto modele? Si sociologjia? njohurive të reja: rrjeti i	

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: reflekto dhe përgjigju.

-  Si përcaktohet pluralizmi në marrëdhëniet ndërmjet shumicës së popullsisë së një shoqërie dhe pakicave racore ose etnike?
-  Ç'është asimilimi i grupeve racore apo etnike dhe si shfaqet ky proces?
-  Si shfaqet dukuria e veçimit të pakicave racore apo etnike?
-  Pse shfaqet përfaqëson formën më të skajshme të dhunimit të vlerave dhe normave kulturore më të përparuara të njerëzimit?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipastemës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësimi formues dhe i vazhdueshëm

b- vlerësimi për tjetrin.

Detyrë me shkrim: Përshkruani ndonjë situatë të marrëdhënieve harmonike ndërmjet shqiptarëve dhe anëtarëve të pakicave racore ose etnike.

Dt. ____/____/____


Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
5.4 Tema mësimore: Pakicat kombëtare dhe grupet etnike në Republikën e Shqipërisë.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë mbi situatëne dhënë në tekst. Ata përqëndrohen tek qëndrimet tolerante dhe harmonike të shqiptarëve ndaj pakicave në periudha të ndryshme të historisë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -përshkruan shkallën e pranisë dhe rrugët e formimit të pakicave kombëtare dhe grupeve etnike në Republikën e Shqipërisë; -analizon mekanizmat psikokulturor që përcaktojnë marrëdhëniet harmonike ndërmjet shqiptarëve dhe anëtarëve të pakicave kombëtare dhe etnike; -përfshihet në diskutime dhe veprimtari që përmirësojnë marrëdhënie të tilla.		Koncepte kyç: - status i pakicës kombëtare në Shqipëri; - status i pakicës etnike në Shqipëri; - profil psikokulturor.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Metodat e përdorura: Brainstorming, rrjeti i diskutimit, grupet e ekspertëve, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, reflektio dhe përgjigju.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe diskutimi i situatës së dhënë në libër. Mësuesja/i pohon se Republika e Shqipërisë është një ndër 3–4 shtetet në botë që kanë popullsi etnikisht më pak të përzier dhe së bashku me nxënësit analizojnë faktorët që kanë ndikuar.

Hapi II: Nxënësit të ndarë sipas grupeve kanë mbledhur materiale nga burime të ndryshme informacioni mbi çështjen e marrëdhënieve të shqiptarëve me pakicat kombëtare dhe etnike, përgjatë historisë dhe në ditët e sotme. Pasi referojnë punën e tyre kërkimore, ndërtojnë së bashku hartën e konceptit.



Hapi III: Përforcimi i të nxënit: reflektio dhe përgjigju.

- ✚ Pse në Republikën e Shqipërisë ka pak popullsi me përkatësi kombëtare joshqiptare?
- ✚ Si janë formuar pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë?
- ✚ Cilat janë grupet etnike më të përhapura në Republikën e Shqipërisë?
- ✚ Si shpjegohen marrëdhëniet përgjithësisht harmonike ndërmjet shqiptarëve dhe pakicave kombëtare apo etnike?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

- a- vlerësim formues
- b- vetëvlerësimi
- c- vlerësim me anë të portofolit

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Përshkruani disa dallime mes kulturës materiale dhe formimit shpirtëror të shqiptarëve dhe të anëtarëve të pakicave kombëtare ose etnike, që janë të pranishme në qytetin ose krahinën tuaj.

5.5 Veprimtari praktike

Tema: “Mirëkuptim dhe respekt mes shqiptarëve dhe pakicave”

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave. Nxënësja/i në fund të orës së veprimtarisë:

- Zhvillon aftësinë e bashkëpunimit në grup për realizimin e objektivave të veprimtarisë;
- përshkruan veçoritë e marrëdhënieve të shqiptarëve me pakicat kombëtare në vendin tonë;
- mban qëndrim kritik ndaj qëndrimeve paragjyquese me natyrë etnocentrike ndaj kulturave të tjera;
- shfrytëzon burime të ndryshme dhe përdor teknologjinë e informacionit për përgatitjen e paraqitjeve

grafike.

Lexim orientues: Pjesë nga përshëndetja e Komitetit të Hebrenjve të Jugosllavisë drejtuar Qeverisë së Shqipërisë, maj 1945.

“Kur hebrenjtë e Jugosllavisë, Polonisë, Gjermanisë etj., shuheshin me gaze e mjete hekuri nga nazifashistët, pa dallim, burra, gra e fëmijë, në Ballkan ishte një popullqë u ngrit mbi çdo teori racore dhe mbi qytetërimin perëndimor, populli hero dhe mikpritës i Shqipërisë...Në historinë e kësaj lufte do të mbetet i shënuar një popull i vogël, por bujar dhe heroik, populli shqiptar, i cili do të shënohet ndoshta i vetmi nga të gjithë popujt e pushtuar të Europës, që pengoi dhe ndaloi shfarosjen dhe përndjekjen e hebrenjve”.

Apostol Kotani: Hebrenjtë në Shqipëri gjatë shekujve”, Botime “Dituria”, Tiranë, 1996, f.5.

Historikisht, në shumicën e shteteve të mëdha, ka ekzistuar një marrëdhënie e paqëndrueshme dhe e ndërlikuar mes shumicës së popullsisë dhe pakicave kombëtare ose grupeve etnike. Shkaqet për probleme të tilla janë të shumta, që nga politikat e ndjekura nga qeveritë përkatëse dhe deri tek tiparet psikokulturore të grupimeve të ndryshme të popullsisë. Në kulturën tradicionale shqiptare, por edhe në historinë moderne të saj, pakicat kanë qenë të mbrojtura dhe të respektuara më shumë se në çdo vend tjetër të Europës.

Çështje që mund të trajtohen në grupe:

Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë marrëdhëniet e shqiptarëve me pakicat, të specifikuar sipas kohës kur funksionuan, si për shembull: para vendosjes së rregjimit komunist, gjatë sundimit të shteti socialist totalitar, pas vendosjes së demokracisë dhe deri më sot.

Çështje për diskutim:

- Dalloni veçoritë e politikave të ndjekura ndaj minoriteteve në Shqipëri, sipas periudhave të ndryshme historike.
- Analizoni faktorët që kanë ndikuar në marrëdhënien harmonike të shqiptarëve me pakicat kombëtare dhe etnike. Ilustroni me shembuj nga historia.
- Shpjegoni rëndësinë e ligjeve në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve që jetojnë brenda shumicës vendase.
- Analizoni paragjykime me natyrë etnike, që keni hasur në biseda me shoqet dhe shokët, të afërmit etj.



Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
6.1-6.2 Tema mësimore: Feja dhe funksionet		Situata e të nxënës: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë	

shoqërore të saj.	situatën në libër.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -shpjegon përcaktimet kryesore sociologjike të fesë; -përshkruan funksionet kryesore sociologjike të besimeve fetare; -vetëreflekton rreth ndikimit të besimeve fetare në jetën vetjake; -analizon rolin e veçantë të vlerës kulturore të tolerancës, të harmonisë ndërfaqetare në shoqërinë shqiptare.	Koncepte kyç: - fe; - profane; - e shenjtë; - funksion shoqëror i fesë; - tolerancë fetare; - tolerancë - harmoni ndërfaqetare.
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, fjalor, foto, video, historia, filozofia, sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodat e përdorura: brainstorming, lexim i orientuar në grupe, shënime të strukturuar, organizues grafik, diskutim, debat dhe dialog.


Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimi i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: diskutimet për perënditë dhe besimet fetare zënë vend të rëndësishëm në historinë e zhvillimit të kulturës së njerëzimit. Cilat janë interpretimet kryesore të sociologjisë për dukurinë aq komplekse të fesë dhe funksionet e saj në shoqëri? Nxënësit shprehin opinionet e tyre lidhur me temën.

Hapi II: ndërtimin e njohurive të reja: punë e pavarur në grupe, shënime të strukturuar, harta e konceptit, diskutime.

Mësuesi/ja shpjegon përcaktimin sociologjik të fesë (sipas Emil Dyrhejm) dhe veçoritë e besimeve ndaj fesë.

Nxënësit punojnë, sipas grupeve, me tekstin duke veçuar secili nga një funksion kryesor të fesë në jetën e shoqërisë. Prezantojnë punën e tyre duke argumentuar dhe mbajtur qëndrimin e tyre dhe së bashku me mësuesin/en ndërtojnë organizuesin grafik:



Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Nxënësit reflektojnë ndaj pyetjeve të mësuesit/es në fazën e fundit të orës.

- Si e përcakton sociologu Emil Dyrhejm kuptimin e fesë?
- A bazohen të gjitha fetë në përfytyrimet për forcat e mbinatyrshme?
- Cili është kuptimi sociologjik bashkëkohor për fenë?
- Sa dhe si ndikon feja në forcimin e unitetit të anëtarëve të shoqërisë?
- Pse dhe si shërbejnë dallimet fetare si bazë e ndasive dhe e konflikteve shoqërore?
- Si ndikojnë besimet fetare në kontrollin e zbatimit të normave kulturore e ligjore?
- Cilat janë disa arsye të fetare kryesore, që ndikojnë në baraspeshën psikologjike dhe përcaktimin e kuptimit të jetës së njerëzve?
- Pse krijohet e shenja sipas sociologëve?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësimi

c- vlerësim me anë të portofolit

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përkthyeri rastë të njerëzve jobesimtarë që iu drejtohen forcave mbi natyrore kur ndodhen në situatë të vështirë ose të rrezikshme.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
6.3 Tema mësimore: Tipat e organizatave fetare zyrtare.		Situata e të nxënrit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë mbi tipet e organizatave fetare që nxënësit njohin.	
Rezultatet e të nxënrit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: <i>-përshkruan karakteristikat e organizatave fetare zyrtare, eksesi dhe dinominejshën;</i> <i>-njeh veçoritë e procesit të laicizmit dhe dallimet e tij nga ateizmi.</i> <i>-njeh organizatat fetare zyrtare në shoqërinë shqiptare;</i> <i>- vetëdijësohet për të respektuar besimtarët pavarësisht nga dallimet mes feve të tyre.</i>		Koncepte kyç: - <i>organizatë fetare zyrtare;</i> - <i>eklesi;</i> - <i>dinominejshën;</i> - <i>laicizëm;</i> - <i>ateizëm</i>	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, shënime të strukturuar, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: Çfarë janë organizatat fetare zyrtare? Cilat janë tiparet e tyre? Si kanë ndryshuar ato në rrjedhën e kohës? Si shpjegohet jetëgjatësia dhe qëndrueshmëria e tyre në kohë?

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: harta e konceptit, rrjeti i diskutimit.

Mësuesi/ja shpjegon konceptet e reja si eklesi dhe dinominejshën, si organizata fetare zyrtare, ateizëm, laicitet etj. Nxënësit pasi kanë lexuar tekstin, japin idetë mbi tiparet dalluese të tyre dhe i shënojnë në hartën e konceptit së bashku me mësuesen/in:

Eklesia	Dinominejshën
• e lidhur zyrtarisht me shtetin; • kanë pasues shumicën e anëtarëve të shoqërisë; • përshtasin anëtarët me politikat shtetërore; • janë shumë pak ose aspak tolerantë ndaj feve të tjera; • nuk pranojnë pluralizmin fetar brenda shtetit; • arsimi dhe edukimi i lidhur me fenë.	• nuk lidhet zyrtarisht me shtetin; • është më tolerante sesa eklesia; • pranojnë pluralizmin fetar; • rrit shkallën e pavarësisë së organizatave fetare zyrtare nga shteti; • rrit shkallën e lirisë së vetëdijes fetare të njerëzve; • arsimi dhe shkolla janë laike (të ndara nga feja).

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Rrjeti i diskutimit.

Në Shqipëri: Kisha Katolike Shqiptare, Kisha Ortodokse Shqiptare, Komuniteti Mysliman Shqiptar, Komuniteti Bektashian Shqiptar dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë janë dinominejshën, d.m.th. organizata fetare zyrtare të palidhura zyrtarisht me shtetin shqiptar. Çfarë tregon ky fakt? Si e vlerësoni ju?

Në kushteturen e RPSSH, gjatë sistemit komunist, pohohej se: "shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste". Diskutoni çështjen e lirisë së besimit fetar pas ardhjes së demokracisë dhe deri sot. Çfarë vini re? Jepni gjykimin tuaj ndaj prezencës së shumë besimeve fetare në Shqipëri, në raporte të barabarta me shtetin dhe ligjet.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësimi

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani mendësi laike dhe qëndrime ateiste ndër shoqet dhe shokët tuaj të shkollës. Mbani qëndrimin tuaj.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
6.4 Tema mësimore: Tipat e organizatave fetare jozyrtare.		Situata e të nxënësve: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë mbi tipet e organizatave fetare që nxënësit njohin dhe përhapjen e tyre pas ardhjes së demokracisë.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -përshkruan karakteristikat kryesore të sekteve dhe kulteve; -analizon dallimet mes organizatave fetare zyrtare dhe jozyrtare; -vetëdijësohet për të respektuar anëtarët e organizatave të tjera fetare, pavarësisht nga ndryshimi.		Koncepte kyç: - organizatave fetare jozyrtare; - sektit; - kultit; - rituale aktive.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, fjalor, foto, video, historia, filozofia, sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, diskutime në dyshe, organizuesi grafik i analogjisë, rrjeti i diskutimit, debat dhe dialog.			
Organizimi i orës së mësimi			
Hapi I: lidhjen e temës me mësimet e mëparshme dhe diskutim i situatës së dhënë në libër. Në Shqipëri janë përhapur disa fe të reja, që nuk njiheshin më parë në realitetin shqiptar: Bahai, Dëshmitarët e Jehovait, etj. Shtrohen pyetjet: Ç’përfaqësojnë këto fe? Në cilat aspekte kryesore ndryshojnë ato nga fetë tradicionale në Shqipëri? Si ndikojnë besime të tilla në mendësitë dhe mënyrën e jetesës së të rinjve?			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimit, debat dhe dialog. Mësuesi/ja shpjegon konceptet e reja sektit dhe kultit. Nxënësit punojnë në dyshe me tekstin duke nxjerrë tiparet kryesore të secilës organizatë. Ata mund të përdorin mjetet e teknologjisë dhe internetin ose informacion shtesë në sociologjinë digjitale. Së bashku me mësuesen/in vendosin në organizuesin grafik përfundimet e punës së tyre:			
Hapi III: Përfundimi i të nxënësve: rrjeti i diskutimit, debat dhe dialog. Nxënësit reflektojnë rreth çështjeve të trajtuara, duke respektuar bindjet dhe opinionet e njëri-tjetrit.		Sekti organizatë fetare jozyrtare •nuk është e mirëintegruar në shoqëri; •anëtarët janë njerëz problematikë, me prirje kundërkulturore etj. •nuk janë tolerante ndaj besimeve të tjera; përgjithsisht nuk janë jetëgjata; •bazohen në rituale aktive dhe përvoja personale të udhëheqësve.	Kulti, lëvizje fetare •lindin nga përvoja të udhëheqësve që pretendojnë se sjellin diçka të re, si zbulesë personale; •mund të krijohen nga përhapja e besimeve fetare në shoqëri ku nuk njiheshin më parë.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësimi

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani ndonjë kult fetar që ju ka lënë përshtypje të veçantë, për të cilin jeni informuar nga programet televizive ose interneti.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
5.5-5.6 Tema mësimore: Fetë botërore.		Situata e të nxënësit: Fetë janë të shumëllojshme në përputhje me tiparet e kulturave ku janë krijuar. Disa nga fetë janë më të përhapura në shkallë botërore. Diskutime.	
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -përshkruan karakteristikat kryesore të krishterimit dhe të funksioneve të tij në shoqëritë perëndimore; -përshkruan veçoritë kryesore të islamizmit si fe që kultivon me përparësi frymën e paqëtimit; -analizojë ndikimet kryesore të judaizmit në shoqëri; -përshkruan karakteristikat kryesore të fesë hinduiste; -analizojë veçoritë e budizmit dhe predikimet e kësaj feje për jetën; -përshkruajë karakteristikat kryesore të konfucianizmit si fe etike; -vetëdijësohet për te respektuar këto fe dhe besimtarët e tyre.		Koncepte kyç: - krishterim; - islamizëm; - judaizëm; - Monoteizëm; - konvinent; - hinduizëm; - politeizëm; - metamorfozë; - budizëm; - bodhi; - konfucianizëm; - xhen.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	

interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.	Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.
--	---


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodat e përdorura: Harta e mendimit (cluster), grupi i ekspertëve, organizuesi grafik, rrjeti i diskutimit: pohim-mbështetje, debat dhe dialog.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: bën lidhjen e temës me njohuritë e nxënësve të marra në temat e mëparshme dhe nga burime të tjera informimi, si dhe diskutimi i situatave të dhëna në libër. Për të shmangur dukuritë paragjyquese, është e nevojshme që veçanërisht të rinjtë të kenë njohuri të mjaftueshme, së paku për fetë më të përhapura në botë, për funksionet e tyre të veçanta shoqërore dhe kulturore në shoqëritë përkatëse. Mësuesja/i drejton pyetje për besimet fetare që kanë më shumë pasues. Klasa ka qenë e organizuar një orë më parë në grupe ekspertësh, që do të mblidhnin materiale nga burime të ndryshme informacioni lidhur me llojet e feve, përhapjen në shkallë botërore dhe disa nga karakteristikat e tyre kryesore.

Hapi II: njohurive grupi i



Ndërtimi i të reja: ekspertëve,

organizuesi grafik.

Mësuesja/i përcakton kuptimin sociologjik të koncepteve kryesore të temave, si: fe monoteiste dhe tipet e feve të tilla në botë; fe politeiste dhe format e saj; ideja e metamorfozës dhe feja që e beson; koncepti i Nirvanës dhe feja që e praktikon e kështu me rradhë. Së bashku me nxënësit, vendos në tabelë fetë më të përhapura sot në botë:

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: rrjeti i diskutimit: pohim-mbështetje, debat dhe dialog.

Çështje për diskutim

-Shpjegoni sa dhe si i ndihmojnë njerëzit në nevojë besimtarët e feve të ndryshme që banojnë në qytetin ose në krahinën tuaj.

-Analizoni motivet kryesore që i nxisin disa nga bashkëmoshatarët tuaj të ndjekin rregullisht ose herë pas here rituale fetare të caktuara.

-Analizoni motivet kryesore që i nxisin shoqet, shokët ose të njohurit tuaj të përqafojnë një fe tjetër, të

ndryshme nga fetë tradicionale në vendin tonë.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësim dhe vlerësim i tjetrit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Përshkruani dallimet në mendësitë dhe modelet e sjelljes ndërmjet ndonjë të afërmi ose të njohuri tuaj, që i ushtron rregullisht praktikën fetare dhe ndonjë tjetri, që nuk i ushtron praktika të tilla.

6.7 Veprimtari

Tema: “Harmonia fetare në Shqipëri, vlerë historike dhe pasuri kombëtare”

“Të krishterë dhe myslimanë Zoti i gatoi në një baltë” – Çajupi

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës. Nxënësja/i në fund të orës së veprimtarisë:

- Analizon ndikimin e shumëllojshmërisë së besimeve fetare në Shqipëri në pasurimin e mozaikut nënkulturor të kulturës shqiptare;
- Konkretizon me shembuj nga historia që tregojnë harmoninë dhe mirëkuptimin ndërfetar të shqiptarëve;
- përshkruan veçoritë e shekullarizimit në shoqërinë shqiptare;
- analizon keqpërdorimet e fesë për qëllime të caktuara ekonomike, politike etj. dhe rrjedhojat e tyre problematike në shoqëri.

Lexim orientues

Shqiptarët janë një popull i vogël, i grupuar në pesë besime të ndryshme fetare zyrtare dhe në shumë kulte të tjera. Këto dallime fetare ndër shqiptarët nuk kanë provokuar konflikte, por kanë ndimuar për të fashitur dhe tejkaluar kontradikta të ndryshme, për të krijuar marrëdhënie harmonike ndërmjet tyre.

Kur flitet për harmoni ndërfetare të shqiptarëve nënkuptohet respekti i ndërsjellë për fetë e ndryshme të njëri-tjetrit, urimet e ndërsjella me raste festash fetare etj. Shumica e shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia fetare, në ditë të caktuara të vitit frekuentojnë edhe vende të shenjta të besimeve të tjera fetare. P.sh. kishën e Krishterë të Shën Ndout në Laç e vizitojnë masivisht, jo vetëm të krishterë, por edhe myslimanë. Ndërkohë, vendin e shenjtë Islamik të Sarisalltikut në malin e Krujës e vizitojnë, jo vetëm besimtarët myslimanë, por edhe ata të besimit të krishterë. Qëllimi i frekuentimit nga besimtarët të vendeve të tilla të shenjta është shëndeti, mbarësia në punë, në jetë etj. Po kështu, shumë shqiptarë të krishterë mbajnë emra myslimanë



dhe nuk është e rrallë që të gjesh emra myslimanë ndër shqiptarët e krishterë.

Çështje për diskutim:

- Ndryshimet fetare nuk sjellin dallime thelbësore tek njerëzit dhe nuk mund të jenë më të rëndësishme sesa vlerat që i bashkojnë ata.
- Njohja me besime fetare të tjera është mënyra më e mirë për të luftuar paragjykimet.
- Harmonia mes besimeve të ndryshme fetare brenda një shoqërie ndihmon në tejkalimin e problemeve të ndryshme brenda saj.

Çështje që mund të trajtohen në grupe: Përkatësia e ndryshme fetare nuk i ka penguar shqiptarët të jetojnë në harmoni dhe paqe me njëri-tjetrin. Bashkëjetesa mes feve të ndryshme në vendin tonë është një pasuri dhe krenari kombëtare, e trashëguar në shekuj, që shpesh është bërë shembull për popujt e tjerë.

Të ndarë në grupe nxënësit diskutojnë mes tyre:

- Tiparet e shtetit shekullarist, në të cilin feja dhe politika janë të ndara nga njëra-tjetra.
- Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në shekullarizimin e shoqërisë shqiptare gjatë periudhave të ndryshme historike.
- Fakte nga historia e Shqipërisë që lidhen me traditën e mirëkuptimit dhe harmonisë ndër fetare.
- Rreziku i përdorimit të besimit fetar me qëllime terrorizmi ndaj feve dhe kulturave të tjera.
- Shembuj të bashkëjetesës fetare të zonës nga vijnë nxënësit apo ku banojnë aktualisht.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
7.1 Tema mësimore: Zhvillimi i qyteteve paraindustriale.		Situata e të nxënësve: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën e dhënë në tekst. Industrializimi dhe zhvillimi i tregtisë ndihmojë në zhvillimin gradual të qendrave urbane.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: nxënës/ja-i: - shpjegon kuptimin sociologjik të urbanizimit; -përshkruan parakushtet e urbanizimit; -analizon tre revolucionet urbane; -përshkruan veçoritë kryesore urbanistike dhe shoqërore në qytetet paraindustriale.		Koncepte kyç: - urbanizim; - parakusht i urbanizimit; - revolucion i parë urban; - mënyrë urbane e jetesës.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Rrjeti i diskutimit, shënime të strukturuar në dyshe (analizë teksti), marrëdhëniet pyetje – përgjigje, reflekto dhe përgjigju.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: Kur filloi procesi i urbanizimit? Çfarë kuptojmë me zona urbane? Në studimet sociologjike urbanizimi përgjithësisht përcaktohet si rritje e përqendrimit të njerëzve në zona gjeografike të kufizuara, që quhen qytete. Në Europë urbanizimi filloi rreth 1800 vjet p.e.r. Qytetet e para para industriale u krijuan në fillim në Greqi Athina, Sparta etj, më pas Roma etj. Në Shqipëri Butrinti dhe Dyrrahi, që u themeluan në shekullin VII p.e.r.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja. Shënime të strukturuar në dyshe (analizë teksti), marrëdhëniet pyetje – përgjigje.

Nxënësit analizojnë tekstin në dyshe, për të kuptuar evolucionin urban dhe veçoritë e tij në Mesjetë. Ata shtrojnë pyetje dhe u përgjigjen njëri-tjetrit.

-Cili mendohet se është revolucioni i parë urban?

- Si ishin të ndërtuar qytetet mesjetare dhe sa % e popullsisë banonte atje?

-Cilat ishin disa nga qytetet kryesore mesjetare të kohës?

- Si realizohej veprimtaria ekonomik në qytetet mesjetare?

- Cilat degë të ekonomisë ishin më të zhvilluara?

-Pse themi se në këto qytetete kishte një hierarki shoqërore të ngurtësuar?

Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: reflekto dhe përgjigju.

✚ Si e përcakton sociologjia urbanizimin?

✚ Cilët janë faktorët kryesorë që përcaktuan revolucionin e parë urban?

✚ Ç'marrëdhënie kishte ndërmjet grupimeve të ndryshme shoqërore në qytetet e para?

✚ Cilat janë karakteristikat kryesore arkitektonike dhe shoqërore të qyteteve mesjetare?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani disa elemente të vjetra ose mesjetare të kulturës së qytetit, ku ju banoni ose të ndonjë qyteti më të afërt që ju njihni.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
7.2 Tema mësimore: Industrializimi dhe zhvillimi urban.		Situata e të nxënësve: Urbanizimi i mënyrës së jetesës dhe rritja e qyteteve filloi nën ndikimin e zhvillimit të industrisë.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon ndikimet e industrializimit në proceset urbanizuese; -përshkruan veçoritë ekonomike, arkitektonike dhe kulturore të qyteteve në periudhën e industrializimit; -analizojë veçoritë e urbanizimit në vendet e pazhvilluara të botës së tretë;		Koncepte kyç: - revolucion i dytë urban; - qytet i shoqërisë moderne; - metropol; - revolucion i tretë urban.	

-vetëdijësohet për përparësitë e jetesës në qytete dhe të angazhohet për t'i zhvilluar ato.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, fjalori, foto, video, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, lexim i orientuar, shënime të strukturuar, rrjeti i diskutimit, reflektio dhe përgjigju.	
Organizimi i orës së mësimi Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: Pse dhe si janë modeluar në këtë mënyrë hapësirat urbane? Cilët faktorë kanë qenë më ndikues në formimin e kësaj bote artificiale? Cilat janë shpjegimet sociologjike kryesore për zhvillimin e "botës" së qyteteve? Shumë të dhëna provojnë, se niveli i urbanizimit të mënyrës së jetesës filloi të rritej nën ndikimin e zhvillimit të industrisë. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: lexim i orientuar, shënime të strukturuar, rrjeti i diskutimit. Nxënësit, pasi analizojnë faktorët e shpejtimit të zhvillimit urban në tekst, zhvillojnë diskutime rreth pikave që iu kanë bërë më shumë përshtypje. Ata dallojnë se: - Në mesin e shekullit XVIII, përdorimi i energjisë së avullit dhe i pajisjeve teknike e teknologjike gjithnjë e më të përparura në industri, transport etj., sollën ndryshime rrënjësore në jetën e qyteteve, të cilat janë karakterizuar si revolucioni i dytë urban. - Pas Luftës së Dytë Botërore, popullsia urbane u rrit me ritme më të shpejta në vendet më pak të zhvilluara, që quhen të Botës së Tretë. Kjo rritje e vrullshme është cilësuar si revolucioni i tretë urban. - Metropol quhet një qytet shumë i madh, që shoqërisht dhe ekonomikisht mbizotëron një zonë urbane të gjerë. Hapi III: Përforsimi i të nxënësve: Reflekto dhe përgjigju: - Cilët faktorë ekonomikë, shoqërorë dhe teknologjikë përcaktuan revolucionin e dytë urban? - Si ndikoi zhvillimi i tregtisë dhe i industrisë në ndryshimin e mjediseve urbane kryesore? - Ç'është metropoli? - Cilat janë rrjedhojat kryesore ekonomike e shoqërore të revolucionit të tretë urban?	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësimi formues dhe i vazhdueshëm b- vlerësimi për tjetrin.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë shtëpie: Përshkruani ndonjë objekt (ndërtesë, rrugë etj.) me vlera të veçanta arkitektonike të qytetit ku banoni ose të një qyteti që ju njihni më mirë.	

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
7.3 Tema mësimore: Dukuri dhe prirje bashkëkohore të urbanizimit.		Situata e të nxënësve: Pas Luftës së Dytë Botërore rritja e popullsisë së qyteteve, veçanërisht në vendet më të industrializuara, është shoqëruar me dukuri e procese kontradiktore.	

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon dukuritë e proceset kryesore të zhvillimeve urbane pas Luftës së Dytë Botërore në vendet më të industrializuara; -përshkruan veçoritë kryesore të zhvillimeve urbane në Republikën e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore; -aftësohet për të analizuar veçoritë e zhvillimeve urbane në qytetin ose në rajonin ku banon; -vetëdijësohet dhe përfshihet në veprimtari të ndryshme që përmirësojnë jetën e banorëve të qytetit.	Koncepte kyç: - shpërqendrim urban; - megalopolis; - përtëritje urbane; - xhentrifikim; - eksurbanizim.
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, psikologjia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, reflektio dhe përgjigju. Organizimi i orës së mësimi Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: zhvillimi i vrullshëm urban ka theksuar jo vetëm përparësitë, por edhe kufizime shqetësuese të jetesës në qytetet e mëdha. Nxënësit shprehin opinionet e tyre. Mësuesja/i shpjegon se: Cilat janë këto dukuri e procese shqetësuese? Si i shpjegon sociologjia ato? Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup, praktikë e pavarur (lexim i orientuar i tekstit), rrjeti i diskutimit. Mësuesja/i përcakton konceptet e reja nga pikëpamja sociologjike, si: ▪ Shpërqendrimi urban – largimi i njerëzve nga qendrat e qyteteve drejt rrethina ose përtej tyre. Së bashku me nxënësit diskutohen problemet sociale, ekonomike, mjedisore etj, që kanë qendrat e mëdha urbane. ▪ Megalopolis. Sipas tij, megalopolis është një rajon urban mjaft i gjerë, që përmban një numër qytetesh dhe rrethinat e tyre që bashkohen. ▪ Përtëritja urbane – rigjallërimi i qendrave të qyteteve të mëdha si mjedise për zyra biznesi, për veprimtari kulturore, artistike etj. ▪ Xhentrifikimi - kthimi i anëtarëve të klasës së mesme ose të lartë në qendrat e rrënuara të qyteteve fqinje. ▪ Eksurbanizimi - banorë të pasur të periferive lëvizin drejt qendrës së qyteteve, të tjerë orientohen kah mjediset më fshatarake. Punë në grupe: Urbanizimi në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore (me ndihmën e tekstit dhe të mësueses/it). Grupi I: periudha e parë 1945-1967; Grupi II: periudha e dytë 1968-199; Grupi III: Nënperiudha e tretë (1991 deri në ditët tona). Hapi III: Përforcimi i të nxënës: Nxënësit prezantojnë punën në grupe, duke vlerësuar punën e njëri-tjetrit.	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipastemës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:	

- a- vlerësim formues
b- vlerësimi për tjetrin

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Analizoni veçoritë e urbanizimit të qytetit ku ju banoni ose të qytetit më të afërt përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
7.4 Tema mësimore: Interpretime sociologjike të jetës shoqërore në qytete.		Situata e të nxënët: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst dhe t’u përgjigjen pyetjeve: Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e mënyrës së jetesës në qytet? Si kanë ndikuar qytetet në zhvillimin e shoqërisë?	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> -analizon dallimet kryesore ndërmjet mënyrës urbane dhe mënyrës fshatare të jetesës; -përshkruan veçoritë e mënyrës urbane dhe fshatare të jetesës në shoqërinë shqiptare; -përfshihet në veprimtari të ndryshme që synojnë përmirësimin e elementeve të caktuara të mënyrës së jetesës në qytete dhe në fshatra.		Koncepte kyç: - mënyrë jetese urbane; - mënyrë jetese fshatare; - bashkësi; - shoqëri - shoqatë; - ekologji urbane.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, shënime të strukturuar, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, reflektimi dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimin			
Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutim i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: Si i shpjegon sociologjia bashkëkohore dukuritë sociale dhe problematikat e jetës në qytetet e mëdha? Nxënësit japin opinionet e tyre duke vlerësuar përparësitë e jetës në qytete krahasuar me mangësitë e saj. Ata drejtohen nga mësuesi/ja në leximin e tekstit për të shënuar pikat kryesore që lidhen me veçoritë e mënyrës urbane dhe fshatare të jetesës, duke i krahasuar ato me njëra-tjetrën.			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: harta e konceptit, rrjeti i diskutimit.			
Mësuesi/ja shpjegon konceptet e reja mësimore, si:			

Hapi III:
të nxënës:
reflekto dhe

- Si e Tënis
- Cili i Tënis për konceptin "shoqëri ose shoqatë"?
- Pse banorëve të qyteteve u kultivohen qëndrime të zbehta, sipas Zimelit?
- Cilat janë tri karakteristikat kryesore të jetës urbane, sipas sociologut Uirth?
- Pse banorët e qyteteve janë më tolerante se fshatarët në marrëdhëniet me njëri-tjetrin?
- Ç'është ekologjia urbane?

Urbanizimi:

- masa e madhe e popullsisë
- vendbanimi i dendur
- shumëllojshmëria shoqërore (Uirth)
- individualizmi dhe egoizmi
- tolerantë ndaj ndryshimeve shoqërore
- interesat vetjake në qendër të vëmendjes (Zimel)

Ekologjia urbane:

- Bashkëveprimi i mjedisit fizik dhe të jetës shoqërore në qytete:
- a- Modeli i zonave bashkëqendrore
- b- Modeli sektorial
- c- Modeli me shumë qendra

Përforcimi i
Diskutime,
përgjigju.
përcakton
konceptin
"bashkësi"?
është kuptimi

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm

b- vetëvlerësimi

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënës do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani veçoritë dhe vështirësitë kryesore të integritetit të banorëve të ardhur nga fshatrat në qytetin ku ju banoni ose në ndonjë qytet të krahinës tuaj.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
7.5-7.6 Tema mësimore: Veçori kryesore të punës në shoqëritë moderne.		Situata e të nxënës: Mësuesja/i fton nxënës të diskutojnë situatën hyrëse në tekst. Njohja e karakteristikave kryesore të punës i ndihmon ata të kuptojnë më shpejt e më mirë kërkesat e tregut të punës.	

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -përshkruan karakteristikat kryesore të punës në shoqëritë industriale të zhvilluara ose pasindustriale; -analizon përafrimet dhe dallimet kryesore të punës në shoqërinë shqiptare me ato të shoqërive perëndimore më të industrializuara; -parashikon ndryshimin e karakteristikave të punës në shoqërinë shqiptare.	Koncepte kyç: - puna fizike "jakëblu"; - punë "jakëbardhë"; - punë profesionale e kualifikuar; - vetëpunësim; - papunësi; - ekonomi e paligjshme; - teknologji informacioni.
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia digjitale, ekonomia etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, ekonomia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, rrjeti i diskutimit.	
Organizimi i orës së mësimi Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe diskutimi i situatës së dhënë në libër. Njohja e karakteristikave kryesore të punës i ndihmon nxënësit të përshtaten më mirë me kërkesat e tregut të sotëm të punës dhe me shoqërinë e vendit ku dëshirojnë të emigrojnë në të ardhmen. Nxënësit paraqesin mendimet e tyre, duke respektuar opinionet e njëri-tjetrit. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve. Mjaft sociologë mendojnë se, në ekonomitë industriale shumë të zhvilluara ose pasindustriale puna ka disa karakteristika kryesore. Nxënësit të ndarë në grupe orientohen të analizojnë nënçështjet e mëposhtme: Grupi I: Pakësimi i punës së gjallë të njerëzve në bujqësi. Grupi II: Rritja e peshës specifike të punëve "jakëbardhë". Grupi III: Shtimi i profesioneve dhe rritja e rëndësisë së tyre. Grupi IV: Pakësimi i peshës specifike të të vetëpunësuarve. Grupi V: Papunësia dhe ekonomia e paligjshme. Grupi VI: Rritja e shkallës së shumëllojshmërisë racor, etnik, gjinor etj. Grupi VII: Përdorimi i teknologjive të informacionit. Hapi III: Përforcimi i të nxënit: rrjeti i diskutimit (ora II). Nxënësit prezantojnë rezultatet e punës në grupe. Ata u përgjigjen pyetjeve të mësuesit/es ose shokëve/shoqeve të klasës, rreth: Cilët faktorë kryesorë përcaktojnë pakësimin e punës së gjallë bujqësore në vendet e zhvilluara industriale? ❖ Pse në Shqipëri pas vitit 1990 është rritur pesha specifike e njerëzve të punësuar në sektorin e bujqësisë? ❖ Pse rritet pesha specifike e punëve "jakëbardhë" në shoqëritë e zhvilluara industriale? ❖ Ç'është puna profesionale dhe cilat janë veçoritë kryesore të saj? ❖ Cilët faktorë kryesorë përcaktojnë pakësimin e peshës specifike të të vetëpunësuarve në ekonominë e zhvilluar industriale? ❖ Pse në Shqipëri pas vitit 1990 është rritur pesha specifike e të vetëpunësuarve? ❖ Cilat grupime të popullsisë "preken" më shumë nga papunësia? ❖ Çfarë ndryshimesh ka sjellë në punë përdorimi i teknologjive të informacionit?	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:	

- a- vlerësim formues
- b- vetëvlerësimi dhe vlerësim i tjetrit
- c- vlerësim me anë të portofolit

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Përshkruani pse do të parapëlqenit ose nuk do të parapëlqenit të punësoheshit në një punë ku punojnë njerëz me përkatësi të ndryshme racore, etnike etj.

Veprimtaria 7.7

Tema: Telepuna dhe ristrukturimi i marrëdhënieve shoqërore

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës. Nxënës/ja-i në fund të orës së veprimtarisë:

- Kupton më mirë ndryshimet që kanë pësuar shumica e proceseve të punës në sajë të përdorimit të programeve kompjuterike dhe mjeteve të komunikimit masiv;
- përshkruan rrjedhojat kryesore në rrafsh ndërkombëtar të telepunës, që u mundëson njerëzve të banojnë në një vend dhe të punojnë për llogari të ndërmarrjeve që funksionojnë shumë larg nga vendbanimi i tyre;
- analizon ndryshimet që sjell telepuna në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshorteve dhe ndërmjet prindërve e fëmijëve;
- shfrytëzon burime të ndryshme informacioni.



Lexim orientues

Veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore është rritur vrullshëm përdorimi i teknikave dhe teknologjive gjithnjë më të sofistikuar në shumicën e proceseve të punës. Nga mesi i viteve 1990 deri në ditët tona përdorimi masiv i mjeteve të komunikimit masiv, veçanërisht i programeve kompjuterike gjithnjë më të përparuara ka ndikuar në rishpërndarjen e vendeve të punës brenda çdo shteti dhe në shkallë botërore, në rritjen e largësisë ndërmjet punonjësve dhe produkteve të punës së tyre, në komunikimet jo të drejtpërdrejta ndërmjet punonjësve dhe klientëve etj. Për këtë analisti i shquar i zhvillimeve bashkëkohore, Edgar Morin, ka shkruar: “Telepuna, që përfshin delokalizimin dhe jashtësimin e shërbimeve të sipërmarrjeve të vendeve të industrializuara drejt vendeve në zhvillim, falë teknologjive të informacionit, krijon vende pune, nga njëra anë, në shërbimet “e folura” si qendra thirrjesh ose kontakti me klientelën dhe, nga ana tjetër, në shërbime administrative si financa, kontabiliteti, trajtimi dhe menaxhimi i të dhënave informatike, zhvillimi i burimeve njerëzore. Ky është një sektor në lulëzim të plotë. Telepuna është përherë e më fitimprurëse, sepse në të ka pakësim të shpenzimeve dhe përdoren teknologji përherë e më të sofistikuar dhe më pak të shtrenjta. Me ndonjë përjashtim të rrallë, grate përfaqësojnë shumicën më të madhe (60%) të punonjësve në thuajse të gjitha vendet që kanë një sektor të mirëfillt të telepunës. Në një kuadër kombëtar telepuna mundëson punën jashtë qytetit dhe mund të kontribuojë për ajrosjen urbane dhe rigjallërimin e fshatrave”.

Çështje për diskutim

- Analizoni parapëlqimet e të rejave dhe të rinjve për punë të ndryshme, të cilat kryhen me programe kompjuterike.
- Të rinjtë përballë dilemës: të punojnë me programe kompjuterike nga Shqipëria për vende më të industrializuara të Perëndimit apo të punësohen atje?
- Të rinjtë përballë dilemës: të jetojnë në mjedise më të shëndetshme në zonat rurale dhe të punojnë me programe kompjuterike, apo të banojnë dhe të jetojnë në mjedise më të ndotura të qyteteve?

Çështje që mund të trajtohen në grupe

Grupi I. Përparësitë dhe kufizimet e punësimit të një vajze të re me programe kompjuterike, duke qëndruar në mjediset e banesës së vet.

Grupi II. Përparësitë dhe kufizimet e punësimit me programe kompjuterike në mjediset e banesës së një nëne të re me fëmijë të vegjël.

Grupi III. Ristrukturimi i marrëdhënieve ndërmjet bashkëshorteve që punojnë me programe kompjuterike dhe në mjediset e banesës së përbashkët.

Grupi IV. Përfshirja e të rinjve shqiptare në punë me programe kompjuterike për vendet më të industrializuara dhe ndikimi i saj në kërkesat e të rinjve për të emigruar.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
8.1 Tema mësimore: Shtresimi i shoqërisë (Sistemi i kastave).		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë situatën në tekst dhe dallojnë kuptimin e shtresimit shoqëror si nënrenditje ose mbirenditje hierarkike e grupimeve të ndryshme të popullsisë brenda një shoqërie.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> -analizon dukurinë e shtresimit shoqëror; -përshkruan karakteristikat kryesore të shtresimit shoqëror; -analizon veçoritë e funksionimit të shoqërive me kasta; -vetëdijësohet se sistemi i kastave ka penguar përparimin e njerëzve, veçanërisht të të rinjve, në karrierën profesionale dhe shoqërore; -angazhohet për të kundërshtuar mendësi e pengesa të kësaj natyre.		Konceptet kyç: - shtresim shoqëror; - kastë; - sistem kastash; - lëvizshmëri shoqërore individuale.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia, ekonomia etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, ekonomia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, organizuesi grafik, diskutim, debat dhe dialog.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (brainstorming) dhe identifikimi i problemit.

Mësuesi/sja shpjegon konceptet kryesore të temës: shtresim shoqëror, kastë dhe sistem kastash si një tip shtresimi shoqëror në të cilin pozita shoqërore e çdo individi paracaktohet nga trashëgimia e prindërve. Ai është mjaft i mbyllur dhe lëvizshmëria e njerëzve në të është shumë e kufizuar. I përhapur më shumë në zonat fshatare të Indisë. Së bashku rendisin disa nga tiparet e këtij shtresimi shoqëror.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, organizuesi grafik.

Nxënësit orientohen drejt tekstit, për të mbajtur shënimet e strukturuar. Ata ndahen në grupe dhe secili analizon paragrafin përkatës që lidhet me një nga veçoritë e shtresimit shoqëror. Së bashku me mësuesen/in ndërtojnë hartën e konceptit:



Hapi III: Përforcimi i të nxënit: Rrjeti i diskutimit, debat dhe dialog.

Në studimet sociologjike, ndryshimi i pozitës shoqërore të individëve brenda një sistemi shtresimi shoqëror quhet lëvizshmëri shoqërore. Në Shqipëri pas vitit 1990 ka patur një lëvizshmëri të madhe nga klasa në klasë. Nxënësit diskutojnë shkaqet dhe rrjedhojat (pozitive dhe negative) e kësaj dukurie për vendin.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Analizoni sa dhe si i pengojnë paragjykimet banorët e ardhur nga fshatrat të integrohen në jetën e qyteteve shqiptare të ditëve tona.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
8.2 Tema mësimore: Shtresimi i shoqërisë (Sistemi i klasave).		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë paragrafin hyrës në tekst, lidhur me klasat dhe shtresat, si dhe ndarjen e hershme klasore të shoqërisë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të		Konceptet kyç:	

fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon sistemin e klasave dhe veçoritë e tij; -përshkruan përbërjen klasore të shoqërisë në ditët tona; -analizon veçoritë kryesore të përbërjes klasore të shoqërisë shqiptare të ditëve tona; - respekton tjetrin pavarësisht nga përkatësia klasore.	- klasë shoqërore; - lëvizshmëri shoqërore strukturore; - meritokraci; - klasë e lartë; - klasë e mesme; - klasë punëtore.
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia digjitale, interneti etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, ekonomia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, harta e mendimit (cluster), punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, reflektio dhe përgjigju. Klasa e lartë Klasa e mesme Klasa e varfër	

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe identifikimi i problemit: Pse ka qenë historikisht e vështirë të ngjiteshe nga një klasë në tjetrën? Mësuesja/i shpjegojnë konceptet kryesore si: klasë shoqërore dhe së bashku me nxënësit bën ndarjen e shoqërisë në klasa.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, rrjeti i diskutimit. Nxënësit të ndarë në grupe analizojnë tekstin në paragrafë të përcaktuar nga mësuesi/ja që lidhen me veçoritë e secilës klasë dhe shtresëzimin mes secilës prej tyre. Ata/ato analizojnë tiparet e secilës shtresë dhe mundësinë e ecjes përpara në bazë të meritokracisë, d.m.th. shpërblimit me të ardhura dhe prestigj përcaktohet nga meritat e gjithsecilit.

Nxënësit diskutojnë për *lëvizshmëri shoqërore strukturore*, si kalim nga fshatarësia tek klasa punëtore, duke marrë shembuj nga Shqipëria pas viteve '90.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: reflekto dhe përgjigju.

Në studimet sociologjike statusi i personit analizohet përgjithësisht me katër përmasa kryesore që janë: *pasuria, prestigji profesional, arsimimi dhe pushteti*. Vlerësoni raportin mes tyre në shoqërinë e sotme moderne.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vetëvlerësimi

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Analizoni veçoritë e marrëdhënieve ndërmjet shokëve ose shoqeve tuaja të shkollës me përkatësi klasore të ndryshme.

Dt. ____/____/____

Fusha: "Shoqëria dhe mjedisi"	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
8.3 Tema mësimore: Ndryshimet shoqërore.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë paragrafin hyrës në tekst, duke iu referuar ndryshimeve të shumta dhe të vrullshme në ditët e sotme në të gjitha fushat.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: -analizon kuptimin sociologjik për ndryshimin shoqëror; -përshkruan karakteristikat kryesore të ndryshimit shoqëror; -analizon rrjedhojat kryesore të ndryshimit shoqëror edhe në shoqërinë shqiptare. -vetëdijesohet për të qenë pjesëmarrës në ndryshimin shoqëror.		Koncepte kyç: - ndryshim shoqëror; - karakteristikë e ndryshimit shoqëror; - rrjedhojë kontradiktore e ndryshimit shoqëror.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e	

sociologjia digjitale etj.	nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, ekonomia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, reflekto dhe përgjigju.	
Organizimi i orës së mësimi Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe identifikimi i problemit përmes pyetjeve: - Ç’është ndryshimi shoqëror? - Cilat janë karakteristikat kryesore të tij? - Si realizohet ndryshimi shoqëror dhe cilat janë rrjedhojat kryesore të tij? Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, rrjeti i diskutimit. Mësuesi/ja shpjegon konceptin e ndryshimit shoqëror <i>si tërësi shndërrimesh në organizimin e shoqërisë, në modelet e të menduarit dhe të sjelljes së njerëzve në rrjedhën e kohës.</i> Procesi i ndryshimit shoqëror ka katër karakteristika kryesore: - është i përgjithshëm, por me veçori dalluese në çdo rast konkret; - është përgjithësisht i qëllimshëm, por i paplanifikuar në të gjitha rrjedhojat e tij; - shpesh ka rrjedhoja kontradiktore dhe është i diskutueshëm; - ka kohëzgjatje dhe rrjedhoja të ndryshme në shoqëri të ndryshme. Hapi III: Përforcimi i të nxënit: reflekto dhe përgjigju. Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit ndryshime të thella kanë ndodhur për shkak të përdorimit masiv prej shqiptarëve, veçanërisht prej të rinjve, të teknikave dhe programeve kompjuterike. Diskutoni për ndryshimet në mënyrën tuaj të komunikimit me shoqet dhe shokët e klasës, me miqtë dhe të afërmit në sajë të përdorimit të internetit.	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: - a- vlerësim formues - b- vetëvlerësimi	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë shtëpie: Përshkruani ndonjë ndryshim të rëndësishëm në jetën e banorëve të qytetit ose të krahinës ku ju banoni.	

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
8.4 Tema mësimore: Lëvizjet shoqërore.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë paragrafin hyrës në tekst, për një kuptim të drejtë të natyrës së lëvizjeve shoqërore dhe trajtimin e këtij koncepti nga këndvështrimi sociologjik.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: - shpjegon natyrën e lëvizjeve shoqërore dhe tipat e tyre; - përshkruan veçoritë e zhvillimit të lëvizjeve shoqërore në fazat kryesore të realizimit; - vetëdijësohet për të qenë veprimtar në lëvizjet shoqërore përparimtare.		Koncepte kyç: - lëvizje shoqërore; - lëvizje shoqërore alternative; - lëvizje shoqërore realizuese; - lëvizje shoqërore reformuese; - lëvizje shoqërore revolucionare.	

Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, ekonomia, interneti etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, rrjeti i diskutimit, harta e konceptit, reflekto dhe përgjigju.	
Lëvizjet shoqërore 1. shfaqja e lëvizjes shoqërore 2. masivizimi dhe organizimi 3. burokratizimi 4. rënia lëvizjeve shoqërore. Klasa ndahet në grupe dhe trajton secili një nga tipet e lëvizjes shoqërore. Mund të shfrytëzojnë përveç tekstit edhe burime të tjera si interneti etj. Grupi I: Lëvizjet shoqërore alternative Grupi II: Lëvizjet shoqërore realizuese Grupi III: Lëvizjet shoqërore reformuese Grupi IV: Lëvizjet shoqërore revolucionare Pas prezantimit të punës në grup, mësuesi/ja trajton fazat e lëvizjes shoqërore, të cilat i vendos në hartën e konceptit: Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: reflekto dhe përgjigju. ❖ Ç'është lëvizja shoqërore? ❖ Ç'është lëvizja shoqërore alternative? ❖ Cilat janë veçoritë kryesore të lëvizjes shoqërore realizuese? ❖ Ç'është lëvizja shoqërore reformuese përparimtare? ❖ Cilat janë karakteristikat kryesore të lëvizjes shoqërore revolucionare? ❖ Cilat janë arsyet kryesore të rënies së lëvizjes shoqërore?	Organizimi i orës së mësimi Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe identifikimi i problemit: ku ndryshojnë lëvizjet shoqërore nga veprimet spontane të turmave: a) kanë shkallë të lartë organizimi të brendshëm; b) zhvillohen për një kohë më të gjatë që përfshin disa vite. c) përgjithësisht i kanë të përcaktuara qartë pikësynimet për të ndryshuar dhe riformuar anë të ndryshme të shoqërisë. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, rrjeti i diskutimit. Mësuesi/ja shpjegon se sipas sociologëve ka katër tipa kryesorë të
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: - a- vlerësim formues - b- vetëvlerësimi	
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë shtëpie: Përshkruani motivet kryesore që mund t'iu nxisin të merrni pjesë në ndonjë lëvizje shoqërore.	

8.5 Veprimtari

Tema: Lëvizja studentore e dhjetorit 1990, lëvizje historike drejt demokracisë

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave. Nxënësja/i në fund të orës së veprimtarisë:

- Përshkruan veçoritë e lëvizjes së studentëve të vitit 1990 në Shqipëri;
- dallon sfidat e Shqipërisë gjatë tranzicionit të saj drejt demokracisë së vërtetë;
- orientohet për të qenë sa më i vlefshëm në lëvizjet shoqërore për përparim dhe progres;
- shfrytëzon burime të ndryshme dhe përdor teknologjinë e informacionit për përgatitjen e paraqitjeve grafike.

Lexim orientues

Lëvizjet revolucionare janë lëvizje masive, të dhunshme ose paqësore, të cilat synojnë shndërrimin e shoqërisë në të gjitha fushat e saj. Në kohët moderne, veçanërisht gjatë shekullit XX, janë kryer një varg revolucionesh të dhunshme që sollën në pushtet rregjime diktatoriale, si për shembull në Rusi (ish Bashkimin Sovjetik), në vendet e Lindjes si Poloni, Rumani, Hungari, Bullgari etj.

Më pas, kalimi nga shtete totalitare në shoqëri demokratike, gjatë viteve '80 dhe '90 të shekullit XX, u realizua nëpërmjet revolucioneve paqësore.



Në Shqipëri, ky shndërrim filloi me lëvizjen studentore të 8 dhjetorit, në Tiranë.

Studentët u hodhën në demonstratë kundër rregjimit të egër të diktaturës, varfërisë dhe shkeljes së të drejtave.

Lëvizjes së studentëve iu bashkuan pedagogët, intelektualët dhe qindra e mijra qytetarë. Thirrjet e tyre "Liri-Demokraci", "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" kërkonin hapur pluralizmin politik, të drejtat themelore dhe shtetin ligjor në mbrojtje të tyre.

Çështje që mund të trajtohen në grupe:

Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë rreth tematikave të mëposhtme:

Grupi I: Transformimi politik dhe vendosja e demokracisë në Shqipëri.

Grupi II: Demokracia në Shqipëri dhe sfidat e periudhës postkomuniste.

Grupi III: Aspirata e shqiptarëve dhe vështirësitë e rrugës drejt Bashkimit Europian.

Çështje për diskutim:

- Analizoni disa nga funksionet e lëvizjes revolucionare, paqësore ose të dhunshme, duke konkretizuar me shembuj nga historia.
- Krahasoni dy sistemet politike: totalitar dhe demokratik. Konkretizoni me shembuj nga Shqipëria gjatë viteve të diktaturës dhe pas vendosjes së demokracisë.
- Tregoni disa veçori të lëvizjes studentore të vitit 1990 në Shqipëri dhe efektet e saj për të ardhmen e Shqipërisë.
- Analizoni pasojat e tranzicionit të gjatë të Shqipërisë drejt demokracisë së vërtetë për pranimin e saj në Bashkimin Europian.



Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
9.1- 9.2 Tema mësimore: Shoqëria tradicionale dhe moderne.		Situata e të nxënit: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë paragrafin hyrës të temës në tekst mbi konceptet “shoqëri tradicionale” dhe “shoqëri moderne” dhe trajtimin e saktë që iu bëjnë atyre studimet sociologjike.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> - përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërisë tradicionale; - analizon karakteristikat kryesore të shoqërisë moderne; - përshkruan veçoritë kryesore të shoqërisë shqiptare, tradicionale dhe të ditëve tona; - vetëdijësohet dhe përfshihet në veprimtari të ndryshme për modernizimin e shoqërisë shqiptare sipas standardeve europiane.		Koncepte kyç: - shoqëri moderne; - shoqëri tradicionale; - bashkësi e vogël tradicionale; - shumëllojshmëri shoqërore; - orientim nga e ardhmja.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, ekonomia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, harta e konceptit, diskutime, reflekto dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimin Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe identifikimi i problemit lidhur me kuptimin jo të saktë që i bëhet shpesh konceptit shoqëri moderne. Mësuesi/ja jep përcaktimin sociologjik si shoqëri e përfutur prej ndryshimeve rrënjësore e të shumanshme, të shkaktuara nga revolucioni industrial që filloi në Europën Perëndimore në mesin e shekullit XVIII dhe që ndryshoi rrënjësisht, jo vetëm marrëdhëniet e shoqërisë me natyrën, por edhe sistemin e marrëdhënieve të shumëllojshme ndërmjet anëtarëve të shoqërisë, mënyrat e sjelljes dhe të menduarit të tyre. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, harta e konceptit. Mësuesja/i ndan klasën në grupe për të punuar me tekstin dhe për të bërë dallimet ndërmjet shoqërisë moderne dhe tradicionale. Pasi bëjnë prezantimin e punës, së bashku ndërtojnë hartën e konceptit:			

Dallimet ndërmjet shoqërisë moderne dhe tradicionale:

- *Venitja e bashkësive të vogla tradicionale.*
- *Zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake.*
- *Pasurim i spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore.*
- *Orientimi nga e ardhmja dhe rritja e vetëdijes për vlerën e kohës.*

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: refleкто dhe përgjigju.

- Ç'është shoqëria moderne?
- Në shoqërinë tradicionale apo në atë moderne thashethemet ndikojnë më shumë në modelet e sjelljes dhe të të menduarit të njerëzve?
- Pse në shoqërinë shqiptare janë ruajtur më vonë bashkësitë e vogla të fshatarëve?
- Ç'është procesi i individualizimit, sipas Peter Berger-it?
- Në shoqërinë tradicionale apo në atë moderne njerëzit kanë më shumë mundësi për zgjedhje?
- Pse në shoqërinë shqiptare edhe në vitet 1945-1990 mundësitë për zgjedhje ishin mjaft të kufizuara?
- Pse në shoqërinë shqiptare spektri i shumëllojshmërisë shoqërore është zgjeruar pas vitit 1991?
- Në shoqërinë tradicionale apo në atë moderne njerëzit e fokusojnë më shumë vështrimin tek e kaluara?
- Pse njerëzit e shoqërisë moderne janë më optimistë për të ardhmen?
- Pse njerëzit e shoqërisë moderne e çmojnë më shumë vlerën e kohës?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vlerësimi për tjetrin

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Tregoni rreth mundësive për zgjedhje vetjake që kanë shokët ose shoqet tuaja të klasës për të vendosur se ku do të jetojnë në të ardhmen.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
9.3 Tema mësimore: Shoqëria pasmoderne.		Situata e të nxënësve: Mësuesja/i fton nxënësit të diskutojnë paragrafin hyrës të temës në tekst mbi konceptin “shoqëri pasmoderne” dhe trajtimin e saktë që bëjnë studimet sociologjike.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: - analizon karakteristikat kryesore të shoqërisë pasmoderne; - përshkruan përafrimet dhe dallimet kryesore të shoqërisë shqiptare të ditëve tona me shoqëritë pasmoderne; - vetëdijësohet e të përgatitet për të përballuar vështirësitë e sfidat e zhvillimeve pasmoderne në shoqëri.		Koncepte kyç: - Shoqëri pasmoderne; - diskutim i rolit të shkencës; - debate kulturore; - ribërje e institucioneve.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimin bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia, interneti etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Brainstorming, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, harta e konceptit, diskutime, reflekto dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimin Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe identifikimi i problemit lidhur me kuptimin jo të saktë që i bëhet shpesh konceptit shoqëri pasmoderne. Mësuesi/ja jep përcaktimin sociologjik si rimodelim i shoqërisë moderne nën ndikimet e shumanshme të revolucionit të informacionit. Shumica e sociologëve mendojnë se kjo shoqëri ka pesë profile kryesore. Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, harta e konceptit. Mësuesja/i ndan klasën në grupe për të punuar me tekstin dhe për të trajtuar secilën nga pesë çështjet. Pasi bëjnë prezantimin e punës, së bashku ndërtojnë hartën e konceptit: Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: reflekto dhe përgjigju. ➤ Ç’është shoqëria pasmoderne? ➤ Shoqëria moderne ka dështuar pjesërisht apo tërësisht në realizimin e pikësnyimeve të saj? ➤ Në shoqërinë moderne apo në atë pasmoderne shkalla e optimizmit e shumicës së njerëzve është më e lartë? ➤ Pse në shoqërinë pasmoderne vlerësohen më shumë idetë?			
Profilat kryesore të shoqërisë pasmoderne: • Dështimi i modernitetit. • Zbehja e dritës së përparimit. • Roli i shkencës më i diskutueshëm. • Dendësimi i debateve kulturore. • Ndryshimi i pandërprerë i institucioneve.			
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.			

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues

b- vlerësimi për tjetrin

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë shtëpie: Diskutoni rreth çështjes: “Ne, adoleshentët e ditëve tona, jemi më pak apo më shumë optimistë se prindërit tanë në moshën e adoleshencës?”

Dt. ___/___/___

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
10.1 Tema mësimore: Tipare të metodave të kërimit sociologjik. Eksperimenti.	Situata e të nxënit: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë paragrafin në hyrje të mësimit. Së bashku diskutojnë rreth metodave të studimit të sjelljes njerëzore.		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: - përshkruan karakteristikat kryesore të metodave të kërimit sociologjik; - analizon “mekanizmin” e realizimit të eksperimentit sociologjik; - analizon përparësitë dhe kufizimet kryesore të eksperimentit sociologjik; - vetëdijësohet për natyrën e vështirësive të studimeve sociologjike.	Koncepte kyç: - metodë e kërimit sociologjik; - eksperiment sociologjik; - ndryshore e pavarur; - ndryshore e varur; - efekt hauthorne.		
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia etj.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Brainstorming, diagrama e Venit, punë në grupe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, rrjeti i diskutimit, reflektio dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimi i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: A mund të kryhen eksperimente me njerëz sikurse me kavie laborator apo në natyrë me fenomene të ndryshme? Nxënësit shprehin opinionet e tyre të cilat mund t’i mbledhin në formën e një Diagrame Veni, ku vendosin dallimet dhe të përbashkëtat mes metodave të studimit në shkencat sociale dhe ato ekzakte.			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, shënime të strukturuar, organizuesi grafik, diskutim. Mësuesi/ja shpjegon konceptin kryesor eksperimentin sociologjik si një nga metodat shkencore më të rëndësishme, që synon të zbulojë marrëdhënie të caktuara shkak–pasojë ndërmjet faktorëve të caktuar shoqëror të konceptuar si ndryshore. Çdo eksperiment udhëhiqet nga një hipotezë kryesore, e cila është parashikim i bashkëveprimeve të mundshme ndërmjet ndryshoreve të pavarura dhe të varura. Eksperimenti synon të zbulojë, nëse hipoteza vërtetohet, ndryshohet ose kundërshtohet nga provat empirike. Ai kalon tri faza kryesore:			
1- maten treguesit e matshëm të ndryshores së varur;			
2- ndryshorja e varur vihet nën ndikimin e ndryshores së pavarur;			
3- maten përsëri treguesit e matshëm të ndryshores së varur, për të parë nëse ata kanë ndryshuar dhe si kanë ndryshuar.			

Nxënësit orientohen drejt shënimeve të strukturuar nga teksti për të analizuar veçoritë e ekperimentit, përparësitë, kufizimet dhe pasojat e tij. Ata shpjegojnë efektin hauthorne, i cili shpreh ndikimin e studiuesve në ndryshimin e modeleve të sjelljes së njerëzve që studiohen.

Hapi III: Përforcimi i të nxënit: reflekto dhe përgjigju.

- Cilat janë karakteristikat kryesore të metodave të kërkimit sociologjik?
- Ç'është eksperimenti sociologjik?
- Cilat janë fazat kryesore të një eksperimenti sociologjik?
- Ç'është efekti hauthorne?
- Pse eksperimenti sociologjik ka fushë përdorimi të kufizuar?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:
a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani nëse do të dëshironit apo jo, që në rolin e sociologut të merrnit pjesë në një eksperiment, në të cilin arrestohen njerëz të pafajshëm.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
10.2 Tema mësimore: Vëzhgimi sociologjik.		Situata e të nxënit: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë paragrafin në hyrje të mësimi. Së bashku diskutojnë rreth metodave të studimit të sjelljes njerëzore, një prej tyre edhe vëzhgimi sociologjik.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> <i>- përshkruan veçoritë kryesore të vështirimeve sociologjike;</i> <i>- analizon veçoritë e realizimit të vëzhgimit sociologjik në shoqërinë shqiptare;</i> <i>- vetëdijësohet për rolin e veçantë të vëzhgimit në studimeve sociologjike;</i> <i>- aftësohet për të realizuar vëzhgime sociologjike të thjeshta.</i>		Koncepte kyç: - vëzhgim sociologjik; - vëzhgim i pjesshëm dhe i përgjithshëm; - vëzhgim sistematik dhe josistematik; - vëzhgim i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë; - vëzhgim pjesëmarrës dhe jopjesëmarrës.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimi bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodat e përdorura: Pyetje-përgjigje, rrjeti i diskutimit: pohim/mbështetje, harta e konceptit, reflekto dhe përgjigju.			

Organizimi i orës së mësimit


Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimi i situatës së dhënë në libër dhe identifikimi i problemit: A mund të quhen vëzhgimet tona në jetën e përditshme sociologjike? Çfarë është vëzhgimi sociologjik? Nxënësit shprehin opinionet e tyre, ndërsa mësuesi/ja jep përcaktimin e kësaj metode si *vështrim i drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me pikësynime të caktuara dhe në mënyrë të organizuar nga studiuesi të dukurive ose fakteve, të proceseve ose ngjarjeve shoqërore.*

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimit: pohim/mbështetje, harta e konceptit.

Mësuesi/ja shpjegon llojet e vëzhgimit sociologjik, duke i renditur në tabelë në formën e hartës së konceptit. Nxënësit diskutojnë për veçoritë e secilit lloj vëzhgimi, përparësitë dhe të metat e tyre.

Më pas, mësuesja/i shpjegon fazat e realizimit të vëzhgimit sociologjik:

- I. përcaktohen qartë qëllimi dhe hipoteza kryesore e vëzhgimit;
- II. "saktësohet" objekti i vëzhgimit;
- III. përcaktohet njësia e vëzhgimit;
- IV. hartohet programi i vëzhgimit;
- V. analizohen faktet dhe përgjithësohen përfundimet (të cilat miratojnë, ndryshojnë pjesërisht ose hedhin poshtë hipotezën fillestare).

**Hapi III: Përforcimi i të nxënës:**

reflekto dhe përgjigju.

- Ç'është vëzhgimi sociologjik?
- Sa lloje kryesore vëzhgimi përdoren në studimet sociologjike?
- Cilat janë veçoritë kryesore të vëzhgimit të drejtpërdrejtë jopjesëmarrës?
- Cilat janë përparësitë dhe kufizimet kryesore të vëzhgimit të drejtpërdrejtë pjesëmarrës?
- Cilat janë veçoritë kryesore të vëzhgimit sociologjik në shoqërinë shqiptare?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Përshkruani se, çfarë do të ndjenit nëse do të kuptonit më pas, që disa sjellje dhe veprime tuaja në mjedise publike janë filmuar nga një kamer e fshehtë.

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
10.3 Tema mësimore: Intervista sociologjike dhe studimi i dokumenteve.	Situata e të nxënësve: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë paragrafin në hyrje të mësimit. Së bashku diskutojnë rreth metodave të studimit të sjelljes njerëzore, një prej tyre edhe intervista.		
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënës/ja-i: - njeh intervistën sociologjike, përparësitë dhe kufizimet kryesore të saj; - përvetëson rregullat kryesore të intervistimit; - aftësohet praktikisht për të realizuar një intervistë të thjeshtë sociologjike; - vetëdijësohet për rëndësinë e dokumenteve zyrtare dhe vetjake në realizimin e studimeve sociologjike dhe pasuron fondet e dokumenteve vetjake.	Koncepte kyç: - anketa sociologjike; - pyetje e hapur ose e pastrukturuar; - pyetje e mbyllur ose e strukturuar; - kampionim; - përzgjedhje rastësore; - përzgjedhje me kuota.		
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia etj.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Pyetje-përgjigje, rrjeti i diskutimit: pohim/mbështetje, harta e konceptit, reflekto dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimi i paragrafit hyrës në tekst dhe identifikimi i problemit: Çfarë është intervista sociologjike? Nxënësit shprehin opinionet e tyre, ndërsa mësuesi/ja jep përcaktimin e kësaj metode si një komunikim i drejtpërdrejtë me përgjigjedhësit, që i jep mundësi sociologut, jo vetëm të mbledhë të dhëna e mendime për probleme të ndryshme të realitetit shoqëror, por edhe të nxitë shtjellimin e mendimeve origjinale të bashkëbiseduesve gjatë procesit të intervistimit. Së bashku, përcaktojnë përparësitë dhe të metat e intervistës mes metodave të tjera.			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimit: pohim/mbështetje, harta e konceptit.			
Mësuesi/ja shpjegon llojet e intervistave sociologjike:			
1- Intervista e lirë, karakterizohet nga një shkallë e gjerë lirshmërie në komunikimin ndërmjet intervistuesit dhe përgjigjedhësit.			
2- Intervista e strukturuar, ku sociologu u drejton përgjigjedhësve të njëjtat pyetje të formuluar dhe të renditura njësoj për të gjithë.			
3- Intervistat e gjysmëstrukturuara, që kanë të gërshetuara cikle pyetjesh të njëjta për të gjithë të intervistuarit me pyetje të lira.			
Intervista sociologjike kalon nëpër tri faza kryesore:			
a- faza hyrëse, ku sociologu synon t'i shpjegojë personit që do të intervistohet, natyrën e studimit dhe rëndësinë e tij;			
b- faza e dytë, gjatë së cilës trajtohen pyetjet, që kanë të bëjnë me thelbin e çështjes;			
c- faza e fundit, ku bëhen pyetje për karakteristikat vetjake të përgjigjedhësve, që kanë të bëjnë me gjendjen shoqërore, moshën, përbërjen familjare, formimin arsimor, profesional etj.			

Hapi III: Përforcimi i të nxënësve: reflekto dhe përgjigju. ➤ Cilat janë disa nga kufizimet kryesore të intervistës sociologjike në shoqërinë shqiptare? A pranojnë ata të jenë objekt i kamerës dhe të shprehin lirisht mendimin e tyre?
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështet në rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm b- vlerësim i tjetrit
Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësve do të punojnë ushtrimet në libër. Detyrë me shkrim: Hartoni me shkrim një model interviste të lirë me një personazh të njohur dhe të dashur për ju.

Dt. ____/____/____

Fusha: “Shoqëria dhe mjedisi”	Lënda: Sociologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
10.4 Tema mësimore: Anketa sociologjike dhe kampionimi.		Situata e të nxënësve: Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë paragrafin në hyrje të mësimit. Së bashku diskutojnë rreth metodave të studimit të sjelljes njerëzore, një prej tyre edhe anketimi.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <i>Nxënës/ja-i:</i> - analizon përparësitë dhe kufizimet kryesore të metodës së anketimit; - përvetëson rregullat kryesore të hartimit e të plotësimit të anketës; - përshkruan veçoritë e anketimit në shoqërinë shqiptare; - harton dhe realizon modele ankete sociologjike për ndonjë problem shqetësues të rinisë; - respekton etikën e plotësimit dhe të trajtimit të anketave; - përshkruan kampionimin sociologjik dhe kriteret e realizimit të tij.		Koncepte kyç: - anketa sociologjike; - pyetje e hapur ose e pastrukturuar; - pyetje e mbyllur ose e strukturuar; - kampionim; - përzgjedhje rastësore; - përzgjedhje me kuota.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia digjitale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjatë orës së mësimit bëhet lidhja e temës me njohuritë e nxënësve dhe me disiplina të tjera, si historia, filozofia etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodat e përdorura: Pyetje-përgjigje, rrjeti i diskutimit: pohim/mbështetje, harta e konceptit, reflekto dhe përgjigju.			
Organizimi i orës së mësimit			
Hapi I: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, diskutimi i paragrafit hyrës në tekst dhe identifikimi i problemit: A mund të quhen anketat thjesht një listë pyetjesh që kërkojnë përgjigje po ose jo? Çfarë është anketa sociologjike? Nxënësit shprehin opinionet e tyre, ndërsa mësuesi/ja jep përcaktimin e kësaj metode si është një sistem pyetjesh, të lidhura logjikisht rreth një problematike të caktuar. Së bashku			

përcaktojnë përparësitë e anketës mes metodave

Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: rrjeti i diskutimit: pohim/mbështetje, harta e konceptit.

Mësuesi/ja shpjegon llojet e pyetjeve që përdoren në anketa:

- 1- pyetjet e hapura që i lejojnë përgjigjedhënësit të shprehë lirshëm mendimet e veta.
- 2- pyetjet e mbyllura që i sugjerojnë përgjigjedhënësit disa alternativa përgjigjesh mes të cilave duhet të zgjedhë.

Studimet sociologjike nuk mund të realizohen për mijra ose miliona njerëz, por përgjithësohen duke studiuar vetëm “segmente” të veçanta të tij d.m.th. kampione që përzgjidhen sipas kriterëve shkencorë:

- 1- homogjeniteti relativ të grupit të njerëzve;
- 2- niveli i ndërlimit të problemit që studiohet.

Përzgjedhja mund të jetë:

- a- rastësore
- b- me kuota

Hapi III: Përforcimi i të nxënës: reflekto dhe përgjigju.

- Cilat janë veçoritë kryesore të anketës sociologjike në shoqërinë shqiptare?

Nxënësit reflektojnë mbi çështjen se përgjithësisht shqiptarët ndjehen disi të druajtur e herë–herë të frikësuar para fletëve të anketës. Pse ndodh kështu?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

- c- vlerësim formues dhe i vazhdueshëm
- d- vlerësim i tjetrit

Detyrat dhe puna e pavarur: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Detyrë me shkrim: Hartoni me shkrim një model pyetësori rreth një problematike të caktuar.

4.2; 4.3 Tema: Metoda dhe strategji të mësimdhënies për orët 90’

Përdorimi i metodave specifike dhe startegjive efektive gjatë orëve dyshe, bazuar në hapa dhe të pasqyruara në plan-ditar, do t’iu mundësojë mësuesve të arrijnë rezultatet e dëshiruara me nxënësit. Kjo për disa arsye:

- 1- Këto metoda do të ndihmojnë nxënësit të mendojnë dhe më pas të veprojnë;
- 2- Nxënësit do të zhvillojnë kreativitetin, që metodat e mëparshme dhe orari i kufizuar 45’, nuk ua stimulonte;
- 3- Këto metoda nxisin diskutimet dhe debatin, duke i angazhuar edhe nxënësit e vështirë;
- 4- Përdorimi i strategjive të caktuara, gjatë fazave të ndryshme të orëve dyshe, rrit interesin dhe vëmendjen e nxënësve në lexim, në punë në bashkëpunim apo në kryerjen e ushtrimeve dhe punëve të pavarura;
- 5- Metodatat e efektshme i pajisin nxënësit me aftësi të një niveli të lartë të menduarit dhe zbatimi të dijes së marrë.

Në cdo orë, mësuesit duhet t’i japë përgjigje tre pyetjeve:

- Cfarë nxënësit kanë nevojë të mësojnë apo të kuptojnë gjatë kësaj ore mësimore?
- Cfarë nxënësit do të jenë të aftë të bëjnë pas kësaj ore mësimore?

- Si do të vlerësohen nxënësit për atë që mësuan apo u aftësuan të kryejnë?

Mësuesit janë të ndërgjegjshëm se, vëmendja e nxënësve nuk mund të fokusohet intesivisht për një kohë të gjatë, prandaj e bën më efektiv të nxënët ndarja e mësimit në disa pjesë 10 apo 20 min.

Hapi I: Tërheqja e vëmendjes së nxënësve apo nxitja e kureshtjes – (Enticement)

Kjo fazë varion nga **10-15'**. Bazohet në atë çfarë nxënësit dinë rreth temës së re, për t'i nxitur ata drejt njohurive të reja. Kjo fazë vlen për t'i njohur nxënësit me qëllimin e orës mësimore, fjalorin dhe konceptet e reja, kërkesat e përmbajtjes, pra i përgatit ata për të nxënë. Kjo do të arrihet, në rradhë të parë, duke tërhequr vëmendjen e nxënësve dhe duke ngritur pyetje. Teknika që mund të përdoret është Brainstorming, i organizuar në forma të ndryshme; e vërtetë apo e gabuar (në formën e pohimeve të shkruara në fletë, në të cilën nxënësit punojnë në grupe, duke përdorur edhe burime të tjera, si: Interneti, teksti, etj.), me qëllim përfshirjen e tyre në temën e re, që do të shpjegohet), etj.

Hapi II: Shpjegim i koncepteve-kyc, informacioni i ri – (Enlightenment)

Kjo fazë mund të zgjasë nga **15-20'** dhe ka si qëllim të fokusojë nxënësit në çështjet që mësuesi ka caktuar t'u shpjegojë, si informacion apo koncepte të reja. Metodat mund të jenë organizues grafik të ndryshëm, si: harta e konceptit, klaster, diagram e Venit, diagrama piramidale, etj. Në këtë fazë, nxënësit shpesh humbasin vëmendjen, vecanërisht nëse mësuesit flasin gjatë dhe në formën e një leksioni. Sipas studimeve, vëmendja e përqendruar tek adoleshentët më të rinj shkon nga 5-10', ndërsa ata më të rritur e kanë 10-20'. Të tjera studime vërtetojnë se nxënësit mbajnë mend më mirë atë që thuhet 5' e para të shpjegimit apo prezantimit, më pas efikasiteti vjen duke rënë derisa ulet fare në minutën e 18-20.

Hapi III: Të angazhosh, të përfshish nxënësit (engagement)

Kjo fazë paraprihet nga dy të parat, qëllimi i të cilave është përgatitja graduale e nxënësve për përfshirjen aktive dhe angazhimin e tyre në procesin e nxënies. Interesi i tyre zgjohet kur ata do kërkojnë të vlerësojnë parashikimet që kanë dhënë mëparë (faza e parë), të provojnë të mbajturit mend të koncepteve dhe informacionit të ri gjatë fazës së dytë, si dhe të monitorojnë veten sa e kanë kuptuar mësimin përmes aktiviteteve në grup dhe ndërveprimet të tyre me tekstin (2 fazat e para). Kjo fazë mund të zgjasë **20-30'**.

Disa nga metodat që mund të përdoren janë: lexim i drejtuar (përmes udhëzimeve të mësuesit) i një paragrafi në tekst, një video, etj., të cilat përmbajnë koncepte apo fakte të rëndësishme për t'u mësuar; marrja e shënimeve, nënvizime të pikave më kyce të mësimit në tekst, etj. Një metodë tjetër është pyetja e lexuesit, që përmban pesë E: Ëho? Ëhen? Ëhere? Ëhat? Ëhy?; diagrama piramidale, ku vendosen të gjitha pyetjet e mësipërme dhe përgjigjet e tyre, etj.

Hapi IV: Përforcimi i njohurive (extension)

Kjo fazë zgjat **20-25'**. Gjatë kësaj etape, nxënësit kanë nevojë të qartësojnë dhe përforcojnë dijet e marra gjatë fazave të mëparshme, përmes analizës, sintezës dhe vlerësimit të asaj çfarë lexuan dhe mësuan. Në këtë mënyrë ata kuptojnë dhe korrigjojnë informacionet e marra, si dhe reflektojnë duke i zbatuar ato brenda kësaj faze apo më pas.

Reflektimi mbi atë çfarë nxënësit kanë mësuar, është për shumicën e studiuesve, metoda më e mirë për të qartësuar idetë, për të mbajtur mend më gjatë informacionin e marrë dhe për ta vënë në zbatim ose përdorur më mirë këtë dije në praktikë. Produkti i këtij reflektimi i ndihmon ata të bëhen nxënës kritik

dhe të pavarur. Gjatë kësaj faze mund të përdoren shënimet e marra nga nxënësit, duke i sqaruar dhe përforcuar idetë.

Metoda që mund të përdoret është bashkëbisedimi, i cili mund të realizohet në forma të ndryshme, me qëllim reflektimin mbi dijen e marrë, duke ndërthurrur analizën, sintezën dhe vlerësimin. Disa nga këto strategji janë:

Grand conversation – pasi kanë lexuar tekstin në fazat e mëparshme, gjatë të cilave kanë mbajtur shënime mendimet, opinionet dhe idetë e tyre, nxënësit u rikthehen për diskutim çështjeve kryesore, duke reflektuar mbi to dhe mënyrën sesi janë paraqitur në tekst (gjuha e përdorur, ilustrimet, citate apo thënie, etj.

Cubing strategy, në të cilën nxënësit përdorin një kub gjashtëfaqesh, për të vendosur në secilën faqe, një nga foljet: përshkruaje; krahasoje, gjej lidhjet, analizoje, zbatoje dhe argumento kundër. Nxënësit diskutojnë ose shkruajnë rreth çështjes, nga të gjashta aspektet.

Posterat (poster session), mund të finalizojnë shumë mirë një orë mësimore. Nxënësit mund të punojnë në grupe të vogla dhe të paraqesin në postera (flipcharter) idetë e tyre, që mund të paraqiten vizualisht (vizatime), të bashkuara me fjalët ose tekstin, mesazhin përkatës, etj. Grupet diskutojnë idetë e njëri-tjetrit.


Reflektimet mund të bëhen p.sh. pasi nxënësit kanë dëgjuar leximin e një teksti apo shfaqjen e një video ose filmi. Në fund drejtohen diskutimet lidhur me: cilat ishin konceptet kyce që hasën? me çfarë idesh të tjera mund ta lidhin? Cfarë pyetjesh kanë akoma? Diskutimet në grup janë të shumë të efektshme për të krijuar lidhjen me informacionin e ri që mësuesi do të japë orën tjetër.

Faza e fundit dhe shumë e rëndësishme është zbatimi i metodave të mësipërme në **plan ditarin** (enactment), në të cilin konkretizohen të gjitha fazat e mësipërme.

Më poshtë është treguar një model plan-ditari për 1 orë mësimore (90 min), për lëndën e qytetarisë:

4.3 Modeli i një plan-ditar për shkencat sociale – Koha 90’

Tema mësimore: Zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit dhe politikat në mbrojtje të tij.

Hapat	Koha	Metoda dhe strategji	Vlerësimi
Faza I Tërheqja vëmendjes (Ëarm up)	10-15’	Ftesë për diskutim në tekst. Brainstorming;  Rreziqet për mjedisin •CO2 •djegia...etj Zhvillim i qëndrueshëm •kursimi •... Politika në mbrojtje •investime •.....	Përmes aktivizimit në diskutim

		Diskutime idesh të njohura më parë nga lëndë të tjera dhe në nivelet paraardhëse. Çështje për diskutim: Cila është rëndësia e mjedisit për jetën në Tokë? Cilat janë disa nga pasojat e ndërhyrjes së njeriut mbi mjedisin? Cfarë mund të bëj shoqëria dhe shteti për mbrojtjen e tij? Cilat janë disa nga ndërhyrjet që mendoni se duhen bërë aktualisht?	
Objektivat	3-5'	• Shpjegon konceptin “Zhvillim i qëndrueshëm i mjedisit”. • Analizon shkaqet të dëmtimit të mjedisit. • Vlerëson hapat për rigjenerimin e dëmeve të shkaktuara.	
Faza 2- Shpjegimi i koncepteve të reja	15-20'	 •mbrojtja e pasurive •pakësimi i ndotjeve •gjetja e burimeve alternative •rigjenerimi i zonave të dëmtuara • etj. •investime në infrastrukturë •vendosja e masave penalizuese •sensibilizimi i qytetarëve dhe pjesëmarrja aktive në politikat mjedisore •etj. Lexim i drejtuar: Nxënësit lexojnë situatat në tekst dhe marrin shënime për konceptet dhe problemet-kyc. Mësuesja harton hartën e konceptit që lidhet me njohuritë e reja mbi zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe politikat që duhej të ndjekë shteti për t'i përmirësuar.	Plotësimi i punës së pavarur dhe aktivizimi i nxënësve gjatë shpjegimit
Faza 3 Angazhimi i nxënësve	20-30'	Punë e pavarur në grupe. Secili grup harton në një flipcharter një projekt-ligj që ndihmon në mbrojtjen e mjedisit, për: -Gr. I - mbrojtjen nga ndërhyrjet e dëmshme; -Gr. II – parandalimin e dëmeve të mëtejshme; -Gr. III – rigjenerimin e zonave të dëmtuara; - G. IV – bashkëpunimin me shtete të ndryshme.	Pjesëmarrja në punën në grup

Faza 4 Përforsim njohurish	20- 25'	Prezantimi i punëve të pavarura; Diskutime dhe reflektime rreth temës; Mësuesja iu rikthehet shënimeve të marra në fillim të orës (Grand conversation) dhe qartëson pyetjet që kanë mbetur. Konkluzionet e orës dhe mesazhi tek i cili nxënësit kanë arritur.	Bashkëbisedimi; reflektimet dhe mesazhet e dhëna.
----------------------------------	------------	---	--

"Bazuar në "The Block Scheduling Handbook" i J. Allen Queen"

Tema 2 : Organizimi i orës mësimore për orët 90'

Suksesi i planifikimit të bllokut mësimdhënës do të përcaktohet nga aftësia e mësuesve për të përfshirë një shumëllojshmëri të strategjive të mësimdhënies brenda kuadrit të ri kohor të caktuar. Për të bërë këtë tranzicion, mësuesit duhet të marrin pjesë të gjerë në trajnime për t'i ndihmuar të zgjerojnë repertorin e tyre të mësimdhënies që t'i shërbejnë më mirë nevojave të nxënësve të tyre.

Në fund të fundit, përgjegjësia për zbatimin e strategjive mësimore qëndron në duart e mësuesve të cilët duhet të përgatiten mirë dhe të jenë të aftë për të përdorur një sërë strategjish, përveç pedagogjike, për mësim efektiv të studentëve. Zhvillimi i stafit mund të përfshijë disa nga temat e mëposhtme: mësimi bashkëpunues, integrimi i kurrikulës, mësimi në grup, vlerësimin, stilet e të mësuarit dhe inteligjencën e shumëfishtë, si dhe përdorimin e teknologjisë.

Në librin e tij "Korniza e mendjes", Howard Gardner shprehet se ka shumë forma të inteligjencës dhe se:

1. Të gjithë ne i posedojmë këto inteligjenca dhe mund t'i përdorim ato në mënyrë produktive.
2. Shumica e njerëzve mund të zhvillojnë çdo inteligjencë në një nivel të duhur të aftësisë.
3. Inteligjencat zakonisht punojnë së bashku në mënyra komplekse.
4. Ka shumë mënyra për të qenë inteligjentë brenda secilës kategori.

Shtatë zbulimet e identifikuar nga Gardner janë:

Inteligjencat: verbale, gjuhësore, logjike / matematikore, muzikore / ritmike, vizuale / hapësinore, trupore / kinestetike, intrapersonale, dhe ndërpersonale.

Tradicionalisht, shkollat u kanë dhënë mësim studentëve që janë verbale / gjuhësore dhe / ose logjike / matematikore dhe shumë nga studentët janë etiketuar në rrezik, me arritje të ulta, ose të pamotivuar sepse nuk u mësuan në rrugët e duhura. Nëse besojmë që të gjithë studentët mund të mësojnë, atëherë është përgjegjësia jonë të adresojmë çdo nxënës në mënyrën e veçantë të të mësuarit.

Rasti i Gjuhës së Huaj

Mësuesit e gjuhëve të huaja janë në një avantazh. Tradicionalisht ata kanë përdorur aktivitete të ndryshme për të ndihmuar studentët të zhvillojnë dëgjimin, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Ndërsa ne e pranojmë se një klasë prej 90 minutash duhet të përfshijë shumë aktivitete, shumë shpesh, kalimi në një kohë më të gjatë do të thotë të shtojmë aktivitete shtesë të palidhura. Është e rëndësishme për të kujtuar se aktivitetet e ndryshme nuk do t'i ndihmojnë studentët të përvetësojnë gjuhën përveç aktiviteteve që janë të lidhura me fokusin e tyre.

Plani i Mësimi

Për të adresuar këtë pikë, Canady dhe Rettig (1995) sugjerojnë një plan mësimor prej tre pjesësh që përfshin:

1. Prezantimi i materialit nga mësuesi

2. Aplikimi i informacionit

3. Sintezë dhe mbyllja

Ata rekomandojnë që faza e aplikimit të jetë veçanërisht e theksuar pasi në këtë fazë studentët kanë mundësinë të përvetësojnë informacionin.

Ora 90-Minutëshe

Për klasën e suksesshme 90-minutëshe, është e rëndësishme të konsiderojmë shumëllojshmërinë e aktiviteteve, si dhe elementin kohë. "Klasat prej 90 minutash ndahen më së miri në tre seksione 30 minutëshe. Koha duhet të ndahet për të përfshirë aktivitete interaktive dhe të pavarura.

Cilësitë e një plani efektiv 90-minutësh të mësimit janë si vijon:

• Shumëllojshmëri

Aktivitete mendore dhe fizike, qendra e vëmendjes (mësues, nxënës i vetëm, prezantime grupi), stilet e mësimit, blloqet e kohës, intensiteti.

• Tranzicioni

Nëse jeni duke kaluar nga një aktivitet në tjetrin, do të humbasësh vëmendjen e disa nxënësve nëse kalimet nuk janë të qeta, logjike dhe të qarta për studentët.

• Koha për të paraqitur informacionin

Koha prej 90 minutave lejon më shumë kohë për praktikën e udhëhequr nga mësuesi në klasë.

• Koha për shqyrtim dhe mbyllje

• Planifikimi i mençur dhe i kujdesshëm do të thotë të mos bini në kurthin e të menduarit, "oh, kemi 90 minuta, kështu që nuk duhet të fillojmë aq shpejt sa më parë". Ju ende duhet të përdorni të gjithë atë kohë në mënyrën më të mirë të mundshme.

"Si të jap mësime për 90 min duke bërë nxënësit të japin maksimumin e tyre, të jenë të përqendruar dhe efektivë?"

Këto janë disa pyetje që mësuesit zakonisht bëjnë kur bëjnë kalimin nga periudha më e shkurtër e klasës (45 minuta) në periudha më të gjata (90 minuta) të kohës së mësimit. Më poshtë janë disa mjete praktike, këshilla dhe teknika për të përfutur sa më shumë nga mësimi në bllok 90 min.

1. Ruaj zërin tënd për gjërat e rëndësishme. Përdorni zërin tuaj për shpjegime të qarta dhe jepni shembuj të mirë të ideve që po përpiqeni të përcillni. Shkruani udhëzimet për punën individuale ose në grup në dërrasë.

2. Shkruaj planin në dërrasë. Ai mund të përfshijë:

30 minuta - mësuesi prezanton një ide, temë ose aftësi të re.

30 minuta - studentët punojnë në grupe të vogla për të rishikuar konceptet, aftësitë ose çështjen e paraqitur.

30 minuta - mësuesi paraqet një ide tjetër të re ose përmbledh diskutimin e tërë grupit.

3. Përdorni "stacionet mësimore" si bazë për organizimin e kohës. Ndajeni klasën në grupet e të mësuarit dhe ndërroni këta të fundit përmes një sërë "stacionesh mësimore" që kërkojnë që ata të kryejnë një detyrë kyçe që lidhet me temën që studiohet.

15 minuta - paraqitja dhe drejtimi i punës.

20 minuta - Stacioni 1

20 minuta - Stacioni 2

20 minuta - Stacioni 3

15 minuta - rishikimi i mësimit

4. Përdorni "mënyrën e seminarit" në lëndën tuaj.

15 minuta - lexim i heshtur (gjithkush lexon)

15 minuta - përgjigjet e lexuesit (të gjithë shkruajnë një përgjigje të një analize të leximit)

30 minuta - zgjedhje (të gjithë duhet të bëjnë një nga aktivitetet e mëposhtme):
reflektimet e ditarit

rishikimin i detyrave të nxënësve ose një ese / produkt të kërkuar

hulumtim (duke përfshirë edhe kalimin në bibliotekë / sallën e kompjuterave)

diskutim me mësuesin (diskutimi me gojë i punës në progres)

përfundimi (shkrimi i punës)

30 minuta - udhëzim i tërë grupi (mund të përfshijë leximin në klasë, diskutimin e historisë / temave, rishikimin kritik të tregimeve, leximit etj)

5. Përdorimi i strategjive të mësimit bashkëpunues. Ndarja e klasave në grupe më të vogla që punojnë në detyra të njëjta ose të ndryshme siguron disa përfitime. Nxënësit mësojnë aftësitë e punës në grup duke përdorur rolet, duke ndjekur rregullat, duke mbajtur shënime dhe duke u fokusuar në rezultate. Ata mund të rishikojnë atë që mësuesi ka shpjeguar, ose ata mund të bazohen në njohuri paraprake duke ndjekur diçka të re. Mësimdhënësi prezanton ose shqyrton bazat e punës në grup: ndërvarësinë, përgjegjshmërinë individuale, përpunimin e punës së grupit, zhvillimin e aftësive shoqërore dhe ndërveprimin. Stacionet mësimore gjithashtu mund të zgjedhin përdorimin e pajisjeve ose burimeve të ndryshme. Të dy detyrat e mësimit bashkëpunues dhe stacionet e mësimit ofrojnë eksperiencë praktike të të nxënësve, kërkojnë praktika të njohurive dhe aftësive esenciale, krijojnë mundësi për mësuesin për të vëzhguar dhe vlerësuar mësimin dhe kanë më shumë gjasa të përmbushin nevojat individuale të studentëve.

6. Thekso rëndësinë e dialogut në mësim. Një mënyrë për të akomoduar këtë dhe për të ndarë klasën tuaj në gjysmë. Ndërsa gjysma e klasës punon në projekte ose detyra të pavarura, gjysma tjetër ulet me ju në një rreth ose gjysëm rrethi për të diskutuar një detyrë leximi. Përzgjedhja e leximit duhet të jetë një burim origjinal - një roman, dramë ose ese - jo një fragment nga një antologji. Qëllimi i dialogut është që studentët të artikulojnë idetë e tyre rreth kuptimit dhe vlerës së punës. Mësimdhënësi nxjerr mendime përmes pyetjeve të hapura si më poshtë:

Dëshmia - Si i mbështet autori pretendimet e tij ose të saj? Mund të citoni dëshmi specifike se karakteri kryesor ishte i besueshëm / i drejtë / i pabesë.

Perspektiva - Kush e shkroi këtë? Si e dini? Cilat ishin kushtet në kohën kur autori i shprehu këto ide.

Lidhjet - Ku e keni hasur këtë temë / çështje më parë? A lidhet kjo me çdo gjë që po ndodh në botë / në jetën tuaj / në familjen tuaj tani?

Pasoja - Cila është rëndësia e këtyre ideve?

Mësuesi mund të vendosë për të punimin në grup në shkenca.

- Nxënësi mund të përcaktojë një problem
- Nxënësi mund të shkruajë një hipotezë
- Nxënësi mund të krijojë një plan hulumtimi
- Nxënësi mund të kryejë kërkime
- Nxënësi mund të mbledhë të dhëna me saktësi
- Nxënësi mund të organizojë të dhëna
- Nxënësi mund të analizojë dhe interpretojë të dhënat
- Nxënësit përdorin një sërë burimesh

- Nxënësi mund të shkruajë një përfundim
- Nxënësi mund t'i paraqesë gjetjet në mënyrë vizuale dhe gojore
- Nxënësi zgjidh një problem të rëndësishëm
- Nxënësi mund të planifikojë dhe t'i përmbahet një afati kohor

7. Vendosni probleme në qendër të klasës. Shumica e profesioneve të të rriturve merren me zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet shoqëria - në ligj, mjekësi, bujqësi, industri, biznes, financë dhe qeveri. Duke i vendosur studentët në role të shkencëtarëve, gazetarëve, shkrimtarëve, artistëve, historianëve, matematikanëve dhe gjyqtarëve, shkollat mund të integrojnë përvetësojnë e aftësive themelore me eksplorimin e karrierës dhe zhvillimin e interesave të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Mësimdhënësit që përdorin probleme të botës reale, u lejojnë nxënësve që të trajtojnë një koncept, problem ose çështje që ata kanë gjasa ta hasin në jetë përtej klasës. Situata problematike i sfidon studentët të mendojnë më thellë, të zbatojnë mësimet në situata të jetës reale, të shqyrtojnë informacionin që zbulojnë dhe të përdorin njohuritë e tyre për të ndërtuar zgjidhje etike për problemet.

Shembull: (nga një detyrë e pavarur e matematikës)

"Ne jemi duke bërë një raft për të mbajtur stereon tonë të ri. Ne duhet të kemi tre rafte. Rafti i lartë duhet të përmbajë tre ndarje, rafti i dytë, dy ndarje, rafti i fundit, një ndarje. Se gjithashtu kemi 6 dërrasa që janë 60" të gjata, 2.5 " të gjera dhe 1" të trasha. Ju mund të përdorni vetëm materialet e dhëna. Vizatoni një skemë të asaj se si do të duket objekti. Kur të mbarojë. Përdorni thyesat për të treguar se si do t'i prisni dërrasat për të bërë ndarjet".

8. Inkurajoni dialogun e studentëve. Mësimdhënësit të cilët theksojnë logjikën, arsyetimin dhe komunikimin efektiv kërkojnë që studentët të angazhohen në biseda me mësimdhënësin dhe / ose kolegët e tyre në një mënyrë që të kuptojnë me mire idetë e temave. Bisedat karakterizohen nga diskutimi hapur i pikëpamjeve të ndryshme, duke kërkuar zgjidhje reciproke, duke krijuar marrëdhënie pozitive dhe produktive.

Seminaret Sokratike janë një format i specializuar për gjenerimin e të menduarit kritik dhe pyetjeve thelbësore. Ndërsa pjesa tjetër e klasës punon në projekte individuale ose në provime, një mësues mund të punojë me 4-5 nxënës që kanë përfunduar një detyrë (ese) në një format seminaresh. Mësimdhënësi përgatitet për seminarin duke ndërtuar pyetje për të cilat:

- mund të ketë shumë përgjigje të mundshme;
- udhëheqësi nuk i ka të gjitha përgjigjet;
- të gjithë pjesëmarrësit mund të përgjigjen
- pyetjet bazohen në caktimin e leximit

Shembull:

- ✓ Çka do të thotë autori me "_____?"
- ✓ Si do ta vlerësonit "_____?"
- ✓ A mund të gjesh një fragment në tekstin që e mbështet atë?
- ✓ Si është "_____" ndryshe nga "_____?"
- ✓ Si lidhet kjo me sot?
- ✓ Cilat dy ose tre tema kanë dalë vazhdimisht në këtë diskutim?

9. Kërkojuni studentëve të përfundojnë projektet. Projekti zakonisht rezulton në një produkt të prekshëm - një raport me shkrim, një shfaqje, një koleksion, një poster, një ndërtim ose një performancë. Mësuesit që presin që nxënësit e tyre të planifikojnë dhe kryejnë projekte shpesh kërkojnë që nxënësit e tyre të komunikojnë njohuritë e tyre përmes një produkti ose performancë të ofruar për një audiencë përtej mësuesit, klasës dhe shkollës. Projektet ndihmojnë studentët të mësojnë të menaxhojnë kohën në punën

në grup, të zgjidhin problemet së bashku, të integrojnë përmbajtjen dhe të zhvillojnë shprehitë e punës gjatë gjithë jetës. Mësuesit përdorin portofole, ekspozita dhe prezantime gojore për të vlerësuar të mësuarit nga puna e projektit.

Shembull: (nga ora e Shkencave Sociale)

Debati i kodrave të zeza: Ekziston një debat aktual politik dhe sociologjik lidhur me kthimin e Kodrave të Zeza në Sioux Lakota. Lakota ishin amerikanët vendas që jetonin në kodrat e zeza përpara se Shtetet e Bashkuara të merrnin në zotërim territorin. Detyra juaj është të hulumtoni historinë e zotërimit të Kodrave të Zeza nga banorët vendas, si edhe pikëpamjet e të gjithë atyre që ishin dhe aktualisht janë të prekur nga kjo çështje.

- Përdorni të paktën tre burime për hulumtimin tuaj (libra, artikuj, raporte gazetalesh)

- Si një ekip, ndërto një argument pro ose kundër kthimit të Kodrave të Zeza vendasve, duke cituar burimet tuaja si mbështetje.

- Paraqitni argumentin tuaj në një grup të politikave publike që studion çështjen.

- Ju mund të paraqisni argumentin tuaj duke përdorur pamjet, një pamflet të përgatitur për publikun, një prezantim me gojë, një shfaqje etj.

10. *Zhvilloni detyra autentike.* Studentët kryejnë të njëjtat aktivitete që bëjnë të rriturit e suksesshëm, siç janë shkencëtarët, muzikantët, menaxherët e biznesit, novelistët, infermierët dhe projektuesit. Kjo shërben për të motivuar, si dhe për të thelluar të kuptuarit duke eksploruar konceptet dhe aftësitë me ndërjegje. Mësuesit kërkojnë që studentët të demonstrojnë njohuritë e tyre në përdorim, duke arritur kulmin në një performancë ose produkt të vëzhgueshëm. Mësimdhënësit inkurajojnë studentët që të vetë-vlerësojnë, vetëvlerësojnë dhe vetë-rregullojnë punën e tyre.

Shembull: (nga ora e shkencave sociale)

"Zgjidh një nga lagjet e shënuara në hartën e qytetit. Identifikoni karakteristikat e tij aktuale duke bërë një raport të ndërtesave të tij, bizneseve, banesave dhe objekteve publike. Identifikoni modelet aktuale të transportit dhe rrjedhën e trafikut. Përshkruani çdo problem të veçantë që po përjeton kjo lagje. Në grup, konsideroni plane të ndryshme për ndryshimin dhe përmirësimin e lagjes. "

11. *Ndrysho teknikat e pyetjeve.* Mësuesit bëjnë pyetje të hapura, në mënyrë që studentët të përpunojnë informacionin dhe idetë përmes analizës, sintezës dhe vlerësimit, si dhe kujtojnë, kuptojnë dhe vënë në zbatim. Pyetjet e mësuesit stimulojnë të gjitha format e të menduarit. Mësuesit i përgjigjen preferencave të mësimit, tregojnë nxënësve se si të organizojnë të menduarit për përmbajtjen që mësohet dhe nxisin studentët të flasin për ato që mesojnë.

Shembull: (nga një detyrë në gjeografi)

"Pasi të vendosni për një plan, tregojeni në hartën tuaj. Tregoni me shkrim një plan të mundshëm që keni dhe shpjegoni. Shpjegoni se si plani juaj do të promovojë dhe arrijë tiparet e lagjes që dëshironi. "

12. *Integroje Teknologjinë.* Duke ofruar mundësi në klasë për të përdorur mjete të ndryshme për të mbledhur, analizuar të dhënat, mësuesit u ndihmojnë nxënësve të lidhin mesazj që ata po mësojnë në shkollë dhe aftësitë në vendin e punës që kërkojnë në botë përtej shkollës. Një nga strategjitë për këtë është përdorimi i kompjuterëve, CD-ROM, disk lazer dhe multi-media për të rritur të nxënësit me bazë projektesh dhe vlerësim autentik. Një tjetër është që studentët të tregojnë rezultatet e punës së tyre në një prezantim.

Shembull i teknologjisë si një mbështetje mësimore:

Studentët bëhen presidentë të vendeve të cilat përballen me dilema të marrëdhënieve ndërkombëtare ose probleme të mëdha të emigracionit dhe kryetarët e bashkive të qyteteve të cilat përballen me krizat mjedisore. "Këshilltarët në internet" u tregojnë nxënësve opinione, fakte, precedentë dhe këshilla të nxjerra nga historia dhe ngjarjet aktuale. Studentët janë të ekspozuar në të gjitha anët e çështjeve dhe

shpejt mësojnë kompleksitetin e përfshirë në vendimmarrje. Nxënësit mësojnë të caktojnë përparësitë, mendojnë në mënyrë kritike për atë që lexojnë, lidhin dhe parashikojnë pasojat.

- Studentët zbulojnë një dilemë të vërtetë botërore përmes një prezantimi on-line dhe leximit kritik të skenarit në librat e tyre të referencës.
- Si një grup i tërë, nxënësit i japin përparësi qëllimeve të tyre.
- Këshilltarët në internet i tregojnë studentëve referencat historike dhe ofrojnë perspektiva të shumta për vendimet me të cilat përballen studentët.
- Pikëpamjet e kundërta dhe shembujt nga e kaluara shkaktojnë diskutime të gjalla në klasë kur studentët arrijnë në një konsensus rreth asaj se çfarë veprimi duhet ndërmarrë.

Si përfundim, mësuesit e suksesshëm bazohen në ndarjen prej 30 minutash ku nxënësit marrin informacion në fazën e parë, punojnë në grup në fazën e dytë duke vlerësuar hipoteza dhe nxjerrje përfundimesh dhe në 30 minutat e fundit bëhet diskutimi me gjithë klasën. Si rrjedhim, nxënësit janë më të përfshirë në procesin mësimor.

"Bazuar në "The Block Scheduling Handbook" i J. Allen Queen"

5. Model projekti lëndor. Udhëzime për hartimin e një ankete dhe projekti

(Në ndihmë të mësuesve po japim më të detajuar projektin lëndor që ndodhet në tekstin e nxënësit)

Projekti i lëndës me temë: "Hartimi dhe realizimi i një ankete"

Anketa është një nga metodat kryesore të kërkimeve sociologjike, e cila përdoret dendur veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore. Përvoja e studimeve sociologjike në mjaft vende të botës dhe në Republikën e Shqipërisë tregon se anketa është mjaft e përshtatshme për tërheqjen e opinionëve të të rejave dhe të rinjve adoleshentë për probleme të ndryshme që shqetësojnë shoqërinë, veçanërisht vetë ata. Adoleshentët dhe adoleshentët përgjithësisht kanë vetëdije më pak të tjetërsuar se njerëzit e grupmoshave të tjera më të rritura. Kryesisht për këtë arsye përgjigjet e tyre për pyetjet e anketës janë më të drejtpërdrejta, më të çiltra, më të sigjerta, më të besueshme.

1. Faza e parë

Në fund të kreut "Metodat e kërkimit sociologjik" është një anketë, e cila trajton problematikën komplekse, por mjaft të rëndësishme për të ardhmen profesionale e shoqërore të maturantëve: atë të përzgjedhjes së fushës së studimeve universitare, pra të profesionit që do të ushtrojnë në jetë. Natyrisht edhe shoqëria është mjaft e interesuar që të reja dhe të rinjtë të arsimohen në nivele universitare dhe mbiuniversitare në ato fusha, në të cilat ata mund të ofrojnë punë më të kualifikuar, arritje profesionale, shkencore e artistike më të spikatura.

Në fazën e parë të projektit mësuesja/i sociologjisë i sqaron nxënësit se si duhet plotësuar kjo anketë e fotokopjuar. Pasi nxënësit e plotësojnë vetë anketën mësuesja/i diskuton bashkë me ata vështirësitë dhe të metat në procesin e plotësimit të anketës. Një diskutim i tillë i ndihmon nxënësit të përfitojnë nga përvoja e njëri-tjetrit në kapërcimin e të metave të konstatuara. Nëse mësuesja/i, në këshillim me nxënësit e konsiderojnë të arsyeshme, mund të shtojnë ose të ndryshojnë pyetje të caktuara të anketës. Më pas nxënësit/it vihen në rolin e anketuesit për të gjithë maturantët e shkollës, pra edhe për ata që nuk e kanë përzgjedhur lëndën e sociologjisë. Gjithashtu, kjo anketë mund të plotësohet edhe me postë elektronike.

Pasi grumbullohen anketat e plotësuara nga gjithë maturantët e shkollës, hartohet programi i përpunimit të tyre me teknikat kompjuterike. Për këtë ndihmojnë mësueset/it e sociologjisë dhe mësueset/it e informatikës që punojnë në shkollë.

Mësueset/it e këtyre profileve i udhëzojnë nxënësit si të hedhin në kompjuter të dhënat e anketave. Pasi përfundon ky proces, fillon përpunimi matematikor i të dhënave të anketimit. Përlllogariten në shifra absolute dhe në përqindje të gjithë alternativat e të gjithë pyetjeve. Më pas përlllogariten në shifra absolute dhe në përqindje të dhënat e anketimit të grupuara sipas këtyre kriterëve: 1) përkatësisë gjinore; 2) gjendjes ekonomike të familjes; 3) notës mesatare; 4) lëndës ose grup-lëndëve në të cilat kanë përparim më të mirë në mësim. 5) nivelit arsimor të nënës; 6) nivelit arsimor të babait; 7) llojit të punësimit të nënës; 8) llojit të punësimit të babait; 9) vendbanimit (rrethi, qyteti, fshati).

Për të realizuar analiza më të thella përlllogariten në vlerë absolute dhe në përqindje të dhënat që përftohen nga kombinimi i alternativave të pyetjeve, që parashikohet të ofrojnë më shumë përfundime të rëndësishme: pyetja e I dhe e II, pyetja e I dhe e III; pyetja e I dhe e IX; pyetja e II dhe e XI; pyetja e XII dhe e XV; pyetja e XV dhe e XVIII; pyetja e XVII dhe e XVIII; pyetja e XVIII dhe e XIX; pyetja e XVIII dhe e XX; pyetja e XVIII dhe e XXI.

Të dhënat e kësaj ankete mund të përpunohen jo vetëm në nivel shkolle. Mësuesit dhe nxënësit e disa shkollave të qytetit ose të rrethit mund t'i përpunojnë ato të grupuara.

Disa nxënësve, të ndarë në grupe, u caktohet si detyrë të lexojnë me vëmendje përgjigjet e pyetjeve të hapura me dy pikësynime kryesore: 1) të përgjithësojnë idetë themelore që shprehen në to; 2) të qëmtojnë mendimet origjinale më interesante të maturantëve të anketuar.

Pasi përpunohen të dhënat e anketimit nxënësit e ndarë në disa grupe përgatisin materiale me shkrim për të interpretuar të dhëna të anketimit të grupuara sipas çështjeve të caktuara, ndër të cilat mund të sugjerohen: 1) parapëlqimet e vajzave për degët e ndryshme të studimeve universitare; 2) parapëlqimet e djemve për degët e ndryshme të studimeve universitare; 3) parapëlqimet e maturantëve me banim në qytete për degët e ndryshme të studimeve universitare; 4) parapëlqimet maturantëve me banim në fshatra për degë të ndryshme të studimeve universitare; 5) motivet që i nxisin maturantët të studiojnë në universitetet shqiptare; 6) motivet që i nxisin maturantët të studiojnë në universitetet e vendeve perëndimore; 7) vlerat kulturore që çmojnë më shumë maturantët; 8) ndikimi i prindërve në motivimin e maturantëve për të studiuar në universitetet shqiptare ose në ato të vendeve perëndimore; 9) ndikimi i shoqeve dhe i shokëve të afërt në motivimin e maturantëve për të studiuar në universitetet shqiptare ose të vendeve perëndimore; 10) ndikimi i programeve televizive dhe të internetit në motivimin e maturantëve për të studiuar në universitetet e vendeve të tjerë; 11) shkalla e optimizmit të maturantëve për të ardhmen vetjake dhe të Shqipërisë etj. Materialet e shkruara bëhen më tërheqëse duke i pasuruar me grafikë të shumëllojshëm, që pasqyrojnë edhe figurativisht të dhënat më të rëndësishme të anketimit.

Në fund të kësaj faze mësuesja/i i jep vlerësimin çdo nxënësi për ecurinë e realizimit të elementëve të veçantë të këtij ministudimi.

Faza e dytë

Materialet e shkruara nga nxënësit në grupe për çështjet e sugjeruara ose për të tjera që kanë të bëjnë me problematikën që trajtohet në këtë anketë mund të paraqiten në një tip diskutimi ose konference studimore në nivel klase, shkollë ose si bashkëpunim i disa shkollave të mesme të rrethit. Në këto veprimtari mund të marrin pjesë jo vetëm maturantë, por edhe nxënës të klasave të nënta e të dhjeta të shkollës, mësues, prindër dhe motra e vëllezër të rritur të nxënësve maturantë, të cilët janë në prag të përzgjedhjes së profesionit që do të ushtrojnë në të ardhmen.

Diskutimet e të dhënave të anketimit në klasë, në shkollë e më gjerë i ndihmojnë nxënësit maturantë të thellohen në njohjen e problematikës që trajtohet në anketë, të tërheqin edhe mendime të tjera për

këto çështje mjaft të rëndësishme në rrafsh individual dhe për shoqërinë, siç është orientimi profesional i të rejave dhe të rinjve.

Nëse do të realizohet me sukses anketimi në shumicën e shkollave në shkallë kombëtare, mund të organizohet edhe një veprimtari kombëtare përmes diskutimeve në programet e internetit. Referatet më të arrira të maturantëve, të përgatitura përgjithësisht me bashkëautorësi mund të publikohen në gazeta e revista të ndryshme, veçanërisht në revistën "Mësuesi", në portale të ndryshme, mund të diskutohen në emisionet me profile arsimore e sociale të televizioneve vendore e kombëtare etj. Publikime të tilla do të sjellin një frymë rinore në trajtimin e problemeve jetike të të rejave e të rinjve, të gjithë shoqërisë shqiptare. Prej tyre mund të formulohen sugjerime për struktura vendimmarrëse përkatëse të shtetit shqiptar.

Për realizimin sa më cilësor të një projekti të tillë me vlera teorike dhe praktike mund të aktivizohen në rolin e ndihmësve edhe studente e studentë të kursit të tretë të ciklit të parë dhe veçanërisht studentë të masterit shkencor të degës së sociologjisë dhe mësues të rinj praktikantë të sociologjisë dhe përgjithësisht të shkencave sociale.

Në vlerësimin e punës së çdo nxënësi për fazën e dytë të projektit mësuesja/i ka parasysh edhe aftësitë e nxënësve për të publikuar në forma dhe në media të ndryshme arritjet e studimit.

Faza e tretë

Në fund të librit të mësuesit për lëndën "Sociologjia 12" parashtrohet një material i detajuar për aspektet kryesore të hartimit të anketës sociologjike. Ky material i fotokopjuar mund t'u ofrohet nxënësve më të zellshëm dhe më të orientuar kah studimet sociologjike. Megjithatë, në mësimin "Anketa sociologjike" që gjendet në linjën "Metodat e kërkimit sociologjik" të këtij teksti, shtjellohen njohuritë kryesore të mjaftueshme për hartimin e anketës.

Duke u bazuar në njohuritë e këtij mësimi dhe në përvojën gjatë realizimit të fazave të ndryshme të procesit të anketimit dhe të interpretimit të të dhënave të anketimit nxënësit të hartojnë anketa për probleme të ndryshme shoqërore dhe psikokulturore, kryesisht për ato të brezit të ri. Nxënësit i hartojnë këto anketa duke punuar individualisht ose në grupe të vogla prej 2-5 vetash, sipas dëshirës së tyre. Në anketa të tilla mund të trajtohen këto çështje kryesore:

1. Veçori të komunikimit të vajzave adoleshente me prindërit, me vëllezërit dhe me motrat e tyre.
2. Profile të komunikimit të djemve adoleshentë me prindërit, me motrat dhe me vëllezërit e tyre.
3. Probleme të komunikimit të vajzave adoleshente me njëra-tjetrën.
4. Veçori të komunikimit të djemve adoleshentë me njëri-tjetrin.
5. Profile të komunikimit ndërmjet vajzave dhe djemve adoleshentë.
6. Mekanizma psikokulturore të ndikimit të filmave televizivë me dhunë në modelet e sjelljes dhe të të menduarit të vajzave adoleshente.
7. Veçori të ndikimit të filmave televizive me dhunë në modelet e sjelljes dhe të të menduarit të djemve adoleshentë.
8. Mendësi e paragjykime për vajzat dhe djemtë adoleshentë në mjedise të ndryshme të shoqërisë shqiptare.
9. Probleme të komunikimit të vajzave adoleshente me mësueset dhe mësuesit e shkollës.
10. Profile të komunikimit të djemve adoleshentë me mësueset dhe mësuesit e shkollës.

Mësuesja/i i lexon anketat e hartuara nga nxënësit. Në një orë diskutimi në klasë mësuesja/i vë në dukje arritjet dhe mangësitë kryesore në përgatitjen e anketave nga nxënësit dhe vlerëson çdo nxënës për realizimin e fazës së tretë të projektit.

6. Modele testesh për realizimin e kompetencave lëndore.

Test i Tremujorit I

Klasa: XI_____

Emër/Mbiemër i Nxënësit: _____

Lënda: Sociologji

PIKËT E TESTIT NË TOTAL: 40

PIKËT E MARRA:_____

1. Përcaktoni termin "kulturë" në kuptimin sociologjik të saj: (2 pikë)

2. Me vlera kulturore në sociologji kuptojmë: (1 pikë)

- a. gjykime dhe kriterë vlerësimi për veprimtarinë dhe jetën e njerëzve
- b. pohime përshkruese të sjelljeve të individëve apo grupeve shoqërore
- c. rregulla të pashkruara të vendosura nga shoqëria
- d. një marrëdhënie shoqërore mes njerëzve

3. Përcaktoni tre elementët e mëposhtëm të kulturës si koncept sociologjik: (6 pikë)

- a. Simbolet kulturore _____
- b. Gjuha _____
- c. Normat kulturore _____

4. Koncepti "nënkulturë" në sociologji tregon: (1 pikë)

- a. kulturën e një grupi që i kundërvihet vlerave sunduese të një shoqërie
- b. kulturën materiale të krijuar nga shoqëria
- c. kulturën e një grupi që ndryshon në disa aspekte nga kultura sunduese
- d. kulturën sunduese të një shoqërie

5. Si e shpjegojnë zhvillimin e kulturës: (6 pikë)

- a. etnocentrikët _____
- b. ksenofobistët _____
- c. relativizmi kulturor _____

6. Në studimet sociologjike shoqërizimi përcaktohet si: (2 pikë)

7. Tregoni cili program i shkollës ndikon më shumë në shoqërizimin e nxënësve dhe shpjegoni pse: (3 pikë)

- a. programi i hapur
 - b. programi i fshehtë
- sepse _____

8. Shpjegoni kuptimin me të cilën janë përdorur shprehjet e mëposhtëme për të shpjeguar sjelljen e individit në raport me shoqërinë: (4 pikë)

a-"pasqyrë e vetes" nga Kulej _____
b-"tjetri i përgjithësuar" nga Mid _____

9. Përcaktoni nga ana sociologjike kuptimin e termave të mëposhtme: (4 pikë)

a. deviancë _____
b. krime _____

10. Dalloni tre nga faktorët që përcaktojnë kuptimin relativ të deviancës:

a. _____
b. _____

11. Përdorimi i substancave narkotike në sociologji konsiderohet si: (1 pikë)

- a. krim i jakave të bardha
- b. krim pa viktimë
- c. krim i organizuar
- d. krim qeveritar

12. Si ndikojnë përgjithësisht nofkat përçmuese në modelet e sjelljes së njeriut të etiketuar:

- a. e nxit drejt sjelljeve konformiste (1 pikë)
- b. e nxit drejt sjelljeve deviante

13. Sipas teorisë së kontrollit të T. Hirshit njerëzit që kanë më shumë mundësi të përparojnë në karrierën profesionale dhe shoqërore janë më pak të prirur drejt sjelljeve deviante. Shprehni mendimin tuaj: (3 pikë)

14. Shpjegoni kuptimin e koncepteve të mëposhtme sipas studiuesit Edvin Lemert:

a. deviancë parësore _____
b. deviancë dytësore _____

15. Shpjegoni tre nga funksionet shoqërore të deviancës: (6 pikë)

a. _____
b. _____
c. _____

Nota	4	5	6	7	8	9	10	
Pikët	Më pak se 10	11-15	16-20	21-25	26-30	31-35	36-40	

Test i Tremujorit II

Klasa: XI_____

Emër/Mbiemër i Nxënësit: _____

Lënda: Sociologji

PIKËT E TESTIT NË TOTAL: 50

PIKËT E MARRA: _____

1. Shpjegoni tre nga funksionet kryesore të familjes: (6 pikë)

- a. _____
- b. _____
- c. _____

2. Në cilën lloj familje anëtarët janë të lidhur emocionalisht me njëri-tjetrin: (1 pikë)

- a-familja bërthamë
- b-familja tipike patriarkale
- c-monogami seriale
- d-familje e hapur

3. Përshkruani tre shkaqe të rritjes së divorceve: (6 pikë)

- a. _____
- b. _____
- c. _____

4. Tregoni dy tipare të familjes patriarkale: (4 pikë)

- a. _____
- b. _____

5. Përshkruani: (4 pikë)

- a. si shfaqet pabarazia gjinore në punësim dhe të ardhura _____
- b. si shfaqet pabarazia gjinore në familje _____

6. Shpjegoni mendësitë e shoqërisë shqiptare për bashkëjetesën: (2 pikë)

7. Studimet sociologjike i përcaktojnë: (6 pikë)

- a. racat si _____
- b. etnicitetin si _____
- c. paragjykimet racore si _____

8. Shpjegoni dy aspekte të pluralizmit, si formë e marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne. (4 pikë)

- a. _____
- b. _____

9. Niveli jo i njëjtë i zhvillimit të racave të ndryshme tregon: (1 pikë)

- a. aftësi të ndryshme natyrore
- b. përparësi gjenetike të ndryshme
- c. predispozita biologjike përcaktuese
- d. kushte të ndryshme historike-kulturore

10. Në studimet sociologjike: (4 pikë)

a. pakicë kombëtare quhen _____

b. pakica etnike quhen _____

11. Në sociologji: (4 pikë)

a. pluralizëm quhet gjendja _____

b. asimilim quhet procesi _____

12. Arsyetoni zgjedhjen tuaj nëse në të ardhmen tuaj do të emigronit: (2 pikë)

a. përshtatjen e plotë ndaj kultures së vendit pritës për të përfituar më shumë

b. ruajtjen e kulturës dhe gjuhës kombëtare

13. Listoni tre nga funksionet shoqërore të fesë: (3 pikë)

a. _____

b. _____

c. _____

14. Në pohimet e mëposhtme qarkoni alternativën e saktë: (1 pikë)

a. krishtërimi predikon arritjen e gjendjes nirvana.

b. kulti është organizatë fetare zyrtare.

c. dinominejshën është organizatë fetare jozyrtare.

d. shekullarizimi është formë e rigjallërimit të besimeve fetare.

15. Pas Luftës së Dytë Botërore deri në fund të viteve 1980 prirjet shekullarizuese u përforcuan, si rrjedhojë e ndikimit të dy faktorëve kryesorë: (2 pikë)

a. _____

b. _____

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	Më pak se 20	21-25	26-30	31-35	36-40	41-45	46-50

Test i Tremujorit III

Klasa: XI_____

Emër/Mbiemër i Nxënësit: _____

Lënda: Sociologji

PIKËT E TESTIT NË TOTAL: 45

PIKËT E MARRA: _____

1. Dalloni dy ndryshime ndërmjet mënyrës urbane dhe rurale të jetesës. (4 pikë)

a. _____

b. _____

2. Përshkruani dy lloje faktorësh që ndikojnë në lëvizshmërinë shoqërore. (4 pikë)

a. _____

b. _____

3. Sociologët kanë vërejtur se çdo lëvizje shoqërore kalon nëpër katër faza kryesore. Rendisni dy fazat e para të saj: (2 pikë)

a. _____

b. _____

4. Tregoni dy pasoja që sjell për shoqërinë moderne venitjes së komuniteteve të vegjël tradicionale. (4 pikë)

a. _____ b. _____

**5. Sociologët e konsiderojnë shoqërinë pasmoderne si _____
Listoni tre nga profilet e saj kryesore: (4 pikë)**

a. _____

b. _____

c. _____

6. Tregoni cila nga metodat e kërkimit sociologjik siguron informacion më të pasur, për një kohë më të shkurtër: (1 pikë)

a.vëzhgimi sociologjik

b. intervista

c. anketimi

d. historitë e jetës

7. Përshkruani tre fazat nëpër të cilat kalon eksperimenti sociologjik: (6 pikë)

- a. _____
- b. _____
- c. _____

8. Tregoni cila nga metodat e kërkimit përdoret me përparësi nga sociologët për analizën krahasuese:

a. vëzhgimi i drejtpërdrejtë (1 pikë)

b. historitë e jetës

c. anketimi

d.intervista e lirë

9. "Puna në terren" e studjuesve në sociologji quhet ndryshe: _____ Listoni
tre nga përparësitë e kësaj metode: (4pikë)

- a. _____
- b. _____
- c. _____

10. Njerëzit priren të ndryshojnë sjellje kur studimi sociologjik zhvillohet: (1 pikë)

a. në mjedis të natyrshëm

b. në mjedise laboratorike

Shpjegoni pse: (3 pikë)

11. Në anketën sociologjike përdoren disa tipe pyetësorësh, shpjegoni dy prej tyre: (4 pikë)

a. _____

b. _____

12. Studimet sociologjike shpesh bazohen në përzgjedhjen sipas kritereve të caktuara të "segmenteve" apo kampioneve të grupeve shoqërore. Përkthyeri dy kriteret kryesore të kampionimit: (4 pikë)

a. _____

b. _____

13. Cilat nga metodat kërkimore nxitin mendimet origjinale vetjake të përgjigjedhënesit:

a. intervista e strukturuar (1 pikë)

b.vëzhgimi i drejtpërdrejtë pjesëmarrës

c. anketa

d. intervista e lirë.

14. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë: (1 pikë)

a. shkencat sociologjike e përdorin më shpesh metoden e eksperimentit sesa shkencat natyrore.

b. teknikat moderne që përdoren në kërkimet sociologjike ndihmojnë drejtpërdrejtë në zbulimin e thelbit të dukurive shoqërore.

c. pyetjet e strukturuar e lejojnë përgjigjedhënesin të shprehë lirshëm mendimin e tij.

d. informacioni sociologjik, që mblidhet nëpërmjet pyetjeve të strukturuar, përpunohet pa vështirësi me metoda matematikore.

15. Cila metodë është më e përshtatshme për studimin e mendimeve të një njeriu të panjohur:

1. studimi i të dhënave statistikore (1 pikë)

2. intervista e strukturuar

3. intervista e gjysmëstrukturuar

4. intervista e lirë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	Më pak se 15	16-20	21-25	26-30	31-35	36-40	41-45

7. Model vetëvlerësimi për nxënësit/es dhe mësuesen/in.

FORMULAR VETËVLERËSIMI				
Tremujori i parë				
Lënda: Sociologji		Klasa: 12	Emër mbiemër: _____	
Nr	Tematika	Niveli i vetëvlerësimit		
	<i>Tematika 1: Kultura, individi, shoqëria</i>	Mjaftueshëm	Mirë	Sh. Mirë
	1.shpjegoj konceptin gjithëpërfshirës të kulturës; 2.tregoj kuptimin e simbolit kulturor dhe funksionet kryesore të simboleve kulturore; 3. përshkruaj kuptimin e gjuhës si tërësi simbolesh kulturore; 4. përshkruaj rolin e veçantë të gjuhës shqipe në shpjegimin e dukurive kulturore e gjuhësore të vendeve të tjera të Evropës; 5. tregoj kuptimin e konceptit sociologjik të vlerave kulturore; 6. argumentoj rolin e veçantë të vlerave kulturore të besës dhe të mikpritjes së shoqërisë tradicionale shqiptare; 7.shpjegoj konceptin sociologjik të normave kulturore; 8.përcaktoj konceptin sociologjik të nënkulturës dhe kundërkulturës; 9.argumentoj se kultura shqiptare është mozaik nënkulturash.			
	<i>Tematika 2: Shoqërizimi</i>			
	1. shpjegoj kuptimin sociologjik të shoqërizimit; 2. jap shpjegime sociologjike të procesit të shoqërizimit; 3. shpjegoj ndikimet e veçanta të mjediseve dhe faktorëve të ndryshëm; 4. përshkruaj ndikimin e filmave me procese gjyqësore dhe me dhunë; 5. përshkruaj karakteristikat kryesore të shoqërizimit në ciklet e jetës;			
	<i>Tematika 3: Devianca</i> 1. përshkruaj karakterin relativ të sjelljeve deviante, faktorët që i përcaktojnë ato; 2. përshkruaj pesë tipat kryesorë të krimit; 3. dalloj format specifike të shfaqjes së krimeve të tilla në shoqërinë shqiptare të ditëve tona;			

	4. përshkruaj shpjegimet kryesore biologjike dhe gjenetike të deviancës; 5. shpjegoj teorinë sociologjike të kontrollit të Trevis Hirshit dhe teorinë e etiketimit të Hauërd S. Beker për shpjegimin e deviancës; 6. përshkruaj funksionet kryesore shoqërore të sjelljeve deviante.			
--	--	--	--	--

Model vetëvlerësimi për mësuesen/in

Formular vetëvlerësimi për mësime				
Lënda: Sociologji		Klasa: XII		Tremujori I
Vetëvlerësimi	Niveli i vetëvlerësimit			
Si e realizova planin mësimor? Cilat ishin ndryshimet që bëra? Ishin efektive? A ishin zgjedhur aktivitetet sipas njohurive të nxënësve apo zhvillova një tjetër veprimtari?	Mjaftueshëm	Mirë	Sh. Mirë	Vërejtjet
Isha përgatitur për aktivitetet që duhet të zhvilloheshin? Punova sipas një plani të përgatitur paraprakisht?				
Kisha mundësi të siguroja materialet dhe mjetet për çdo veprimtari? Munda të ofroja një mjedis më të ngrohtë, tërheqës dhe stimulus për nxënësit?				
A kisha mundësi të ndërveproja në mënyrë të përshtatshme, gjatë të gjithë kohës me nxënësit? Tregova durim dhe mirëkuptim gjatë veprimtarisë? Ishte e mundur të kontrolloja nxënësit gjatë të gjithë kohës?				
Ishin të kënaqur nxënësit me punën në grup? E zgjodhën vetë grupin ku kishin dëshirë të punonin? A munda të siguroja zhvillimin normal të veprimtarisë në këto kushte?				
U kujdesa që mbas zhvillimit të veprimtarisë, mjedisi në klasë të ishte i rregullt për të zhvilluar orën pasardhëse?				
A e kisha mundësinë të mbaja në				

mënyrë të rregullt regjistrin dhe dosjet e nxënësve?				
E realizova drejt vlerësimin e nxënësve?				
Cilat ishin vështirësitë dhe pengesat gjatë zhvillimit të veprimtarive? A kisha mundësinë për t'i zgjidhur ato?				
Ishin të mjaftueshme format që përdora për tërheqjen e prindërve në realizimin e programit? A ishte e dobishme ndihma e tyre?				